



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 117

Tiranë – E hënë, 8 qershor 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 85/2026, datë 1.6.2026	Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit.... 10719
Vendim i Kuvendit nr. 86/2026, datë 1.6.2026	Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit 10720
Vendim i Kuvendit nr. 87/2026, datë 1.6.2026	Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit..... 10721
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 2, datë 21.5.2026	Për përcaktimin e mënyrave të ndërhyrjes nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në rastet e moszbatimit të detyrimeve nga pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore..... 10723
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 3, datë 21.5.2026	Për përcaktimin e kushteve, kritereve, procedurave, mënyrave, kohëzgjatjes dhe tarifave, për dhënien e miratimit të interesit kulturor të veprimtarive kulturore dhe çdo iniciative tjetër me karakter kulturor..... 10724
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 4, datë 21.5.2026	Për përcaktimin e termave dhe kushteve për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme..... 10728
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 9, datë 2.6.2026	Për përcaktimin e procedurave të njësimit të diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, lëshuar nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuara në Republikën e Shqipërisë..... 10731
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 348, datë 14.5.2026	Mbi zbatimin e vendimit nr. 231, datë 1.4.2026, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”..... 10734

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 351, datë 14.5.2026	Për miratimin e përbërjes së komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë dhe komisioneve mjekësore të përcaktimit të verbërisë, të nivelit të parë dhe epror, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara.....	10742
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 564, datë 21.5.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin e ministrit nr. 113, datë 15.3.2022, “Për miratimin e rregullores për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, të ndryshuar.....	10743
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 571, datë 22.5.2026	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël.....	10755
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 575, datë 25.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës.....	10756
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 576, datë 25.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar.....	10757
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 577, datë 25.5.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 231, datë 4.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.....	10760
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 579, datë 28.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	10761
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 580, datë 28.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	10762
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 581, datë 28.5.2026	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 432, datë 21.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”....	10765
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 582, datë 28.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	10765
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 594, datë 29.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	10767
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 2.4.2026	Me objekt shfuqizimin pjesërisht të vendimeve nr. 18, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin është ndryshuar vendimi nr. 36, datë 31.5.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1823 (281), datë 14.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me deklarinimin fajtor dhe dënimin e kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	10769

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 117, datë 24.4.2026	Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.....	10785
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 118, datë 24.4.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	10787
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 6.5.2026	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla.	10788
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 532/6, datë 2.6.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Zgjerimi i rrugës Elbasan–Qafëthanë (faza 1)”	10795
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 1271, datë 12.3.2026	Për shpalljen të zhdukur të shtetasit Spiro Jaçaj.....	10797



VENDIM
Nr. 85/2026

PËR CAKTIMIN E KRYESIVE TË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, duke u mbështetur në listat e kandidatëve, të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit është si më poshtë:

Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe Financat:

1. Milva Ekonomi	kryetare	PS
2. Erion Braçe	zëvendëskryetar	PS
3. Enno Bozdo	zëvendëskryetar	PD
4. Zamira Sinaj	sekretare	PS

Komisioni për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike:

1. Ulsi Manja	kryetar	PS
2. Damian Gjikhuri	zëvendëskryetar	PS
3. Oerd Bylykbashi	zëvendëskryetar	PD
4. Aurora Mara	sekretare	PS

Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes:

1. Bledar Çuçi	kryetar	PS
2. Olta Xhaçka	zëvendëskryetare	PS
3. Klevis Balliu	zëvendëskryetar	PD
4. Ilirjan Pendavinji	sekretar	PS

Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe Sportet:

1. Luçiano Boçi	kryetar	PD
2. Evis Kushi	zëvendëskryetare	PS
3. Hatixhe Konomi	sekretare	PS

Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale:

1. Bardh Spahia	kryetar	PD
2. Eduard Shalsi	zëvendëskryetar	PS
3. Enriketa Jaho	sekretare	PS

Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastruktura dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm:

1. Anila Denaj	kryetare	PS
2. Ceno Klosi	zëvendëskryetar	PS
3. Blend Himçi	zëvendëskryetar	PD
4. Ilva Gjuzi	sekretare	PS

Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik:

1. Jorida Tabaku	kryetare	PD
2. Iris Luarasi	zëvendëskryetare	PS
3. Ardit Bido	sekretar	PS

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural:

1. Blendi Klosi	kryetar	PS
2. Fadil Nasufi	zëvendëskryetar	PS
3. Xhelal Mziu	zëvendëskryetar	PD
4. Saimir Hasalla	sekretar	PS

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën:

1. Ina Zhupa	kryetare	PD
2. Erion Malaj	zëvendëskryetar	PS
3. Arkend Balla	sekretar	PS

Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme:

1. Igli Hasani	kryetar	PS
2. Bora Muzhaqi	zëvendëskryetare	PS
3. Albana Vokshi	zëvendëskryetare	PD
4. Marjana Koçeku	sekretare	PS

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale:

1. Fatmir Xhafaj	kryetar	PS
2. Ermal Elezi	zëvendëskryetar	PS
3. Ivi Kaso	zëvendëskryetar	PD
4. Bledi Çomo	sekretar	PS

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE
Klodiana Spahiu

Miraturar në datën 1.6.2026.



**VENDIM
Nr. 86/2026**

**PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

I. Përbërja e anëtarësisë së komisioneve të përherëshme të Kuvendit është si më poshtë:

**Komisioni për Ekonominë, Punësimin dhe
Financat:**

1. Admir Kadeli	PS
2. Adi Qose	PS
3. Elton Korreshi	PS
4. Antoneta Dhima	PS
5. Briseida Çakërri	PS
6. Bujar Leskaj	PD
7. Ledina Alolli	PL
8. Igli Cara	PD
9. Besart Xhaferi	PD

**Komisioni për Çështjet Ligjore dhe
Administratën Publike:**

1. Ermal Pacaj	PS
2. Olsi Komici	PS
3. Zegjine Çausi	PS
4. Ani Dymishi	PS
5. Aulona Bylykbashi	PS
6. Gent Strazimiri	PD
7. Saimir Korreshi	PD
8. Arian Ndoja	PD
9. Tedi Blushi	PL
10. Tedi Mula	Jashtë grupeve parlamentare

**Komisioni për Çështjet e Brendshme dhe të
Mbrojtjes:**

1. Hysen Buzali	PS
2. Agron Malaj	PS
3. Bujar Rexha	PS
4. Aurora Mara	PS
5. Elisa Spiropali	PS
6. Flamur Noka	PD
7. Isuf Çelaj	PD
8. Fatmir Mediu	Aleanca për Ndryshim
9. Erald Kapri	Jashtë grupeve parlamentare
10. Besnik Brahimi	Jashtë grupeve parlamentare

**Komisioni për Edukimin, Shkencën dhe
Sportet:**

1. Ogerta Manastirliu	PS
2. Alma Selami	PS
3. Ana Nako	PS
4. Lindita Nikolla	PS
5. Zamira Sinaj	PS
6. Luan Baçi	PD
7. Kastriot Piroli	PD
8. Brunilda Haxhiu	PL

**Komisioni për Shëndetësinë dhe Mirëqenien
Sociale:**

1. Vasil Llajo	PS
2. Ani Dymishi	PS
3. Asfloral Haxhiu	PS
4. Hysen Buzali	PS
5. Ilir Pendavinji	PS
6. Manjola Luku	PD
7. Zija Ismaili	Aleanca për Ndryshim
8. Mesila Doda	Jashtë grupeve parlamentare
9. Erisa Xhixho	PL

**Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastruk-
turën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm:**

1. Klevis Jahaj	PS
2. Orinaldo Rakipi	PS
3. Vullnet Sinaj	PS
4. Besa Spaho	PS
5. Piro Vëngu	PS
6. Kliti Hoti	PD
7. Fidel Kreka	Aleanca për Ndryshim
8. Klodiana Çapja	PL
9. Redi Muçi	Jashtë grupeve parlamentare


Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik:

1. Ramion Kurti	PS
2. Etleva Budini	PS
3. Kiduina Zaka	PS
4. Piro Dhima	PS
5. Arbjan Mazniku	PS
6. Gazment Bardhi	PD
7. Edi Paloka	PD
8. Greta Bardeli	Aleanca për Ndryshim

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural:

1. Agron Gaxho	PS
2. Genti Lakollari	PS
3. Tërmet Peçi	PS
4. Orlando Rakipi	PS
5. Ramadan Likaj	PD
6. Flamur Hoxha	PD
7. Bledion Nallbati	PD
8. Shkurt Lasku	Jashtë grupeve parlamentare
9. Artan Luku	Aleanca për Ndryshim

Komisioni për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën:

1. Xhenis Çela	PS
2. Loer Kume	PS
3. Skënder Pashaj	PS
4. Ramion Kurti	PS
5. Briseida Çakërrri	PS
6. Agron Gjekmarkaj	PD
7. Jozefina Topalli	PD
8. Denisa Vata	Aleanca për Ndryshim
9. Ana Dajko	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Evropën dhe Punët e Jashtme:

1. Sara Mila	PS
2. Ervin Hoxha	PS
3. Romina Kuko	PS
4. Taulant Balla	PS
5. Klodiana Spahiu	PS
6. Tritan Shehu	PD
7. Tomor Alizoti	PD
8. Edmond Haxhinasto	PL
9. Vangjel Dule	Aleanca për Ndryshim
10. Agron Shehaj	Jashtë grupeve parlamentare

Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale:

1. Erjo Mile	PS
2. Onid Bejleri	PS
3. Saimir Hasalla	PS
4. Evis Kushi	PS
5. Belind Këlliçi	PD
6. Elda Hoti	PD
7. Gjin Gjoni	PD
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.	

ZËVENDËSKRYETARE
Klodiana Spahiu

Miratuar në datën 1.6.2026.

VENDIM
Nr. 87/2026

PËR KAKTIMIN E ANËTARËVE
ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN
E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21/1 dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Ekonominë, Punësimin dhe Financat, janë si më poshtë:

1. Aulona Bylykbashi	PS;
2. Ceno Klosi	PS;
3. Ermal Pacaj	PS;
4. Flamur Hoxha	PD;
5. Luan Baçi	PD;
6. Edmond Haxhinasto	PL.

II. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Administratën Publike janë si më poshtë:



1. Bledi Çomo PS;
2. Xhenis Çela PS;
3. Erjo Mile PS;
4. Arkend Balla PS;
5. Skënder Pashaj PS;
6. Greta Bardeli Aleanca për Ndryshim;
7. Gjijn Gjoni PD.

III. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Çështjet e Brendshme dhe të Mbrojtjes janë si më poshtë:

1. Romina Kuko PS;
2. Arkend Balla PS;
3. Ardit Bido PS;
4. Agron Gaxho PS;
5. Antoneta Dhima PS;
6. Pirro Vëngu PS;
7. Kastriot Piroli PD;
8. Fidel Kreka Aleanca për Ndryshim;
9. Agron Shehaj Jashtë grupeve parlamentare.

IV. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Edukimin, Shkencën dhe Sportet janë si më poshtë:

1. Etleva Budini PS;
2. Erjo Mile PS;
3. Besart Xhaferi PD;
4. Ledina Alolli PL.

V. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale janë si më poshtë:

1. Olta Xhaçka PS;
2. Loer Kume PS;
3. Klodiana Spahiu PS;
4. Tritan Shehu PD;
5. Kliti Hoti PD.

VI. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm janë si më poshtë:

1. Bora Muzhaqi PS;
2. Hatixhe Konomi PS;
3. Antoneta Dhima PS;
4. Belind Këlliçi PD;
5. Bledion Nallbati PD;
6. Artan Luku Aleanca për Ndryshim.

VII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik janë si më poshtë:

1. Sara Mila PS;
2. Alma Selami PS;
3. Andi Qose PS;
4. Romina Kuke PS;
5. Elda Hoti PD;
6. Arian Ndoja PD;
7. Agron Gjonmarkaj PD.

VIII. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural janë si më poshtë:

1. Ana Nako PS;
2. Kiduina Zaka PS;
3. Ilirjan Pendavinji PS;
4. Igli Cara PD;
5. Saimir Korreshi PD.

IX. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Kulturën, Turizmin dhe Diasporën janë si më poshtë:

1. Evis Kushi PS;
2. Admir Kadeli PS;
3. Marjana Koçeku PS;
4. Bujar Rexha PS;
5. Klodiana Çapja PL;
6. Besart Xhaferi PD.

X. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Evropën dhe Punët e Jashtme janë si më poshtë:

1. Iris Luarasi PS;
2. Skënder Pashaj PS;
3. Vasil Llajo PS;
4. Kiduina Zaka PS;
5. Adi Qose PS;
6. Erion Malaj PS;
7. Mesila Doda Jashtë grupeve parlamentare;
8. Igli Cara PD;
9. Brunilda Haxhiu PL;
10. Erald Kapri Jashtë grupeve parlamentare.

XI. Anëtarët zëvendësues në përbërje të Komisionit për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale janë si më poshtë:



1. Erion Malaj PS;
2. Ilva Gjuzi PS;
3. Romina Kuko PS;
4. Pirro Vëngu PS;
5. Fatmir Mediu Aleanca për Ndryshim;
6. Gent Strazimiri PD;
7. Erisa Xhixho PL.

XII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDESKRYETARE
Klodiana Spahiu

Miratuar në datën 1.6.2026.

UDHËZIM
Nr. 2, datë 21.5.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE TË
NDËRHYRJES NGA MINISTRIA
PËRGJEGJËSE PËR TRASHËGIMINË
KULTURORE NË RASTET E
MOSBATIMIT TË DETYRIMEVE NGA
PRONARI OSE POSEDUESI I PASURISË
KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 9 të nenit 92, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton mënyrat e ndërhyrjes së ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, në rastet kur pronari ose poseduesi i pasurisë kulturore nuk përmbush detyrimet ligjore për realizimin e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

2. Qëllimi i këtij udhëzimi është garantimi i ruajtjes fizike të pasurive kulturore, parandalimi i degradimit të mëtejshëm të tyre, përcaktimi i procedurave administrative dhe teknike për ndërhyrjen e ministrisë, në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe mbrojtja e interesit publik, në funksion të ruajtjes dhe të mbrojtjes të vlerave të trashëgimisë kulturore.

3. Ndërhyrje të detyruara në pasuri kulturore konsiderohen rastet kur ka ndodhur ose kur kërkohet të parandalohet:

- a) shembjet;
 - b) dëmtim strukturor që rrezikon stabilitetin e objektit;
 - c) fatkeqësi natyrore;
 - d) veprime që shkaktohen nga individ.
4. Ndërhyrja e detyruar nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore kryhet kur subjekti privat, që kanë në pronësi ose në posedim pasuri kulturore:

a) nuk ka dorëzuar për miratim në KKTKM projektin dhe preventivin e ndërhyrjeve brenda afatit të përcaktuar nga DRTK-ja;

b) ka marrë miratimin e KKTKM-së, por nuk ka filluar zbatimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar.

5. Ndërhyrja realizohet nëpërmjet disa formave:

a) Ndërhyrjet me emergjencë të lartë dhe kompleksitet të ulët, kryhen nga punonjësit e DRTK-së, mbi bazën e projektit të miratuar nga KKTKM-ja, dhe bëjnë pjesë në tipologjinë e mëposhtme:

- i. skeleri emergjente;
- ii. pajantim;
- iii. stabilizim strukturor;
- iv. mbulim i përkohshëm;
- v. evakuim i elementeve me vlerë;
- vi. ruajtje fizike e përkohshme;
- vii. izolim nga lagështira;
- viii. ndërtim perimetër sigurie;

ix. çdo ndërhyrje tjetër e cila konsiderohet e nevojshme për ruajtjen e stabilitetit të pasurisë kulturore, që nuk është përmendur më sipër.

b) Ndërhyrjet me volum të konsiderueshëm, me kompleksitet të lartë, me kërkesa specifike teknike, realizohen nga subjekte private të licencuara. Përzgjedhja e subjekteve të licencuara bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Në rastet kur pronari ose poseduesi nuk ka përmbushur detyrimet e parashikuara në pikën 4 të këtij udhëzimi, procedura vijon si më poshtë:

a) Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore njofton, brenda 10 ditëve punë, ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore mbi rastin e mosrealizimit të detyrimeve të pronarit, duke përcaktuar:

- i. natyrën e rrezikut dhe shkallën e emergjencës;
- ii. kompleksitetin e punimeve;
- iii. kërkesat teknike dhe projektin e miratuar nga KKTKM-ja (kur ka projekt);



iv. kopje të njoftimeve drejtuar pronarit apo poseduesit të pasurisë;

b) në rastin kur ndërhyrja mund të realizohet nga DRTK-ja, ajo kërkon dhe autorizimin për hapjen e procedurës;

c) Struktura përgjegjëse e trashëgimisë kulturore shqyrton dokumentacionin dhe ka të drejtë brenda 5 (pesë) ditëve pune, të kërkojë nga DRTK-ja plotësimin e dokumentacionit;

d) Pas plotësimit të dokumentacionit, struktura përgjegjëse për trashëgiminë kulturore përgatit një relacion informues për ministrin, brenda 7 ditë pune;

e) Ministri miraton fillimin e procedurës, duke përcaktuar:

i. Burimin e financimit;

ii. Strukturat e ngarkuara me zbatim.

7. Burimi i financimit për ndërhyrjet e detyruara ruajtëse janë:

a) Buxheti i shtetit;

b) Fondi Kombëtar i Kujdesit për Trashëgiminë Kulturore Materiale;

c) Çdo burim tjetër i ligjshëm.

8. Zbatimi, mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

9. Shpenzimet e ndërhyrjeve të detyruara ruajtëse shlyhen dhe i ngarkohen pronarit dhe poseduesit, sipas parashikimeve të nenit 93 dhe 94, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, si dhe pronarët ose poseduesit e pasurive kulturore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

UDHËZIM

Nr. 3, datë 21.5.2026

PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, KRITEREVE, PROCEDURAVE, MËNYRAVE, KOHËZGJATJES DHE TARIFAVE, PËR DHËNIEN E MIRATIMIT TË INTERESIT KULTUROR TË VEPRIMTARIVE KULTURORE DHE ÇDO INICIATIVE TJETËR ME KARAKTER KULTUROR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të nenit pikës 3, të nenit 100, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve, kriterëve, procedurave, mënyrave, kohëzgjatjes dhe tarifave për dhënie të miratimit të interesit kulturor për veprimtaritë kulturore dhe çdo iniciativë tjetër me karakter kulturor në pasuritë kulturore dhe zonat e mbrojtura si pasuri kulturore, në kuptim të ligjit nr. 27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi “zona të mbrojtura si pasuri kulturore” janë ansamblet historike urbane, parqe arkeologjike, qendra historike; zonë arkeologjike sipas përcaktimeve të nenit 5, ligjit nr. 27/2018.

3. Në pasuritë kulturore dhe zonat e mbrojtura si pasuri kulturore mund të zhvillohen aktivitetet, si vijon:

a) Aktivitetet artistike:

i. koncerte muzikore (klasike, moderne, folklorike);

ii. shfaqje teatrore dhe performanca skenike;

iii. ekspozita arti (pikturë, skulpturë, instalacione, art bashkëkohor);

iv. festivale artistike (muzikë, film, letërsi, folklor);

v. recitale, performancë art, balet e vallëzim.

b) Aktivitetet kulturore:

i. aktivitete promovuese të trashëgimisë (prezantime, ekspozita të objekteve muzeale jashtë vitrinave etj.);

ii. panaire me karakter kulturor, artizanati ose produkte tradicionale;



iii. ceremoni kulturore (përvjetorë, homazhe, aktivitete përkujtimore);

iv. festime tradicionale dhe rituale komunitare;

v. turizëm kulturor i organizuar (vizita të udhëhequra, aktivitete interpretimi kulturor).

c) Aktivitetet shkencore dhe edukative:

i. konferenca, simpoziume dhe *workshope* shkencore;

ii. prezantime shkencore të lidhura me trashëgiminë;

iii. prezantime studimore, diskutime akademike;

iv. aktivitete edukative për fëmijë dhe të rinj (punëtori arti, programe edukimi; kulturor).

d) Aktivitetet audiovizive:

i. xhirime filmike, dokumentarë, reklama ose projekte televizive;

ii. regjistrime muzikore dhe projekte multimediale në hapësira kulturore.

e) Aktivitetet komunitare me karakter kulturor:

i. takime komunitare për ruajtjen dhe promovimin e traditave;

ii. aktivizime qytetare me tematikë kulturën ose trashëgiminë.

4. Miratimi i interesit kulturor ose shkencor jepet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Veprimtaria duhet të ketë karakter kulturor, shkencor, edukues, artistik ose promovues dhe të kontribuojë drejtpërdrejt në vlerësimin, interpretimin ose promovimin e pasurisë kulturore;

b) Veprimtaria nuk duhet të cenojë integritetin fizik, vizual, arkeologjik dhe historik apo simbolik të pasurisë kulturore, si dhe nuk duhet të krijojë rrezik dëmtimi, apo pasoja të pakthyeshme;

c) Veprimtaria duhet të jetë në përputhje me veprimtaritë e parashikuara në planin e menaxhimit të pasurisë kulturore kur një të tillë ekziston;

d) Veprimtaria duhet të zhvillohet brenda kufijve dhe rregullave të përcaktuara në planet e ruajtjes të miratuara të pasurive kulturore;

e) Subjekti duhet të paraqesë një plan masash të detajuar për mbrojtjen e pasurisë gjatë përgatitjes, zhvillimit dhe përfundimit të aktivitetit;

f) Duhet të paraqitet një vlerësim risku, që identifikon rreziqet e mundshme dhe përfshin masa të qarta të menaxhimit të sigurisë, duke garantuar mbrojtjen e pasurisë dhe pjesëmarrësve;

g) Pajisjet teknike, elementet skenografike, ndriçimi, sistemi i zërit dhe çdo strukturë e përkohshme duhet të jenë të projektuara, vendosur dhe përdorur, në mënyrë të tillë që të mos

shkaktojnë ndikime negative fizike, vizuale ose mjedisore mbi pasurinë kulturore.

5. Subjektet që plotësojnë kushtet për miratimin, vlerësimin e interesit kulturor ose shkencor për veprimtaritë kulturore dhe çdo iniciativë tjetër me karakter kulturor në pasuritë kulturore janë, si vijon:

a) Kriteret kulturore ose shkencore:

i. rëndësinë e aktivitetit për publikun;

ii. ndikimin në promovimin e trashëgimisë;

iii. nivelin artistik dhe profesional.

b) Kriteret e mbrojtjes së pasurisë:

i. ekspozimin e pasurisë kulturore ndaj rrezikut të dëmtimit gjatë zhvillimit të aktivitetit;

ii. ndjeshmërinë arkeologjike të zonës aktivitetit;

iii. përshtatshmëria e pajisjeve teknike/ndihmëse që do të përdoren, me qëllim për të parandaluar dëme;

iv. menaxhimi i fluksit dhe siguria për kontrollin e lëvizjes së pjesëmarrësve (fluksit) dhe garantimin e sigurisë fizike të pasurisë dhe njerëzve.

c) Kriteret e kapaciteteve organizative:

i. përvoja e organizatorit;

ii. masat e parashikuara për emergjencë.

6. Çdo subjekt i interesuar për zhvillimin e aktiviteteve sipas këtij udhëzimi për vlerësimin teknik dhe administrativ të aktivitetit dhe miratimin e interesit kulturor dhe shkencor, në rastet kur aktiviteti parashikon ndërtimin/montimin e strukturave të përkohshme në pasurinë kulturore, duhet të paraqesë projektin e miratuar në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM), sipas përcaktimeve të nenit 77 të ligjit nr. 27/2018, i ndryshuar.

7. Çdo subjekt i interesuar 15 ditë pune përpara zhvillimit të aktivitetit paraqet aplikimin përmes platformës elektronike *e-Albania*, sipas aneksit nr. 1.

8. Shqyrtimit dhe miratimi i kërkesës kryhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) Drejtoria përgjegjëse e trashëgimisë kulturore brenda 5 ditë pune nga aplikimi verifikon, nëse aplikimi dhe dokumentacioni shoqërues është në përputhje me aneksin nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

b) Në rast se konstatohet se dokumentacioni i depozituar nuk është i plotë, të struktura përgjegjëse cakton 5 ditë pune kohë për plotësimin e dokumentacionit nga subjekti aplikues.

c) Struktura përgjegjëse shqyrton kërkesën dhe vlerëson dokumentacionin brenda 5 ditëve pune nga depozitimi i dokumentacionit të plotë. Nëse e



vlerëson të nevojshme, gjatë afatit të shqyrtimit, kjo strukturë kryen edhe inspektimin në terren.

d) Procedura e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës përfundon me urdhrin e titullarit të institucionit, i cili përmban:

- i. subjektin që ka paraqitur kërkesën;
- ii. objektin e aktivitetit që do të zhvillohet;
- iii. përshkrimin e aktivitetit dhe programin që do të zhvillohet;
- iv. kushtet për ruajtjen e pasurisë kulturore;
- v. afatin e vlefshmërisë, duke përcaktuar datat e fillimit dhe mbarimit të aktivitetit;
- vi. strukturën përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të detyrimeve.

9. Detyrimet e subjektit:

- i. të zbatojë plotësisht planin e miratuar;
- ii. të mos prekë/cenojë pasurinë;
- iii. të ndërpresë aktivitetin në rast rreziku;
- iv. të raportojë incidentet;
- v. të rikthejë gjendjen;
- vi. të lejojë monitorimin nga ekspertët;
- vii. të mos transferojë miratimin në palë të treta.

10. Llogaritja e tarifës, për dhënien e interesit kulturor ose shkencor të veprimtarive kulturore dhe të çdo iniciativë tjetër me karakter kulturor, bazohet në parashikimet e udhëzimit “Për përcaktimin e tarifave të përdorimit të pasurive kulturore në

administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore”.

11. Ministri mund të revokojë miratimin e dhënë nëse gjatë zhvillimit të aktivitetit të miratuar konstatohet se organizatori:

- a) Shkel detyrimet e tij sipas urdhrit për miratimin e aktivitetit;
- b) Kryen veprime që rrezikojnë pasurisë;
- c) Devijon nga veprimtaria e miratuar;
- d) Nëse gjatë zhvillimit të veprimtarisë shkaktohet dëm pasurisë kulturore, ky dëm i ngarkohet subjektit, të cilit i është miratuar veprimtaria kulturore dhe në rast të konstatimit të shkeljeve të detyrimeve shoqërohet edhe me ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarisë.

12. Ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, struktura përgjegjëse dhe çdo subjekt publik ose privat, që kërkon të zhvillojë veprimtari kulturore ose shkencore dhe çdo iniciativë tjetër me karakter kulturor, në pasuritë kulturore, apo zonat e mbrojtura, si pasuri kulturore, ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE
SPORTIT
Blendi Gonxhja

ANEKS I

FORMULAR APLIKIMI PËR MIRATIMIN E INTERESIT KULTUROR/SHKENCOR

1. Të dhënat e aplikantit

Emri i plotë i subjektit/organizatës: _____
 Numri i regjistrimit ligjor (për subjektet juridike): _____
 Adresa e zyrës së regjistruar: _____
 Adresa për korrespondencë: _____
 Numri i telefonit: _____
 Email: _____
 Personi përgjegjës për aktivitetin: _____

2. Përshkrimi i veprimtarisë

Emri i aktivitetit: _____
 Lloji i aktivitetit (shënoni me X):
 - Artistik
 - Kulturore
 - Shkencore
 - Edukative
 - Audiovizive



- Komunitare (përshkrim i detajuar i aktivitetit)

Qëllimi kryesor dhe kontributi për pasurinë kulturore:

Data dhe koha e zhvillimit: _____

Vendndodhja/pasuria kulturore ku do zhvillohet:

3. Plani i veprimtarisë

Harta/plan-vendosja e aktiviteteve (skena, platforma, pajisje, strukturat ndihmëse):

Numri i pjesëmarrësve i parashikuar: _____

Programi i aktivitetit (orari i detajuar):

4. Siguria dhe menaxhimi i riskut

- Plani i masave mbrojtëse: _____

- Vlerësimi i riskut (rreziqet dhe masat e parashikuara):

- Masat për emergjenca dhe evakuim:

- Pajisjet dhe strukturat ndihmëse:

(Shënoni pajisjet e përdorura: skena, ndriçim, foni, strukturë e përkohshme, të tjera)

- Personeli përgjegjës për sigurinë dhe trajnimet e tij:

5. Përputhshmëria me planin e menaxhimit

- A ekziston një plan menaxhimi i pasurisë kulturore? Po Jo

- Nëse po, përshkrimi i harmonizimit të veprimtarisë me planin: _____

6. Dokumentacioni i bashkangjitur (shënoni me X dokumentet e bashkëngjitura)

- Kërkesa zyrtare

- Plan-vendosja/Harta

- Plani i sigurisë

- Plani i masave mbrojtëse

- Vlerësimi i riskut

- Deklarata e përgjegjësisë

- Dokumenti i pagesës së tarifës

- Kontrata e sigurimit (kur kërkohet)



7. Deklarata e aplikantit

Deklaroj se të gjitha informacionet e dhëna janë të sakta dhe se do të respektoj të gjitha kushtet e miratimit dhe masat e sigurisë gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Emri dhe mbiemri: _____

Data: _____

Nënshkrimi: _____

UDHËZIM

Nr. 4, datë 21.5.2026

PËR PËRCAKTIMIN E TERMAVE DHE KUSHTEVE PËR KATEGORIZIMIN E VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të nenit 53, dhe shkronjës “a” të nenit 268, të ligjit nr. 27, datë 17.5.2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i termave dhe i kushteve për kategorizimin e vlerave kulturore të paluajtshme, në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, i ndryshuar.

2. Për qëllim të këtij udhëzimi “Vlerë kulturore” është dëshmia materiale e jomateriale e pranisë dhe e veprimtarisë njerëzore, fenomene apo peizazhe, të cilat janë të rëndësishme për individin, komunitetin apo shoqërinë si një e tërë dhe kanë vlerë shkencore apo kulturore; dëshmia materiale ose jomateriale e pranisë dhe veprimtarisë njerëzore, e cila është domethënëse për institucionet fetare të regjistruara; fragmente të objekteve arkeologjike, etnografike apo objekteve të tjera, që janë të fragmentarizuara, të cilat përbëjnë një pjesë të vogël të autenticitetit të objektit origjinal, që janë dëmtuar në masë të madhe, pa ndonjë vlerë të rëndësishme kulturore, shkencore ose artistike, dhe pjesa më e madhe e tyre mund të përkufizohet si materiale, kur janë pjesë e fondeve muzeore.

II. TERMAT PËR KATEGORIZIMIN E VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Termat e përcaktuar në këtë kre përdoren për kategorizimin e vlerave kulturore të pasurive të paluajtshme dhe shërbejnë për të përcaktuar

rëndësinë e tyre në aspektet historike, artistike, shkencore, teknologjike, urbanistike, peizazhore dhe shoqërore. Këto vlera, veçmas ose të ndërthurura, shprehin kuptimin dhe rëndësinë e pasurisë për trashëgiminë kulturore dhe për identitetin historik e kulturor të vendit.

2. Vlerat klasifikohen, si më poshtë:

a) “Vlerë historike” pasqyrojnë lidhjen e pasurisë me ngjarje, procese, personalitete, periudha ose zhvillime që kanë rëndësi për historinë kombëtare, rajonale apo lokale, si dhe për dëshminë e evolucionit të qytetërimit dhe të jetës shoqërore, kur pasuria:

i. lidhet me ngjarje, personalitete ose periudha historike me ndikim në zhvillimin e një komuniteti, rajoni apo të vendit në tërësi;

ii. përfaqëson dëshmi materiale të mënyrës së jetesës, teknologjisë ose organizimit shoqëror të një periudhe të caktuar;

iii. është e lidhur me zhvillimin e fushave të arkeologjisë, arkitekturës, peizazhit kulturor, trashëgimisë industriale ose bujqësore;

iv. përmban vlera dokumentuese që kontribuojnë në kuptimin e historisë lokale ose kombëtare.

b) “Vlerë artistike” përfshin cilësitë estetike, përbërjen formale, stilin arkitektonik, zbukurimin, mjeshtërinë e realizimit dhe shprehjen krijuese që e dallon pasurinë për veçantinë e saj, kur pasuria:

i. përfaqëson një nivel të lartë krijimtarie artistike ose mjeshtërie ndërtimore;

ii. shfaq tipare stilistike karakteristike për një periudhë, shkollë ose autor të veçantë;

iii. përbën shembull përfaqësues të estetikës tradicionale, arkitekturës popullore ose artizanatit lokal;

iv. kontribuon në zhvillimin e koncepteve artistike ose arkitektonike në nivel kombëtar apo rajonal.

c) “Vlera shkencore dhe teknologjike” përfaqëson rëndësinë e pasurisë për kërkimin, studimin dhe kuptimin e zhvillimeve në fushat e



historisë, arkeologjisë, arkitekturës, teknologjisë, inxhinierisë dhe disiplinave të tjera shkencore, kur pasuria:

- i. përmban të dhëna me rëndësi për studime historike, arkeologjike, arkitektonike ose teknike;
- ii. ka potencial të lartë për kërkime shkencore ose për ruajtjen dhe transmetimin e njohurive tradicionale;
- iii. dëshmon zhvillimin e njohurive dhe praktikave teknologjike ose ndërtimore, tradicionale apo inovative;
- iv. ruan materiale, teknika ose metoda ndërtimi origjinale e përfaqësuese për periudhën e krijimit të saj.

d) “Vlerë urbane dhe e peizazhit”, lidhet me marrëdhënien e pasurisë me mjedisin përreth, integrimin në strukturën urbane, harmoninë vizuale dhe historike me peizazhin kulturor ose natyror ku ndodhet, kur pasuria:

- i. është pjesë përbërëse e një ansambli ose strukture historike urbane me vlera të njohura;
- ii. ndikon në formimin e identitetit vizual të peizazhit kulturor ose natyror;
- iii. përmban elemente që sigurojnë lidhje të lexueshme ndërmjet trashëgimisë dhe mjedisit përreth;
- iv. kontribuon në ruajtjen e karakterit të vendbanimeve tradicionale ose të ansambleve historike.

e) “Vlerë shoqërore” pasqyron domethënien që pasuria ka për komunitetin si simbol identitar, si vend kujtese kolektive, si qendër fetare, rituale ose shpirtërore, apo si pjesë e traditave dhe praktikave të trashëguara, kur pasuria:

- i. është e lidhur me tradita, rite, besime ose kujtesë historike të komunitetit;
- ii. përfaqëson vendndodhje me funksione fetare ose shpirtërore të njohura;
- iii. përbën element identifikues të historisë ose kulturës së një grupi shoqëror; nxit ndjenjën e përkatësisë dhe vazhdimësisë kulturore në nivel komunitar.

f) Termi “Vlerë e rrallësisë” lidhet me shkallën e unikalitetit dhe përfaqësueshmërisë që paraqet pasuria e paluajtshme në raport me pasuri të tjera të ngjashme, sipas tipit, stilit, teknikës, ndërtuesit, periudhës historike apo rajonit. Kjo vlerë tregon nivelin e veçantisë së pasurisë në kontekst lokal, kombëtar apo ndërkombëtar dhe lidhet ngushtë me vlerat historike, artistike e teknike. Një shkallë e lartë

rrallësie rrit rëndësinë e pasurisë dhe mund të shërbejë si bazë për vlerësim në kuadër të kritereve të trashëgimisë botërore, kur pasuria:

- i. është një nga pak shembujt e mbetur të një tipi, stili ose teknike të caktuar;
- ii. përfaqëson një variant unik ose të rrallë në nivel lokal, rajonal apo kombëtar;
- iii. përmban elemente që nuk përsëriten në pasuri të tjera të ngjashme;
- iv. ruan nivel të lartë autenticiteti në formë, material dhe funksion;
- v. ka rëndësi për dokumentimin e një periudhe, rryme ose procesi që është zhdukur ose përfaqësohet në mënyrë të kufizuar në dëshmi të tjera materiale.

3. Cilësitë që përcaktojnë gjendjen dhe qëndrueshmërinë e vlerave kulturore të pasurisë së paluajtshme janë:

a) Autenticiteti, është cilësia që tregon vërtetësinë dhe origjinalitetin e një pasurie kulturore, kur vlerat e saj historike, artistike, shkencore apo shoqërore shprehen në mënyrë të besueshme përmes formës, materialeve, funksionit, teknikave të ndërtimit, vendndodhjes dhe traditave. Ai dëshmon ruajtjen e identitetit origjinal dhe të lidhjes me kontekstin historik e kulturor të krijimit të saj. Në varësi të tipologjisë së pasurisë dhe të kontekstit të saj historiko-kulturor, një pasuri vlerësohet si autentike, nëse vlerat që mbart shprehen në mënyrë të vërtetë dhe të besueshme përmes një grupi atributash, që përfshijnë:

- i. formën dhe dizajnin;
- ii. materialet;
- iii. përdorimin dhe funksionin;
- iv. traditat, teknikat dhe sistemet e menaxhimit;
- v. vendndodhjen dhe mjedisin;
- vi. gjuhën dhe format e tjera të trashëgimisë jomateriale;
- vii. faktorë të tjerë të brendshëm ose të jashtëm që ndikojnë në ruajtjen e vlerave.

b) Integriteti është gjendja në të cilën një pasuri kulturore ruan tërësinë dhe koherencën funksionale dhe kontekstuale, duke mundur shprehjen e plotë të vlerave që ajo mbart. Vlerësimi i kushteve të integritetit kërkon shqyrtimin e shkallës në të cilën pasuria kulturore:

- i. përfshin të gjithë elementet e nevojshme për të shprehur vlerën e saj kulturore;



ii. ka përmasa të mjaftueshme për të siguruar përfaqësimin e plotë të tipareve dhe proceseve që përcjellin rëndësinë e saj;

iii. nuk është dëmtuar nga ndikime të pafavorshme që vijnë si pasojë e zhvillimit, ndërhyrjeve jo të përshtatshme dhe/ose mungesës së kujdesit për ruajtjen e saj.

c) Ekzistenca e një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi nënkupton sigurimin e kushteve që garantojnë ruajtjen dhe forcimin e vlerave kulturore, autenticitetit dhe integritetit të pasurisë me kalimin e kohës.

Vlerësimi i ekzistencës së një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi, kërkon:

i. legjislacion dhe mbrojtje institucionale afatgjatë;

ii. kufij të qartë dhe, nëse është e nevojshme, zonë të mbrojtur (tampon);

iii. plan ose sistem menaxhimi që garanton ruajtjen për brezat e ardhshëm;

iv. përfshirje të komuniteteve lokale dhe popujve autoktonë në proceset e menaxhimit;

v. vlerësime të ndikimit mjedisor dhe të trashëgimisë për çdo zhvillim të propozuar;

vi. përfshirje të elementeve të qëndrueshmërisë, përfshirë përballimin e ndryshimeve klimatike dhe rrezeve.

III. KUSHTET PËR KATEGORIZIMIN E VLERAVE KULTURORE TË PALUAJTSHME

1. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi universale”, kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet si më poshtë:

a) Përbush një ose më shumë nga 6 (gjashtë) kriteret e mëposhtme, sipas Udhëzimeve Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s:

i. përfaqëson një kryevepër të gjeniut krijues njerëzor;

ii. dëshmon një shkëmbim të rëndësishëm të vlerave njerëzore, në një hapësirë kohore ose brenda një zone kulturore, mbi zhvillimet në arkitekturë, teknologji, art monumental, urbanistik ose dizajn peizazhi;

iii. ruan një dëshmi unike ose të jashtëzakonshme për një traditë kulturore ose qytetërim, ende gjallë ose të zhdukur;

iv. është një shembull i jashtëzakonshëm i një ndërtese, kompleksi arkitektonik, teknologjik ose peizazhi që ilustron faza të rëndësishme të historisë njerëzore;

v. është një shembull i jashtëzakonshëm i një vendbanimi tradicional, përdorimi të tokës ose të detit, që përfaqëson një kulturë ose ndërveprimin e njeriut me mjedisin, sidomos kur është bërë i cenueshëm nga ndryshimet e pakthyeshme;

vi. është i lidhur drejtpërdrejt ose në mënyrë të prekshme me ngjarje, tradita të gjalla, ide, besime, vepra artistike ose letrare me rëndësi të jashtëzakonshme universale;

b) Kur pasuria e paluajtshme është e përzier (me vlera kulturore dhe natyrore), kategorizohet “me rëndësi universale” nëse përbush një ose më shumë nga 4 (katër) kriteret e mëposhtme, sipas Udhëzimeve Operacionale për Zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s:

i. përmban fenomene natyrore madhështore ose zona me bukuri natyrore dhe rëndësi estetike të jashtëzakonshme;

ii. është shembull i shquar që përfaqëson etapa kryesore të historisë së Tokës, përfshirë regjistrin e jetës, proceset gjeologjike në zhvillim në formimin e relievit, ose tiparet gjeomorfologjike dhe fiziografike me rëndësi të madhe;

iii. është shembull i shquar që përfaqëson procese të rëndësishme në vazhdim ekologjike dhe biologjike në evolucionin dhe zhvillimin e ekosistemeve tokësore, ujërave të ëmbla, bregdetare dhe detare, si dhe të komuniteteve të bimëve dhe kafshëve;

iv. përmban habitatet natyrore më të rëndësishme dhe më domethënëse për ruajtjen *in-situ* të diversitetit biologjik, përfshirë ato që përmbajnë specie të rrezikuara me vlerë të jashtëzakonshme universale nga këndvështrimi shkencor ose i ruajtjes;

c) Garanton autenticitetin. sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;

d) Garanton kushtet e integritetit, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi;

e) Dëshmon ekzistencën e një sistemi të përshtatshëm mbrojtjeje dhe menaxhimi, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.

2. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi kombëtare” kategorizohet si e tillë, nëse përbush një ose më shumë nga termat, sipas përcaktimeve në pikën 2 dhe 3 të kreut II të këtij udhëzimi.

3. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi lokale” kategorizohet si e tillë, nëse përbush një ose më shumë nga termat sipas përcaktimeve në



pikën 2 dhe 3 të kreut II të këtij udhëzimi, me përjashtim të vlerës së përcaktuar në shkronjën f, të pikës 2, të kreut II të këtij udhëzimi.

4. Vlera e paluajtshme kulturore “me rëndësi për ansamblin” kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet në vijim:

a) mbështet karakteristikat hapësinore dhe tipologjinë arkitektonike të grup-vlerave kulturore të cilave u përket;

b) është pjesë integrale e një grupi vlerash kulturore (qendra historike, ansamble arkitektonike ose urbane, komplekse, qendra të banimit tradicional etj.);

c) kontribuon në ruajtjen e tipologjisë arkitektonike, tërësisë hapësinore dhe karakterit të përgjithshëm të ansamblit;

d) ka vlera të kufizuara individuale, por të rëndësishme për integritetin e grupit ku bën pjesë;

e) garanton autenticitetin dhe integritetin, sipas përcaktimeve të kreut II të këtij udhëzimi.

5. Vlera e paluajtshme kulturore “vetëm për referencë”, kategorizohet si e tillë, nëse plotëson kushtet në vijim:

a) ka vlera individuale të kufizuara, por që ofrojnë informacion të vlefshëm historik, kulturor, shkencor ose dokumentar për zonën ku ndodhet;

b) kontribuon në kuptimin, interpretimin ose kontekstualizimin e vlerave të tjera kulturore të lidhura me të;

c) nuk përmbush kriteret për t’u klasifikuar në kategoritë e tjera, por është e rëndësishme si burim dokumentimi, studimi ose krahasimi;

d) garanton një nivel minimal autenticiteti dhe integriteti, sipas përcaktimeve të kreut II të këtij udhëzimi.

IV. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Ngarkohen ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe Instituti Kombëtar Trashëgimisë Kulturore për zbatimin e këtij udhëzimi.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE
SPORTIT
Blendi Gonxhja

UDHËZIM

Nr. 9, datë 2.6.2026

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË NJËSIMIT TË DIPLOMAVE TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE TË HUAJA OSE TË NGJASHME ME TO, LËSHUAR NGA SHKOLLAT PRIVATE TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, TË LICENCUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 3, të nenit 52, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të përcaktohen procedurat për njësimin e diplomave të institucioneve arsimore të huaja ose të ngjashme me to, lëshuar nga shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuara në Republikën e Shqipërisë.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë kuptimet, si vijon:

a) “Program ndërkombëtar” është programi i arsimit të mesëm të lartë i akredituar nga një organizatë arsimore ndërkombëtare dhe i njohur ndërkombëtarisht;

b) “Institucion ndërkombëtar akreditues/certifikues” është organizata ose enti ndërkombëtar që akrediton ose certifikon programin arsimor dhe provimet përfundimtare;

c) “Njësim diplome” është procesi administrativ i barasvlerësimit të diplomës së një institucioni arsimor të huaj ose të ngjashëm me të, e cila lëshohet në përfundim të një programi të arsimit të mesëm të lartë të zhvilluar në një shkollë private të arsimit të mesëm të lartë, të licencuar në Republikën e Shqipërisë, që zbaton një program arsimor të aprovuar nga institucioni i huaj dhe që është e akredituar nga një institucion arsimor jashtë vendit.

3. Diplomat e institucioneve arsimore të huaja që njihen në Republikën e Shqipërisë, janë:

a) diploma për programin “*International Baccalaureate Diploma Programme (IB DP)*”, i cili zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat që ka statusin “*IB World School*” dhe lëshohet nga *International Baccalaureate Organization*;



b) diploma për programet “*Cambridge International AS & A Level*”, i cili zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat që akreditohet nga *Cambridge International Education*;

c) diploma për programin francez që zhvillohet në institucionin arsimor parauniversitar privat, të akredituar nga Agjencia për Arsimin Francez Jashtë Vendit (AEFE), në përfundim të të cilit jepet diploma “*Diplôme du baccalauréat*”.

4. Institucioni arsimor parauniversitar privat që ofron program ndërkombëtar duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

a) të jetë i licencuar për ushtrimin e veprimtarisë arsimore në fushën e arsimit parauniversitar;

b) të ketë akreditim nga institucioni ndërkombëtar akreditues/certifikues, brenda afatit të vlefshmërisë të përcaktuar nga ky institucion;

c) të zbatojë kurrikulën, sistemin e vlerësimit dhe standardet arsimore të programit ndërkombëtar për të cilin është akredituar/certifikuar;

d) të ketë personel mësimor të kualifikuar sipas kërkesave të programit;

e) të garantojë zhvillimin e provimeve sipas standardeve të sigurisë dhe integritetit, të përcaktuar nga institucioni ndërkombëtar akreditues/certifikues.

5. Institucionet arsimore parauniversitare private të licencuara, të depozitojnë në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe në institucionin përgjegjës për shërbimet arsimore, dokumentacionin provues për plotësimin e kriterëve, sipas pikës 4 të këtij udhëzimi.

6. Aplikimi për njësimin e diplomës kryhet në shërbimin përkatës të platformës qeveritare e-*Albania* dhe përmban formularin e aplikimit që plotësohet *online*. Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:

a) diplomën që kërkon të njësohet në RSH, të shkarkuar nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

b) listën e notave për vitet e kryerjes së arsimit të mesëm të lartë (transkriptin me nota ose dëftesat vjetore) të shkarkuara nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

c) rezultatet e provimeve përfundimtare nëse ka, të shkarkuara nga sistemi SMIP me vulë elektronike;

d) fotokopjen e dokumentit të identifikimit (vetëm për shtetasit e huaj).

7. Njohja e provimeve përfundimtare të programeve ndërkombëtare:

a) Provimet përfundimtare të programeve ndërkombëtare të arsimit të mesëm të lartë, të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, njihen si të barasvlershme me provimet e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë, për efekt të njësimit të diplomës;

b) Për qëllime të njësimit të diplomës, rezultatet e provimeve përfundimtare të përmendura në pikën 3 shërbejnë si bazë për verifikimin dhe barasvlerësimin akademik të arritjeve të nxënësit, pa qenë e nevojshme pjesëmarrja në Maturën Shtetërore;

c) Në përfundim të procedurës së njësimit, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore lëshon aktin administrativ të njësimit të diplomës, i cili konfirmon barasvlerësinë e saj me diplomën e arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë, njësimin e notave me sistemin shqiptar të vlerësimit dhe notën mesatare të studimeve.

8. Procedura e njësimit të diplomës vijon me shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit nga Komisioni i Njohjes së Diplomave në institucionin përgjegjës për shërbimet arsimore. Kur aplikimi është i plotë, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore ngarkon në mënyrë elektronike vërtetimin e njësimit të diplomës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e aplikimit.

9. Në rast konstatimi të mangësive në dokumentacion, institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore njofton aplikantin brenda 3 (tre) ditëve nga data e aplikimit në adresën elektronike të deklaruar prej tij në formular, për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

10. Brenda 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së njoftimit, aplikanti ngarkon në të njëjtin aplikim/ose dërgon në adresën elektronike të institucionit përgjegjës për shërbimet arsimore dokumentacionin plotësues. Institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së dokumentacionit të plotësuar, ngarkon vërtetimin e njësimit të diplomës. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit brenda afatit të përcaktuar, shqyrtimi i aplikimit ndërpritet dhe praktika arkivohet duke njoftuar aplikantin.

11. Vërtetimi i njësimit të diplomës lëshohet sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

12. Vërtetimi i njësimit të diplomës përmban minimalisht elementet e mëposhtme:

a) emrin, atësinë dhe mbiemrin e aplikantit;



b) emërtimin e shkollës private të arsimit të mesëm të lartë të licencuar në Republikën e Shqipërisë që ka lëshuar diplomën;

c) datën e lëshimit të diplomës;

d) notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë;

e) notën mesatare të përgjithshme të njëvlerësuar sipas VKM-së për notën mesatare.

13. Institucioni përgjegjës për shërbimet arsimore është institucioni përgjegjës për mbajtjen dhe përditësimin e regjistrit zyrtar të njësimit të diplomave. Regjistri mbahet në format fizik (*hard copy*) dhe elektronik.

14. Ky shërbim aplikohet në formë shkresore deri në përshtatjen dhe përfundimin e zhvillimeve teknike për pranimin dhe trajtimin *online* të aplikimeve në sistemin *e-Matura*.

15. Nxënësi që studion në institucionin arsimor parauniversitar privat, që ofron program ndërkombëtar mund të kryejë edhe provimet e Maturës Shtetërore dhe nuk pajisen me njësim të diplomës.

16. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si edhe shkollat private të arsimit të mesëm të lartë, që zhvillojnë mësimin edhe në gjuhë të huaj, të licencuara në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

Shtojca nr. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. prot. _____, Tiranë, më _____._____

VËRTETIM NJËSIMI

Vërtetohet njësimi i diplomës së arsimit të mesëm të lartë, për z./znj. _____ (emër atësi mbiemër), (), lëshuar nga _____ (institucioni i arsimit të mesëm të lartë, i licencuar në Republikën e Shqipërisë që ka lëshuar diplomën), më datë _____._____ (data e lëshimit të diplomës), lloji i arsimit të mesëm të lartë _____, nota mesatare e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë _____, notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në Republikën e Shqipërisë, _____, nota mesatare e provimeve të maturës, _____, nota mesatare e përgjithshme e njëvlerësuar sipas VKM-së për notën mesatare.

Bashkëlidhur këtij vërtetim gjendet tabela e konvertimit të notave me maturën shtetërore dhe nota mesatare.

Kjo diplomë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Nota mesatare e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë:		---	(nota me fjalë)
Notat e njëvlershme me provimet e maturës shtetërore në RSh:			
Nota D ₁	Gjuhë shqipe dhe letërsi:	--.---	(nota me fjalë)
Nota D ₂	Matematikë:	--.---	(nota me fjalë)
Nota D ₃	Gjuhë e huaj (--):	--.---	(nota me fjalë)
Nota Z	Lënda me zgjedhje	--.---	(nota me fjalë)
Nota mesatare e provimeve të maturës:		--.---	(nota me fjalë)
Nota mesatare e përgjithshme, e njëvlerësuar:		--.---	(nota me fjalë)

Z./znj. Emër Atësi Mbiemër nuk ka detyrime të Maturës Shtetërore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Faqe | 10733



UDHËZIM

Nr. 348, datë 14.5.2026

**MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 231,
DATË 1.4.2026, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E
FORMAVE TË MBËSHTETJES
NËPËRMJET SUBVENCIONIT PËR
NDËRMARRJET SOCIALE, PËR
PERIUDHËN 2026–2028”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendimit nr. 231, datë 1.4.2026, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”:

UDHËZOJ:

1. Organizatat jofitimprurëse, me status “Ndërmarrje Sociale”, të njohur me urdhrin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, kanë të drejtën e aplikimit për format e mbështetjes, nëpërmjet subvencionit të ndërmarrjeve sociale.

2. Aplikimi bëhet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale (më poshtë në tekst “Ministria”), me anë të një kërkesë, në bazë të thirrjes publike në faqen zyrtare të Ministrisë.

3. Aplikimi shoqërohet me një projekt-propozim si edhe përshkrimin e detajuar të aktiviteteve të projektit. Aplikimi mund të bëhet nga vetë kërkuesi apo çdo person i autorizuar prej tij, sipas “Formularit të aplikimit për financimin e ndërmarrjeve sociale” në aneksin nr. 1, i cili do të publikohet në thirrjen publike në faqen zyrtare të Ministrisë.

4. Aplikimi me shkrim shoqërohet dhe me dokumentacione të tjera shtesë, përkatësisht:

a) Ekstraktin historik të kompanisë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Kopje të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, në rast se organizata e ushtron aktivitetin prej më shumë se një viti dhe formularët e deklarimeve dhe pagesave për personat fizikë;

c) Vërtetim nga dega e tatim-taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa ushtron veprimtarinë, por jo më gjatë se për një periudhë kohore njëvjeçare nga çasti i aplikimit;

d) Informacion mbi numrin e të punësuarve në momentin e aplikimit dhe nivelin e pagesë së dhënë për çdo person;

e) Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesit të specifikuar për tre muajt e fundit;

f) Kopje të licencës kur veprimtaria, që ushtron ndërmarrja sociale, e kërkon një të tillë;

g) Një kopje të aktit të inspektimit në punë në rast se organizata është inspektuar nga strukturat përgjegjëse për inspektim.

5. Përfitimi nga fonde të akorduara nga donatorët apo institucione financiare ndërkombëtare, për këto sipërmarrje, nuk përbën pengesë për përfitime dhe nga fondi për ndërmarrjet sociale. Subjektet duhet të vetëdeklarojnë se nuk janë duke përfutur financim nga donatorë të tjerë për të njëjtin projekt.

6. Sekretariati i Komisionit të Vlerësimit të Ndërmarrjeve Sociale vlerëson dosjen sipas kritereve të përcaktuara në vendimin nr. 231/2026 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e formave të mbështetjes, nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”, përgatit informacionin dhe ia paraqet Komisionit.

7. Komisioni i vlerësimit shqyrton çdo aplikim, në bazë të informacionit të përgatitur nga Sekretariati dhe merr vendimin për miratimin ose refuzimin e një aplikimi bazuar mbi dokumentet e paraqitura, sipas formatit në aneksin nr. 2.

8. Pas miratimit të aplikimeve për subvencionim, vendimi i Komisionit të Vlerësimit, së bashku me dosjet përkatëse, përcillet pranë Shërbimit Social Shtetëror, i cili ndjek procedurën për dhënien e subvencionit.

9. Ndërmarrja, së cilës i është miratuar kërkesa, njoftohet me shkrim ose në mënyrë elektronike dhe paraqitet pranë Shërbimit Social Shtetëror për të nënshkruar kontratën për dhënien e subvencionit, në të cilën do të përcaktohet dhe afati për përfundimin e projektit, sipas modelit në aneksin nr. 3.

10. Kontrata do të hartohet në pesë kopje origjinale me nënshkrimin në çdo faqe dhe vulën e titullarit të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe nënshkrimin në çdo faqe dhe vulën e subjektit përfutues (ose personit të autorizuar prej tij).

11. Ndërmarrja sociale, çdo tre muaj, brenda datës 10 të muajit pasardhës, paraqet pranë Sektorit të Financës së Shërbimit Social Shtetëror,



dokumentacionin justifikues për subvencionim, i cili protokollohet në datën e dorëzimit.

12. Dokumentet që duhet të dorëzojë ndërmarrja sociale janë:

- a) Kërkesë për rimbursim;
- b) Listëprezenca e punonjësve aktual, E-sig27 deri në momentin e nënshkrimit të kontratës;
- c) Listëprezenca e punonjësve nga kategoritë në nevojë për tre muaj, E-sig27, pas nënshkrimit të kontratës;
- d) Deklarata, listëpagesa e tre muajve të kontributeve E-sig25 të printuar nga sistemi;
- e) Urdhërpagesa elektronike e kontributeve të paguar në bankë me vulë të njomë ose elektronike;
- f) Dëshmi për pagesën e pagave me anë të listëpagesës me vulë të njomë ose elektronike (vetëm të punonjësve nga kategoritë në nevojë), bashkëlidhur mandatpagesa nga banka;
- g) Urdhërpagesa elektronike për pagesën e detyrimeve tatimore në bankë me vulë të njomë ose elektronike;
- h) Lista e punonjësve nga grupet e pafavorizuara, të cilët janë punësuar në kuadër të projektit shoqëruar me:

1. Kontratat e tyre të punës me kohëzgjatje sipas kohëzgjatjes së kontratës;

2. Vërtetim që vërteton kategorinë e grupit të pafavorizuar për personat e punësuar, sipas vendimit nr. 56/2018, të Këshillit të Ministrave,

“Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”.

13. Detyrimet për gjoba, kamatëvonesa për deklarime apo pagesa të vonuara janë përgjegjësi e ndërmarrjes sociale.

14. Nëse dokumentacioni paraqitet i rregullt, financimi do të bëhet brenda 15 ditëve pune nga paraqitja e dokumenteve nga subjekti në Sektorin e Financës, pranë Shërbimit Social Shtetëror.

15. Shërbimi Social Shtetëror monitoron ecurinë e projektit dhe auditimin financiar të tij. Raportet e monitorimit paraqiten pranë Komisionit në mënyrë periodike, të paktën një herë në 6 muaj.

16. Pas përfundimit të projektit, ndërmarrja përgatit dhe paraqet pranë Shërbimit Social Shtetëror një raport mbi projektin. Raporti vjetor i hartuar nga Shërbimi Social Shtetëror përcillet pranë Ministrisë përgjegjëse për çështjet sociale.

17. Ministria do të ruajë në mënyrë konfidenciale informacionet e marra nga ndërmarrjet. Asnjë e dhënë e marrë prej Ministrisë nga ana e aplikuesve nuk do t'u bëhet e ditur palëve të treta pa miratimin e tyre.

18. Udhëzimi nr. 207, datë 9.4.2024, shfuqizohet. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Aneksi nr. 1

FORMULARI I APLIKIMIT PËR FINANCIMIN E NDËRMARRJEVE SOCIALE
(në zbatim të VKM nr.231/2026 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026-2028”)

1. Të dhëna të ndërmarrjes:

Emri i ndërmarrjes	
Përfaqësuesi/personi i autorizuar për të bërë aplikimin	
Adresa	
Rruga	
Qyteti	
Tel	
E-mail	
Website:	
Viti i krijimit	
Statusi Ligjor	
Produktet /shërbimet kryesore	

2. Përmbledhje

Titulli i Projektit		
Fusha ku aplikohet të përcaktuara sipas VKM nr.16/2018 (Ju lutem lini vetëm fushën ose fushat ku aplikohet programi juaj)		
Shtrirja e Projektit	<i>Specifiko Rajonin(etj), Bashkinë, njësinë administrative ku do të zbatohet projekti</i>	
Emri i aplikantit		
Statusi ligjor (së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës)	<i>Numri i Vendimit dhe Data e regjistrimit në Gjykatë;</i> <i>NIPT-i</i> <i>Emri i Bankës</i> <i>Numri IBAN</i> <i>Nr. i Llogarisë Bankare (në lekë)</i>	
Partnerët në projekt (nëse ka)	<i>Emrat e organizatave partnere në projekt</i>	<i>Kontribute të tjera</i>
Buxheti i kërkuar	<i>Shuma e kërkuar nga MSHMS</i>	
Buxheti total		
Kohëzgjatja e zbatimit të Projektit	< Muajt/vitet >	



3. Kapaciteti i aplikantit (max. 1 faqe)

Projekte të zbatuara nga aplikanti (listo të gjitha projektet në 3 vitet e fundit, nese ka)

Emri i projektit dhe numri i kontratës	
Donatorët dhe kontaktet përkatëse	
Aktivitetet kryesore	
Kohëzgjatja e projekteve	
Buxheti i secilit projekt dhe kontributi i dhënë nga aplikanti	

4. Aktivitetet e propozuara për zbatimin e projektit

a. Kalendari i aktiviteteve; Vendi i zbatimit; Përfituesi/target grupi

Emri i aktivitetit	Vendi i zbatimit	Përfituesi / Target grupi	Muaj/vitet					
			1	2	3	4	5	6

b. Shërbimet dhe produktet që mund të zhvillohen nga ndërmarrja sociale

5. Efektshmëria dhe qëndrueshmëria e rezultateve

a. Lidhja midis rezultateve dhe qëllimit të objektivave specifike të projektit me aktivitetet e parashikuara

Aktiviteti	Rezultatet specifike të pritshme	Si do të ndihmojë të arrini objektivat specifike të projektit

b. Përshkruani impaktin social

Dokumentet e dorëzuara		
Deklarata e përgjithshme në emër të kërkuarit të finacimit		
Deklaroj nën përgjegjësinë time dhe të subjektit që përfaqësoj se: Të dhënat e deklaruara dhe dokumentet e dorëzuara janë të vërteta. Njoh dhe pranoj kriteret e aplikimit si dhe kufizimet dhe detyrimet ligjore që duhet të zbatohet dhe respektoj përgjatë zbatimit të projektit. Pranoj se paraqitja në mënyrë të vetëdijshme e informacione të rreme ose të paqarta do të çojë në refuzimin e këtij aplikimi dhe çdo aplikimi të mëtejshëm.		
1	Emri dhe Nënshkrimi i deklaruarit	
2	Nënshkrimi i personit që aplikon/vula	
3	Numri i aplikimit	
4	Data e aplikimit	



ZËRAT	Njësia	Sasia	Kosto për njësi (në lekë)	VITI 1	VITI 2	VITI 3	(I) Shuma e kërkuar	(II) Kontribut i siguruar nga Aplikanti / Partnerë të tjerë	TOTAL (I+II)
1. Pagat për burimet njerëzore	Nr.punonjësish								
2. Pagesa e sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore	Nr.punonjësish								
TOTAL (1+ 2)									



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
KOMISIONI I VLERËSIMIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE*Aneksi nr.2*

Nr _____ prot.

Tiranë, më _____

VENDIM

NR____, DATË_____

“PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË NDËRMARRJEVE SOCIALE”

Në mbështetje të Vendimit nr. 231/2026 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale për periudhën 2026-2028” dhe në zbatim të Urdhrit Nr. 559, datë 11.11.2025 “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ndërmarrjeve Sociale”, i ndryshuar, Komisioni

V E N D O S I:

1. Miratimin e subvencionimit për ndërmarrjet sociale _____, për periudhën e zbatimit _____

Ky vendim bazohet në përmbushjen e kriterëve të nevojshme për marrjen e subvencionimit nga ndërmarrjet sociale.

2. Vlera totale e subvencionit nuk duhet të kalojë shumën 14 000 000 lekë, për një periudhë prej 3 (tre) vitesh.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.
4. Sekretariati Teknik duhet të përgatisë shkresat për njoftimin e ndërmarrjeve sociale përfituese për vlerën e miratuar të subvencionimit, si dhe për detyrimin ligjor të raportimit për zbatimin nga ndërmarrjet sociale, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Komisioni i Vlerësimit



Aneksi nr. 3

Neni 2

Baza ligjore

KONTRATË

NDËRMJET SUBJEKTTË PËRFITUES
DHE SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR PËR
FINANCIMIN E PROJEKTTË
“_____”, NGA
PROGRAMI I FONDIT TË MBËSHETJES
SË NDËRMARRJEVE SOCIALE

Sot më datë _____._____ lidhet kjo
Kontratë ndërmjet palëve:

Shërbimi Social Shtetëror, person juridik
publik, që ushtron veprimtarinë në bazë të ligjit nr.
121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në
Republikën e Shqipërisë”; vendimit nr. 135, datë
7.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e
statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, të ndryshuar,
përfaqësuar nga z./znj. _____
(pozicioni) _____, me adresë: Rruga e
Durrësit, nr. 1001, Tiranë (më poshtë referuar edhe
si “SHSSH”),

dhe

Subjekti _____ ndërmarrje
sociale, që operon në sektorin e _____,
përzgjedhur për të përfutur nga fondi për
subvencionimin e ndërmarrjeve sociale përfaqësuar
nga z./znj. _____, (pozicioni) _____,
me adresë _____ (më poshtë referuar
edhe si “Ndërmarrja Sociale”).

Palët në këtë kontratë bashkëpunimi bien dakord
për sa më poshtë:

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj kontrate është dhënia e financimit
për ndërmarrjen sociale _____
për të subvencionuar pagesat për pagat dhe
sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe
shëndetësore në nivelin e pagës minimale në vend,
për projektin _____ në një
vlerë prej _____ lekësh, me qëllim integrimin
në tregun e punës të kategorive të ndryshme të
grupeve të pafavorizuara.

Kjo kontratë bazohet në ligjin nr. 65/2016, “Për
ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”; në
vendimin nr. 231, datë 1.4.2026, të Këshillit të
Ministrave, “Për përcaktimin e formave të
mbështetjes nëpërmjet subvencionit për
ndërmarrjet sociale, për periudhën 2026–2028”; në
vendimin nr. 716, datë 1.12.2017, “Për përcaktimin
e procedurave të kryerjes së kontrollit të
veprimtarisë së ndërmarrjes sociale”, dhe në
udhëzimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale nr. 677, datë 27.9.2018, “Për përcaktimin e
formave, afateve dhe mënyrave të raportimit
periodik, për veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë
e personave të punësuar nga ndërmarrjet sociale”.

Neni 3

Angazhimet dhe detyrimet e palëve

Fondi i mbështetjes së ndërmarrjeve sociale do të
disbursohet nga Shërbimi Social Shtetëror, me
miratim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe
Mirëqenies Sociale për ndërmarrjen sociale, kur ajo
të ketë paguar të gjitha detyrimet financiare dhe të
ketë përmbushur të gjitha kërkesat që rrjedhin nga
implementimi i projektit, sipas kushteve që
paraqiten në këtë kontratë.

Përgjegjësitë e ndërmarrjes sociale:

a) Të drejtojë dhe të implementojë projektin me
kujdes, efikasitet dhe në përputhje me ligjet dhe
aktet nënligjore të shtetit shqiptar;

b) Të mos ndryshojë projektin, për të cilin është
përfutuese e këtij fondi të mbështetjes së
ndërmarrjeve sociale, ose të mos shkrihet, apo
bashkohet me ndërmarrje të tjera, ose të tjetërsojë
objektin e veprimtarisë në veprimtari të paligjshme,
të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi;

c) Të sigurojë informacionin e nevojshëm, sipas
formatit të raportimit bashkëlidhur udhëzimit nr.
677, datë 27.9.2018, “Për përcaktimin e formave,
afateve dhe mënyrave të raportimit periodik, për
veprimtaritë e ushtruara dhe kategoritë e personave
të punësuar nga ndërmarrjet sociale”, sa herë
kërkohet nga SHSSH-ja, si dhe çdo vit pas
përfundimit të kontratës dhe marrjes së fondit të
mbështetjes së ndërmarrjeve sociale, në përputhje
me parashikimet e VKM-së nr. 716, datë 1.12.2017,



“Për përcaktimin e procedurave të kryerjes së kontrollit të veprimtarisë së Ndërmarrjes Sociale”;

d) Të pranojë çdo lloj monitorimi, vlerësimi dhe/apo auditimi, për të cilat projekti i aprovuar mund të bëhet objekt, duke siguruar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar;

e) Të bashkëpunojë me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, SHSSH-në dhe institucionet e saj, për inspektimin e saj (ndërmarrjes) pas përfundimit të projektit. Në rast refuzimi për bashkëpunim, SHSSH-së i lind e drejta t'i kërkojë ndërmarrjes të kthejë shumën e përfituar për mbështetjen e projektit të miratuar;

f) Të mos ndryshojë projektin. Nëse për ndonjë arsye, ndërmarrja dëshiron të ndryshojë projektin pas nënshkrimit të kontratës, ajo duhet t'i paraqesë paraprakisht Shërbimit Social Shtetëror një kërkesë për anulimin e kontratës, e cila do të nënkuptojë mos rimbursimin e shpenzimeve të kryera nga ndërmarrja, si dhe detyrimin e ndërmarrjes për të kthyer shumën e përfituar pas nënshkrimit të marrëveshjes;

g) T'i paraqesë SHSSH-së pas përfundimit të projektit, të gjitha materialet dhe raportin përfundimtar, lidhur me zbatimin e tij dhe mbi përfitimet që kanë ardhur dhe do të vijnë si rezultat i këtij projekti. Ky raport duhet të paraqitet brenda 3 muajve nga përfundimi i projektit.

h) Të përfundojë projektin brenda afatit të parashikuar në këtë kontratë. Nëse projekti nuk përfundon brenda afatit të caktuar, kontrata do të konsiderohet e zgjidhur dhe SHSSH-ja nuk ka asnjë detyrim financiar për shpenzimet e kryera nga ndërmarrja për realizimin e projektit të miratuar.

Përgjegjësitë e Shërbimit Social Shtetëror:

a) Të disbursojë fondin e subvencionit, 15 ditëve pune nga paraqitja e dokumenteve nga subjekti;

b) Të monitorojë ecurinë e projektit;

c) Të bëjë auditimin financiar gjatë zbatimit të projektit;

d) Të hartojë raportin vjetor, bazuar në raportet e dërguara nga ndërmarrja sociale dhe një kopje t'i dorëzohet dhe ndërmarrjes.

Neni 4

Fondi i mbështetjes së ndërmarrjeve sociale

Pagesa e fondit të mbështetjes së ndërmarrjeve sociale për subjektin do të bëhet pas nënshkrimit të kontratës. Shërbimi Social Shtetëror do të

subvencionojë pagesat për të punësuarit nga grupet e pafavorizuara çdo 3 muaj, në përputhje me parashikimet e udhëzimit.

Neni 5

Deklarime

Ndërmarrja përfituese deklaron që:

a) Ka autoritetin të bëjë këtë Kontratë, nuk është në proces falimentimi dhe/ose nuk ka filluar procedura ligjore për shpërbërjen e saj;

b) Nuk ka/ose është duke përfituar financim nga ndonjë donator tjetër për të njëjtin projekt.

Neni 6

Afati

Afati i përfundimit të projektit është _____ nga data e nënshkrimit të kontratës.

Neni 7

Kushtet e zgjidhjes së kontratës

Në rastin e mospërbushjes së detyrimeve nga ndërmarrja, ndryshimit të projektit pas nënshkrimit të kontratës, mospërfundimit të projektit brenda afatit të parashikuar në këtë kontratë dhe mosdorëzimit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga përfundimi i projektit, të dokumenteve të kërkuara për rimbursim, SHSSH-ja merr vendimin për ndërprerjen dhe zgjidhjen e menjëhershme të kësaj kontrate.

SHSSH-ja është e detyruar të njoftojë me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve pune ndërmarrjen, si dhe të komunikojë arsyen ose shkakun që ka sjellë zgjidhjen e kësaj kontrate. Me ndërprerjen dhe zgjidhjen e kësaj kontrate, SHSSH-ja nuk ka asnjë detyrim financiar për shpenzimet e kryera nga ndërmarrja për realizimin e projektit të miratuar.

Kontrata zgjidhet dhe në rastet e mëposhtme:

a) nëse ndërmarrja shpërbëhet, falimenton ose nuk ka mundësi të paguajë;

b) nëse përfaqësimet ose pagesat e bëra, sipas kësaj kontrate, do të jenë të pasakta;

c) nëse ndërmarrja, ose ofruesi i shërbimit kanë dështuar në përmbushjen e detyrave të tyre;

c.1. sipas kësaj kontrate; dhe/ose

c.2. sipas kontratës të ofruesit të shërbimit.



Neni 8
Përfaqësimi

Përfaqësuesit e autorizuar

Përfaqësuesit e autorizuar për çdo veprim që do të ndërmerret dhe çdo dokument që do të prodhohet, sipas kësaj kontrate do të jenë:

A. Për ndërmarrjen: _____; me adresë: _____.

B. Për SHSSH: _____, me adresë: _____.

Njëra palë mund të ndërrojë adresë duke i bërë të ditur palës tjetër ndryshimet e bëra.

Neni 9
Refuzimi dhe dëmshpërblimi

SHSSH-ja nuk ka detyrime në gjetjen e “ofruesit të shërbimit” dhe përmbushjen e aktivitetit/shërbimit. SHSSH-ja nuk mban përgjegjësi ndaj ndërmarrjes për dëme ose humbje të shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë nga kryerja e aktivitetit/shërbimit ose nga zbatimi i rekomandimeve të bëra nga ofruesi i shërbimit.

Ndërmarrja njeh këtë refuzim nga SHSSH-ja dhe pranon të adresojë çdo kërkesë në lidhje me aktivitetin/shërbimin vetëm tek ofruesi i shërbimit.

Në prani të njëra-tjetrës, palët veprojnë sipas autoriteteve të tyre përfaqësuese, nënshkruajnë këtë kontratë me emrat e tyre përkatës në datën e përmendur me sipër.

Kjo kontratë nënshkruhet në 3 kopje.

**Për ndërmarrjen
përfituese**

Nga: _____

**Për Shërbimin Social
Shtetëror**

Nga: _____

URDHËR
Nr. 351, datë 14.5.2026

**PËR MIRATIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONEVE MJEKËSORE TË
CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË
DHE KOMISIONEVE MJEKËSORE TË
PËRCAKTIMIT TË VERBËRISË, TË
NIVELIT TË PARË DHE EPROR, PËR
VLERËSIMIN E PERSONAVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 4, pika 3, dhe të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, datë 18.7.2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar; të nenit 15, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar; të pikës 1, të vendimit nr. 671, datë 15.12.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë”, të ndryshuar; të pikës 8, të kreut II, të vendimit nr. 182, datë 26.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, të ndryshuar; si edhe në vijim të udhëzimit nr. 459/6, datë 14.7.2003, “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e përbërjes së komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP) dhe të komisionit mjekësor të përcaktimit të verbërisë (KMPV), të nivelit të parë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si më poshtë vijon:

a) KMCAP Paraplegji/Tetraplegji:

- i. Entela Basha, neurolog;
- ii. Ilirjana Zekja, neurolog;
- iii. Artid Lame, neurokirurg;
- iv. Hajdi Gorica, neurolog;
- v. Besim Murati, mjek SHSSH;
- vi. Olsi Akshia, jurist.

b) KMPV Verbëri:

- i. Etleva Gjurashaj, okulist;
- ii. Edlira Markeçi, okulist;



- iii. Brikena Selimi, okulist;
- iv. Jonit Ferhati, SHVSH;
- v. Ajola Kote, mjek SHSSH;
- vi. Adelina Shabanaj, jurist.

2. Miratimin e përbërjes së komisionit epror mjekësor të caktimit të aftësisë për punë (KMCAP Epror) dhe të komisionit epror mjekësor të përcaktimit të verbërisë (KMPV Epror), për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara, si më poshtë vijon:

a) KMCAP Epror Paraplegji/Tetraplegji:

- i. Eris Ranxha, neurolog;
- ii. Arsen Seferi, neurokirurg;
- iii. Bujar Cakani, neurolog;
- vi. Ejona Isakaj, neurokirurg;
- iv. Edmond Kallëmbi, mjek SHSSH;
- v. Eneida Capo, jurist.

b) KMPV Epror Verbëri:

- i. Vilma Mema, okulist;
- ii. Johana Vruho, okulist;
- iii. Ermal Simaku, okulist;
- iv. Edmond Kallëmbi, mjek SHSSH;
- v. Anila Prifti, jurist.

3. Urdhri nr. 434, datë 22.7.2020, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MIRËQENIES SOCIALE
Evis Sala

URDHËR

Nr. 564, datë 21.5.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË URDRIN E MINISTRIT NR. 113,
DATË 15.3.2022, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR MASAT
MBROJTËSE KUNDËR DËMTUESVE
TË BIMËVE”, TË NDRYSHUAR**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

Në rregulloren “Për masat mbrojtëse kundër dëmtuesve të bimëve”, miratuar me urdhrin nr. 113, datë 15.3.2022, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshime si vijon:

1. Në kreun IX pas nenit 26 shtohet neni 27 me këtë përmbajtje:

“Neni 27

Masat specifike për hyrjen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë të frutave të *Mangifera L.*, me origjinë nga Mali

1. Përjashtimisht nga pika 61 (d) e aneksit VII të kësaj rregulloreje, lejohet hyrja brenda territorit të Republikës së Shqipërisë e frutave të *Mangifera L.* me origjinë nga Mali, vetëm nëse plotësohen kërkesat e mëposhtme:

a) Frutat shoqërohen me një deklaratë zyrtare që vërteton se ato i janë nënshtruar një trajtimi efektiv pas vjeljes, për të siguruar që janë të lira nga dëmtues të familjes *Tephritidae*, siç përmendet në pikën 79, të tabelës 3, pjesa A, të aneksit II, të kësaj Rregulloreje, ndaj të cilave këto fruta dihet se janë të ndjeshme;

b) Detajet e metodës së trajtimit pas vjeljes pasqyrohen në certifikatën fitosanitare; dhe

c) Metoda e trajtimit i është komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga Organizata Kombëtare e Mbrojtjes së Bimëve të Malit”.

2. Në aneksin VII, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 61, te kolona e dytë formulimi i tekstit “Fruta të *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.* dhe hibridet e tyre *Mangifera L.* dhe *Prunus L.*” zëvendësohet me formulimin “Fruta të *Citrus L.*, *Fortunella Swingle*, *Poncirus Raf.*, dhe hibridet e tyre, *Mangifera L.* (*) dhe *Prunus L.*”.

b) Pas pikës 32.7 shtohen pikat 32.8 dhe 32.9, të cilat përcaktojnë masat për parandalimin e futjes, vendosjes dhe përhapjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të organizmave të dëmshëm *Anoplophora glabripennis* dhe *Anoplophora chinensis*, me përmbajtje si vijon:

(1*) Për frutat e *Mangifera L.*, me origjinë nga Mali, zbatohen kërkesat e nenit 27 të kësaj rregulloreje, në përputhje me Rregulloren Zbatuese (BE) 2025/2294.



ANEKSI

“32.8	Bimë për mbjellje që kanë një diametër të kërcellit prej 1 cm ose më shumë në pikën e tyre më të trashë, të <i>Acer spp.</i> , <i>Aesculus spp.</i> , <i>Betula spp.</i> , <i>Fraxinus spp.</i> , <i>Populus spp.</i> , <i>Salix spp.</i> dhe <i>Ulmus spp.</i>	ex 0602 10 90 ex 0602 20 20 ex 0602 20 80 ex 0602 90 41 ex 0602 90 45 ex 0602 90 46 ex 0602 90 48 ex 0602 90 50 ex 0602 90 70 ex 0602 90 99	Kina, Japonia Koreja e Veriut, Libani, Koreja e Jugut, Zvicra, Shtetet e Bashkuara.	Deklaratë zyrtare se bimët: a) kanë origjinën nga një zonë e përcaktuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës si e pastër nga <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 4 (*). Zona e pastër nga dëmtuesit duhet të përmendet në certifikatën fitosanitare nën rubrikën “vendi i origjinës”, me kusht që ky status i pastërtisë t’i jetë komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve të vendit të origjinës; ose b) janë kultivuar gjatë një periudhe prej të paktën dy vjetësh para eksportit, ose, në rastin e bimëve që janë më të reja se dy vjet, janë kultivuar gjatë gjithë jetës së tyre, në një vend prodhimi: i. i përcaktuar si i lirë nga <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky), në përputhje me ISPM 10(**); ii. i nënshtrohet çdo vit të paktën dy inspektimeve zyrtare për çdo shenjë të <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky) të kryera në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë shenjë e atij dëmtuesi; iii. kur bimët janë rritur në një vend: - me izolim fizik kundër futjes së <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky); ose - me zbatimin e trajtimeve të përshtatshme parandaluese dhe të rrethuara nga një zonë tampon me gjerësi prej të paktën 1 km ku kryhen çdo vit në kohë të përshtatshme studime zyrtare për praninë ose shenjat e <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky); dhe iv. ku, menjëherë para eksportit, të gjitha dërgesat e bimëve i janë nënshtruar një inspektimi zyrtar për praninë e <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky), në veçanti në degë dhe kërcëje, duke përfshirë marrjen e mostrave të synuara shkatërruese; ose c) janë rritur nga nënshartesa që plotësojnë kërkesat e pikës (b), janë shartuar me filiza dhe bimët e shartuara janë inspektuar në përputhje me pikën (b) (iv). Madhësia e mostrës për inspektimin e përmendur në pikën (b) (iv), duhet të jetë e tillë që të mundësojë të paktën zbulimin e nivelit 1% të infektimit me një nivel besimi prej 99%.
32.9	Bimë për mbjellje që kanë një diametër të kërcellit prej 1 cm ose më shumë në pikën e tyre më të trashë, të <i>Acer spp.</i> , <i>Aesculus spp.</i> , <i>Alnus spp.</i> , <i>Betula spp.</i> , <i>Carpinus spp.</i>	ex 0602 10 90 ex 0602 20 20 ex 0602 20 30 ex 0602 20 80 ex 0602 40 00 ex 0602 90 41 ex 0602 90 45 ex 0602 90 46	Të gjitha vendet	Deklaratë zyrtare që bimët: a) e kanë origjinën nga një vend të njohur si i lirë nga <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM4, me kusht që ky status i lirë të jetë komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve e vendit eksportues; ose



<i>Citrus</i> spp., <i>Cornus</i> spp., <i>Corylus</i> spp., <i>Cotoneaster</i> spp., <i>Crataegus</i> spp., <i>Fagus</i> spp., <i>Lagerstroemia</i> spp., <i>Malus</i> spp., <i>Melia</i> spp., <i>Ostrya</i> spp., <i>Photinia</i> spp., <i>Platanus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Prunus laurocerasus</i>, <i>Pyrus</i> spp., <i>Rosa</i> spp., <i>Salix</i> spp., <i>Ulmus</i> spp. and <i>Vaccinium corymbosum</i>	ex 0602 90 47 ex 0602 90 48 ex 0602 90 50 ex 0602 90 70 ex 0602 90 91 ex 0602 90 99	b) kanë origjinën nga një zonë e përcaktuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës si e pastër nga <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 4 (*). Zona e pastër nga dëmtuesit duhet të përmendet në certifikatën fitosanitare nën rubrikën “vendi i origjinës”, me kusht që ky status i pastërtisë t’i jetë komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve të vendit eksportues në fjalë; ose c) janë kultivuar gjatë një periudhe prej të paktën dy vjetësh para eksportit, ose, në rastin e bimëve që janë më të reja se dy vjet, janë kultivuar gjatë gjithë jetës së tyre, në një vend prodhimi: i. i përcaktuar si i pastër nga <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster), në përputhje me ISPM10 (**) ii. i nënshtrohet çdo vit të paktën dy inspektimeve zyrtare për çdo shenjë të <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster) të kryera në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë shenjë e atij dëmtuesi; iii. kur bimët janë rritur në një vend: - me izolim fizik kundër futjes së <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster); ose - me zbatimin e trajtimeve të përshtatshme parandaluese dhe të rrethura nga një zonë tampon me gjerësi prej të paktën 1 km ku kryhen studime zyrtare për praninë ose shenjat e <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster) çdo vit në kohë të përshtatshme; dhe iv. kur, menjëherë para eksportit, dërgesat e bimëve i janë nënshtruar një inspektimi zyrtar për praninë e <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster), në veçanti në rrënjë dhe kërcë, duke përfshirë marrjen e mostrave të synuara shkatërruese; ose d) janë rritur nga nënshartesa që plotësojnë kërkesat e pikës (c), janë shartuar me filiza dhe bimët e shartuara janë inspektuar, në përputhje me pikën (c) (iv). Madhësia e mostrës për inspektimin e përmendur në pikën (c)(iv), duhet të jetë e tillë që të mundësojë zbulimin e të paktën 1% të nivelit të infektimit me një nivel besimi prej 99%.
--	--	---

(*) ISPM 4 Kërkesat për krijimin e zonave pa dëmtues, IPPC, FAO, 1995.

(**) ISPM 10 Kërkesat për krijimin e vendeve të prodhimit pa dëmtues dhe vendeve të prodhimit pa dëmtues, IPPC, FAO, 1999.”

c) Pas pikës 113, shtohen pikat 114 dhe 115, me përmbajtje si më poshtë vijon:

“114.	Druri i <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp., dhe <i>Ulmus</i> spp., përveçse në formën e: - ashkla, grimca, cifa,	ex 4401 12 00 ex 4403 12 00 4403 95 10 4403 95 90 4403 96 00 4403 97 00	Kina, Japonia, Libani, Koreja e Veriut, Koreja e Jugut, Zvicra, Shtetet e Bashkuara.	Deklaratë zyrtare se druri: a) e ka origjinën nga një zonë e përcaktuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës si e pastër nga <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare
-------	---	--	--	--



	tallash, mbetje dhe skrap druri, të përftuara tërësisht ose pjesërisht nga këto bimë, material ambalazhimi prej druri, në formën e arkave të paketimit, kutive, kafazeve, fuçive dhe ambalazheve të ngjashme, paletave, paletave-kuti dhe platformave të tjera të ngarkimit, kornizave të paletave, materialeve mbështetëse (<i>dunnage</i>), pavarësisht nëse përdoren apo jo realisht në transportin e objekteve të çdo lloji, përveç materialeve mbështetëse për ngarkesat e drurit, të cilat janë ndërtuar nga dru i të njëjtë tip dhe cilësi si druri në ngarkesë dhe që përmbushin të njëjtat kërkesa fitosanitare të Bashkimit si druri në ngarkesë, por duke përfshirë edhe materialin që nuk e ka ruajtur sipërfaqen e tij natyrore të rrumbullaket.	ex 4403 99 00 ex 4404 20 00 ex 4406 12 00 ex 4406 92 00 4407 93 10 4407 93 91 4407 93 99 4407 95 10 4407 95 91 4407 95 99 4407 96 10 4407 96 91 4407 96 99 4407 97 10 4407 97 91 4407 97 99 ex 4407 99 27 ex 4407 99 40 ex 4407 99 90 ex 4409 29 91 ex 4409 29 99 ex 4416 00 00 ex 9406 10 00		ISPM 4 (*). Zona e pastër nga dëmtuesit duhet të përmendet në certifikatën fitosanitare nën rubrikën “vendi i origjinës”, me kusht që ky status i pastërtisë t’i jetë komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve të vendit të origjinës; ose b) është hequr lëvorja dhe i është nënshtruar një trajtimi të përshtatshëm termik për të arritur një temperaturë minimale prej 56 °C për një kohëzgjatje minimale prej 30 minutash të vazhdueshme në të gjithë profilin e drurit (duke përfshirë edhe bërthamën e tij), gjë që duhet të tregohet në certifikatën fitosanitare, dhe shenja “HT” është vendosur në dru ose në çdo mbështjellës në përputhje me përdorimin aktual.
115	Dru në formën e ashklave, grimcave, tallasheve, mbeturinave dhe skrapit të drurit të përftuar tërësisht ose pjesërisht nga <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp. and <i>Ulmus</i> spp.	ex 4401 22 90 ex 4401 49 90 ex 4401 49 10	Kina, Japonia, Libani, Koreja e Veriut, Koreja e Jugut, Zvicra, Shtetet e Bashkuara.	Deklaratë zyrtare se druri: a) e ka origjinën nga një zonë e përcaktuar nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve në vendin e origjinës si e pastër nga <i>Anoplophora glabripennis</i> (<i>Motschulsky</i>), në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 4 (*). Zona e pastër nga dëmtuesit duhet të përmendet në listën fitosanitare. certifikatë sipas rubrikës “vendi i origjinës”, me kusht që ky status lirie t’i jetë komunikuar paraprakisht me shkrim Komisionit nga organizata kombëtare e mbrojtjes së bimëve të vendit të origjinës; ose b) është hequr lëvorja dhe i është nënshtruar një trajtimi të përshtatshëm termik për të arritur një temperaturë minimale prej 56 °C për një kohëzgjatje minimale prej 30 minutash të vazhdueshme në të gjithë profilin e drurit (duke përfshirë edhe bërthamën e tij), gjë që duhet të tregohet në certifikatën fitosanitare; ose c) është përpunuar në copa me trashësi dhe gjerësi jo më shumë se 2,5 cm.”.

3. Në aneksin VIII bëhen ndryshime, t si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 17.1, shtohen pikat 17.2 dhe 17.3 me përmbajtje si më poshtë vijon:



“17.2	Bimë për mbjellje që kanë një diametër të kërcellit prej 1 cm ose më shumë në pikën e tyre më të trashë, të <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp. dhe <i>Ulmus</i> spp., me origjinë nga një zonë e përcaktuar, sipas nenit 5 të Rregullores Zbatuese (BE) 2025/1952 ose të futura në një vend prodhimi në një zonë të tillë.	Deklaratë zyrtare që bimët janë rritur të paktën dy vjet para zhvendosjes, ose në rastin e bimëve që janë më të reja se dy vjet, gjatë gjithë jetës së tyre, në një vend prodhimi që përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme: a) i është nënshtruar çdo vit të paktën dy inspektimeve zyrtare për çdo shenjë të <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky) të kryera në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë shenjë e tillë, duke përfshirë, aty ku është e përshtatshme, marrjen e mostrave shkatërruese të synuara në kërcëjtë dhe degët e bimëve; dhe b) kur bimët janë rritur në një vend: i. me izolim fizik kundër futjes së <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky); ose ii. ku janë kryer çdo vit studime zyrtare për praninë ose shenjat e <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky) brenda një gjerësie prej të paktën 1 km rreth vendit në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë <i>Anoplophora glabripennis</i> (Motschulsky) ose shenja të saj dhe, ku: iii. - janë aplikuar trajtime parandaluese; ose - në secilin lot është kryer marrje mostrash shkatërruese e synuar para lëvizjes, duke përfshirë marrje mostrash shkatërruese të synuar të degëve dhe kërcëjtëve të bimëve. Madhësia e mostrës për inspektim sipas pikës (a) ka qenë e tillë që të mundësojë zbulimin e të paktën 1% të nivelit të infektimit me një nivel besimi prej 99%. Nënshartesat që plotësojnë kërkesat e pikave (a) dhe (b) mund të shartohen me filiza, të cilët nuk janë rritur në këto kushte, por që nuk janë më të mëdhenj se 1 cm në diametër në pikën e tyre më të trashë.
-------	--	---

17.3	Bimë për mbjellje që kanë një diametër të kërcellit prej 1 cm ose më shumë në pikën e tyre më të trashë, të <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Alnus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Carpinus</i> spp., <i>Citrus</i> spp., <i>Cornus</i> spp., <i>Corylus</i> spp., <i>Cotoneaster</i> spp., <i>Crataegus</i> spp., <i>Fagus</i> spp., <i>Lagerstroemia</i> spp., <i>Malus</i> spp., <i>Melia</i> spp., <i>Ostrya</i> spp., <i>Photinia</i> spp., <i>Platanus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Prunus laurocerasus</i> , <i>Pyrus</i> spp., <i>Rosa</i> spp., <i>Salix</i> spp., <i>Ulmus</i> spp. dhe <i>Vaccinium corymbosum</i> , me origjinë nga një zonë e përcaktuar, sipas nenit 5 të Rregullores Zbatuese të Komisionit (BE) 2022/2095 (*) ose e futur në një vend prodhimi në një zonë të tillë.	Deklaratë zyrtare që bimët janë rritur të paktën dy vjet para zhvendosjes, ose në rastin e bimëve që janë më të reja se dy vjet, gjatë gjithë jetës së tyre, në një vend prodhimi, që përmbush të gjitha kërkesat e mëposhtme: a) i është nënshtruar çdo vit të paktën dy inspektimeve zyrtare për çdo shenjë të <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster) të kryera në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë shenjë e tillë, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, marrjen e mostrave shkatërruese të synuara në rrënjët dhe kërcëjtë e bimëve; dhe b) kur bimët janë rritur në një vend: i. me izolim fizik kundër futjes së <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster); ose ii. ku janë kryer çdo vit studime zyrtare për praninë ose shenjat e <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster) brenda një gjerësie prej të paktën 1 km rreth vendit në kohë të përshtatshme, dhe nuk është gjetur asnjë <i>Anoplophora chinensis</i> (Forster) ose shenja të tij; dhe - aty ku janë aplikuar trajtime parandaluese; ose - aty ku është kryer marrja e mostrave shkatërruese të synuara në secilin lot para lëvizjes, duke përfshirë marrjen e mostrave shkatërruese të synuara të rrënjëve dhe kërcëjtëve të bimëve. Madhësia e mostrës për inspektim sipas pikës (a) ka qenë e tillë që të mundësojë zbulimin e të paktën 1% të nivelit të infektimit me një nivel besimi prej 99%. Nënshartesat që plotësojnë kërkesat e pikave (a) dhe (b) mund të shartohen me filiza, të cilët nuk janë rritur në këto kushte, por që nuk janë më të mëdhenj se 1 cm në diametër në pikën e tyre më të trashë.
------	--	---

(*) Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2022/2095 e datës 28 tetor 2022 që përcakton masat për të parandaluar futjen, vendosjen dhe përhapjen brenda territorit të Bashkimit të *Anoplophora chinensis* (Forster) dhe që shfuqizon vendimin nr. 2012/138/BE.

b) Pas pikës 29, shtohen pikat 30, 31 dhe 32 me përmbajtje si më poshtë vijon:



30	Druri i <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp. dhe <i>Ulmus</i> spp., me origjinë nga zonat e përcaktuara sipas nenit 5 të Rregullores Zbatuese (BE) 2025/1952 ose jo me origjinë por i futur në ato zona të përcaktuara, përveçse në formën e: - ashkla, grimca, cifla, mbetje dhe skrap druri, të përfutuara tërësisht ose pjesërisht nga këto bimë; - material paketimi prej druri, në formën e arkave të paketimit, kutive, arkave, fuçive dhe paketimeve të ngjashme, paletave, paletave kuti dhe dërrasave të tjera të ngarkesës, jakave të paletave, materialit mbështetës, pavarësisht nëse është apo jo në përdorim në transportin e objekteve të të gjitha llojeve, përveç materialit mbështetës të dërgesave prej druri, i cili është ndërtuar nga dru i të njëjtit lloj dhe cilësi si druri në dërgesë dhe që plotëson të njëjtat kërkesa fitosanitare të Bashkimit si druri në dërgesë, por duke përfshirë atë që nuk e ka ruajtur sipërfaqen e tij natyrale të rrumbullakët.	Deklaratë zyrtare se druri: a) është i zhveshur nga lëvorja; dhe b) i është nënshtruar një trajtimi të përshtatshëm termik për të arritur një temperaturë minimale prej 56 °C për një kohëzgjatje minimale prej 30 minutash të vazhdueshme në të gjithë profilin e drurit, duke përfshirë edhe bërthamën e tij, dhe të treguar nga shenja “HT” në dru ose në çdo mbështjellës në përputhje me përdorimin aktual.
31	Dru në formën e ashklave, grimcave, tallasheve, mbeturinave dhe skrapit të drurit, i përfutur tërësisht ose pjesërisht nga <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp. dhe <i>Ulmus</i> spp., me origjinë nga një zonë e përcaktuar sipas nenit 5 të Rregullores Zbatuese (BE) 2025/1952.	Deklaratë zyrtare se druri: a) është hequr lëvorja dhe i është nënshtruar një trajtimi të përshtatshëm termik për të arritur një temperaturë minimale prej 56°C për një kohëzgjatje minimale prej 30 minutash të vazhdueshme në të gjithë profilin e drurit (duke përfshirë edhe bërthamën e tij); ose b) është përpunuar në copa me trashësi dhe gjerësi jo më shumë se 2,5 cm.
32	Materiali i paketimit prej druri i <i>Acer</i> spp., <i>Aesculus</i> spp., <i>Betula</i> spp., <i>Fraxinus</i> spp., <i>Populus</i> spp., <i>Salix</i> spp. dhe <i>Ulmus</i> spp. me origjinë nga një zonë e përcaktuar sipas nenit 5 të Rregullores Zbatuese (BE) 2025/1952.	Materiali i paketimit prej druri: a) është bërë nga dru i livruar, siç specifikohet në aneksi I të Standardit Ndërkombëtar të FAO-s për Masat Fitosanitare nr. 15 mbi rregullimin e materialit të paketimit prej druri në tregtinë ndërkombëtare, dhe i është nënshtruar njërit prej trajtimeve të miratuara siç specifikohet në shtojcën I të atij Standardi Ndërkombëtar; dhe b) shfaq një shenjë siç specifikohet në aneksi II të atij Standardi Ndërkombëtar, që tregon se materiali i paketimit prej druri i është nënshtruar një trajtimi fitosanitar të miratuar në përputhje me këtë standard.”.

4. Në aneksin IX, bëhet ndryshimi si vijon:

Pjesa A, pika 12, hyrja “*Acer* L., *Aesculus* L., *Alnus* L., *Betula* L., *Carpinus* L., *Cercidiphyllum* Siebold & Zucc., *Corylus* L., *Fagus* L., *Fraxinus* L., *Koelreuteria* Laxm., *Platanus* L., *Populus* L., *Salix* L., *Tilia* L. dhe *Ulmus* L. ...”.

Zëvendësohet me përmbajtjen si vijon:

“ <i>Acer</i> L., <i>Aesculus</i> L., <i>Betula</i> L., <i>Fraxinus</i> L., <i>Populus</i> L., <i>Salix</i> L. dhe <i>Ulmus</i> L., duke përfshirë drurin që nuk e ka ruajtur sipërfaqen e tij natyrale të rrumbullakët.	Dru zjarri, në formë trungjesh, në formë copëzash, në formë degësh, në formë stoku ose në forma të ngjashme; dru në ashkla ose grimca; tallash dhe mbetje e skrap druri, nëse janë apo jo të bashkuara në formë trungjesh, briketash, peletash ose në forma të ngjashme;	Kina, Japonia, Libani, Koreja e Veriut, Koreja e Jugut, Zvicra, Shtetet e Bashkuara.
--	--	--



	- Dru zjarri, në formë trungjesh, në formë shkurresh, në degëza, në copa të trasha ose në forma të ngjashme: - Johalore: ex 4401 12 00 - Dru në copa ose grimca: - Johalore: - Të tjera (përveç eukaliptit (<i>Eucalyptus spp.</i>)): ex 4401 22 90 - Mbetje dhe skrap druri, të pa bashkuara - Lëvorja dhe mbeturinat e prodhimit, skrapet, mbeturinat dhe mbetjet: ex 4401 49 10 - Të tjera: ex 4401 49 90 Dru i papërpunuar, jo i zhveshur nga lëvorja ose nga lëngu, ose i sheshuar përafërsisht: - Të trajtuara me bojë, njolla, kreozot ose konservues të tjerë: - Johalore: ex 4403 12 00 Dru i papërpunuar, nëse i është hequr lëvorja ose druri i lëngshëm apo jo, ose i sheshuar përafërsisht: - Të tjera nga ato të trajtuara me bojë, njolla, kreozot ose konservues të tjerë: - Nga thupra (<i>Betula spp.</i>): 4403 95 10 4403 95 90 4403 96 00 - Nga plepi dhe aspeni (<i>Populus spp.</i>): 4403 97 00 - Të tjera: ex 4403 99 00 - Shtylla të ndara; shtylla, kunja dhe hunj prej druri, të mprehur në majë por jo të sharruar përgjatë gjatësisë: - Johalore: ex 4404 20 00 Traversa hekurudhore ose tramvaji (lidhëse) prej druri: - Jo i impregnuar: ex 4406 12 00 - Të tjera (përveç jo të ngopura): - Johalore: ex 4406 92 00 Dru i sharruar ose i copëtuar për së gjati, i prerë në feta ose i qëruar, nëse është apo jo i rrafshuar, i lëmuar ose i lidhur me funde, me një trashësi që tejkalon 6 mm:	
	- Nga panja (<i>Acer spp.</i>): 4407 93 10 4407 93 91 4407 93 99 - E frashrit (<i>Fraxinus spp.</i>): 4407 95 10 4407 95 91 4407 95 99 - E mështeknës (<i>Betula spp.</i>): 4407 96 10 4407 96 91 4407 96 99 - Nga plepi dhe aspeni (<i>Populus spp.</i>):	



	4407 97 10 4407 97 91 4407 97 99 - Të tjera: ex 4407 99 27 ex 4407 99 40 ex 4407 99 90 Fletë për rimeso (përfshirë ato të fituara nga prerja e drurit të laminuar), për kompensatë ose për dru të laminuar të ngjashëm dhe dru tjetër, të sharruar për së gjati, të prerë në feta ose të qëruar, nëse janë apo jo të rrafshuara, të lëmuara, të bashkuara ose të lidhura në fund, me një trashësi jo më të madhe se 6 mm: ex 4408 90 15 ex 4408 90 35 ex 4408 90 95 Dru (përfshirë shirita dhe friza për dysHEME parketi, i pamontuar) i formësuar vazhdimisht (me gjuhëza, me brazda, me dërrasa, i shtrembëruar, i lidhur në formë V-je, i rruazuar, i modeluar, i rumbullakosur ose të ngjashme) përgjatë çdo skaji, skaji ose faqeje të tij, nëse është apo jo i rrafshuar, i lëmuar ose i lidhur në skaje: - Johalore, të tjera: ex 4409 29 91 ex 4409 29 99 Fuçi, kazanë, vaska, vaska dhe produkte të tjera të punimit të bakrit dhe pjesët e tyre, prej druri, duke përfshirë shkopinjtë: ex 4416 00 00 Ndërtesa të parafabrikuara prej druri: ex 9406 10 00.”.	
--	--	--

5. Në aneksin XI, pas pikës 4.1 shtohen pikat 4.2 dhe 4.3 me këtë përmbajtje:

“4.2. Dru, përveç atij në formën e ashklave, grimcave, tallasheve, mbeturinave dhe skrapit të drurit me origjinë nga zonat e përcaktuara ose druri që ruan të gjithë ose një pjesë të sipërfaqes së tij të rumbullakët, jo me origjinë, por i futur në ato zona të përcaktuara të *Acer* spp., *Aesculus* spp., *Betula* spp., *Fraxinus* spp., *Populus* spp., *Salix* spp. dhe *Ulmus* spp., siç referohet në pikën 30 të aneksit XI.

4.3. Dru në formën e ashklave, grimcave, tallasheve, mbeturinave dhe skrapit të drurit me origjinë nga zona të përcaktuara, i marrë tërësisht ose pjesërisht nga *Acer* spp., *Aesculus* spp., *Betula* spp., *Fraxinus* spp., *Populus* spp., *Salix* spp. dhe *Ulmus* spp., siç përmendet në pikën 31 të aneksit XI.”.

6. Pas aneksit XVIII shtohen anekset XIX, XX dhe XXI, si pjesë përbërëse e këtij urdhri.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

8. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet 30 ditë pas hyrjes në fuqi. Shkronjat (a), (b) dhe (c), të pikës 61, të aneksit XII të kësaj rregulloreje do të zbatohen deri më 1 dhjetor 2030.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla



ANEKSI XIX

KËRKESAT E PËRMENDURA NË PIKËN 3
TË NENIT 24 PËR HYRJEN E BIMËVE TË
PËRCAKTUARA NË TERRITORIN E
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Bimët e përcaktuara mund të hyjnë në territorin e vendit tonë, vetëm nëse përmbushin të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) *Janë prodhuar në vendndodhjen e prodhimit që:*

i. janë përfshirë nga NPPO (Autoriteti Kombëtar i Mbrojtjes së Bimëve) i Guatemalës në një listë të vendndodhjeve të miratuara të prodhimit, të njohura si të pastra nga dëmtuesit e specifikuar dhe të autorizuar për të eksportuar bimët të specifikuar në Bashkimin Evropian;

ii. janë të identifikuar me një kod unik gjurmueshmërie që figuron në listën e përmendur në nënndarjen (i) të kësaj pike;

iii. janë fizikisht të izoluar kundër insekteve, me dyer të dyfishta, ku dera e dytë hapet vetëm pasi të jetë mbyllur plotësisht dera e parë, dhe kanë një sistem për të siguruar higjienën dhe procedurat e dezinfektimit për stafin, pajisjet dhe të gjitha proceset e prodhimit;

iv. kanë një sistem furnizimi me ujë për ujitje të pastër nga dëmtuesit, i cili i nënshtrohet të paktën dy inspektimeve zyrtare vjetore, përfshirë testime molekulare, për të siguruar mungesën e *Ralstonia pseudosolanacearum* Safni *et al.* dhe *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi *et al.*, Emend. Safni *et al.*;

v. janë të dedikuara ekskluzivisht për prodhimin e bimëve të specifikuar, ose të bimëve të tjera që përmbushin kërkesat e legjislacionit të Shqipërisë për shëndetin e bimëve, dhe i nënshtrohen pastrimit dhe dezinfektimit të plotë përpara hyrjes së bimëve të specifikuar të reja;

vi. kanë raftë për të mbajtur vazot të paktën 50 cm mbi tokë;

vii. kanë një sistem për të mbajtur regjistrim e të gjitha proceseve, përfshirë lotet e prodhuara dhe procedurat për kontrollin e dëmtuesve të specifikuar gjatë çdo cikli prodhimi;

viii. në rast zbulimi të një dëmtuesi të specifikuar, hiqen nga lista e vendndodhjeve të prodhimit të përmendura në nënndarjen (i) të kësaj pike, deri sa të rikthehet statusi pa dëmtues, dhe vetëm atëherë miratohen sërish për prodhim dhe eksport të këtij materiali.

b) *Bimët e specifikuar janë:*

i. rritur në Guatemalë dhe janë me origjinë të drejtpërdrejtë nga bimë mëmë të importuara nga Bashkimi Evropian;

ii. prodhuar duke përdorur substrat dhe vazo që janë ose të reja, ose të trajtuara për të siguruar mungesën e dëmtuesve që barten nga toka dhe çdo dëmtues të specifikuar para përdorimit në procesin e prodhimit;

iii. monitoruar me kurthe për praninë e insekteve nga staf i trajnuar;

iv. kontrolluar vizualisht çdo javë për mungesën e dëmtuesve të specifikuar ose simptomave të tyre nga staf i trajnuar;

v. trajtuar, kur është e nevojshme, kundër dëmtuesve;

vi. nënshtuar testimeve molekulare për zbulimin e *Pepper golden mosaic virus*, *Pepper huasteco yellow vein virus*, *Squash leaf curl virus* dhe *Tomato severe leaf curl virus*, të paktën një herë përpara eksportit në Shqipëri, të lotit parë të prerjeve të parrënyrosura gjatë atij cikli prodhimi, ose pas çdo zbulimi të *Bemisia tabaci* Genn. në vendndodhjen e prodhimit.

c) *Para eksportit, çdo lot i bimëve të specifikuar nga çdo vendndodhje prodhimi:*

i. i nënshtrohet një inspektimi zyrtar për praninë e dëmtuesve të specifikuar, përmes një metode mostrimi që lejon zbulimin e një niveli infektimi prej të paktën 1%, me një nivel besueshmërie prej 99%, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 31, përfshirë testimet molekulare në rast dyshimi për viruset e mësipërme:

ii. transportohet nga vendndodhjet e prodhimit në ambientet e magazinimit, ftohjes ose ambalazhimit në mënyrë që të shmangët kontaminimi me dëmtuesit e specifikuar;

iii. ambalazhohet në kuti, ku secila kuti përfshin një etiketë me kodin e gjurmueshmërisë së vendndodhjes së prodhimit.

d) *Janë të shoqëruara me një certifikatë fitosanitare, të lësuar nga NPPO-ja e Guatemalës, e cila certifikon përputhshmërinë me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe përmban, në rubrikën "Deklaratë Shtesë":*

i. emrin/emrat e vendndodhjes/vendndodhjeve të miratuara të prodhimit nga të cilët vijnë bimët;

ii. kodin/kodet e gjurmueshmërisë së vendndodhjes/vendndodhjeve të prodhimit nga të cilët vijnë bimët;



iii. deklaratën: “Kjo ngarkesë është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 24, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, i ndryshuar”.

2. Raporti vjetor mbi aktivitetet e vitit kalendarik të mëparshëm duhet të përfshijë, për çdo vendndodhje prodhimi:

a) numrin e bimëve të specifikuara të eksportuara drejt Shqipërisë;

b) një përmbledhje të inspektimeve zyrtare të kryera para eksportit;

c) të dhënat mbi zbulimet e pranisë së dëmtuesve të specifikuar;

ç) numrin e bimëve të asgjësuar për shkak të dyshimit ose infektimit me dëmtues të specifikuar;

d) masat e marra për të rikthyer statusin pa dëmtues të vendndodhjes së prodhimit dhe për të parandaluar përsëritjen e dëmtuesve të specifikuar.

ANEKSI XX

KËRKESAT E REFERUARA NË PIKËN 3, TË NENIT 25 PËR HYRJEN E BIMËVE TË SPECIFIKUARA BREDA TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Bimët specifike mund të hyjnë brenda territorit të Shqipërisë vetëm nëse plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) *Ato janë prodhuar në vendndodhje prodhimi që:*

i. përfshihen nga NPPO-ja e Kenias në një listë të vendndodhjeve të prodhimit të miratuara, të njohura si të pastra nga dëmtuesit e specifikuar dhe të lejuara për eksportimin e bimëve të specifikuara në Bashkimin Evropian;

ii. identifikohen me një kod unik të gjurmueshmërisë që shfaqet në listën e përmendur në nënndarjen (i);

iii. janë fizikisht të izoluar kundër insekteve, me dyer të dyfishta, ku dera e dytë hapet vetëm pasi dera e parë të jetë mbyllur plotësisht, dhe kanë një sistem për të siguruar procedurat e higjienës dhe dezinfektimit për personelin, pajisjet dhe të gjitha proceset e prodhimit;

iv. kanë një sistem për furnizimin me ujë për ujitje të pastër nga dëmtuesit, që nënshtrohet të paktën dy herë në vit në inspektime zyrtare, përfshirë teste molekulare, për të siguruar mungesën e *Ralstonia pseudosolanacearum* Safni et al. dhe *Ralstonia solanacearum* (Smith) Yabuuchi et al. Emend. Safni et al.;

v. janë të dedikuara plotësisht për prodhimin e bimëve të specifikuara, ose bimëve të tjera që

plotësojnë kërkesat e legjislacionit të Shqipërisë mbi shëndetin e bimëve, dhe janë subjekt i një pastrimi dhe dezinfektimi të plotë para hyrjes së bimëve të specifikuara të reja;

vi. kanë rafte për të mbajtur enët të paktën 50 cm mbi tokë;

vii. kanë një sistem për të mbajtur regjistrin e të gjitha proceseve, duke përfshirë lotet e prodhuar dhe procedurat për kontrollin e dëmtuesve të specifikuar gjatë çdo cikli prodhimi;

viii. në rast të gjetjes së një dëmtuesi të specifikuar, hiqen nga lista e vendndodhjeve të prodhimit të përmendur në nënndarjen (i) derisa të rikthehet situata pa dëmtues, dhe vetëm atëherë ripranohen për prodhimin dhe eksportin e këtij materiali.

b) *Ato janë:*

i. të kultivuara në Kenia dhe të nxjerra në linjë të drejtë nga bimët mëmë të importuara nga Bashkimi Evropian;

ii. prodhuar duke përdorur terrene të kultivimit dhe enë që janë ose të reja ose që u nënshtrohen trajtimeve për të siguruar pastërtinë nga organizmat që jetojnë në tokë dhe çdo dëmtues të specifikuar para përdorimit në procesin e prodhimit;

iii. monitoruar me kurthe për praninë e insekteve nga personel i trajnuar;

iv. nënshtroar ekzaminimeve vizuale për të siguruar mungesën e dëmtuesve të specifikuar ose simptomave të tyre nga personel i trajnuar çdo javë;

v. nënshtroar, kur është e përshtatshme, trajtimeve kundër dëmtuesve;

vi. nënshtroar teste molekulare për zbulimin e *Compea mild mottle virus*, *Pepper vein mottle virus*, *Potato leafroll virus*, *Tomato mild mottle virus* dhe *Tomato yellow ring virus* të paktën një herë para se të eksportohet loti i parë i prerjeve pa rrënjë në Shqipëri gjatë atij cikli prodhimi ose më shpesh kur gjenden *Bemisia tabaci* Genn., afidet ose tripset të njohur si transmetues të viruseve në vendndodhjen e prodhimit;

c) *Para eksportit, secili lot bimësh të specifikuar nga çdo vendndodhje prodhimi është:*

i. nënshtroar një inspektimi zyrtar për praninë e dëmtuesve të specifikuar, me një metodë mostrimi që lejon zbulimin e një niveli të infestimit të paktën 1 %, me një nivel besueshmërie 99 %, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Masat Fitosanitare ISPM 31, duke përfshirë teste molekulare për *Compea mild mottle virus*, *Pepper vein mottle virus*, *Potato leafroll virus*, *Tomato mild mottle virus*



and Tomato yellow ring virus, në rast dyshimi për infeksion;

ii. transportuar nga vendndodhja e prodhimit në ambientet e magazinimit, ftohjes ose ambalazhimit në vendndodhjet e prodhimit, në një mënyrë që parandalon kontaminimin me dëmtuesit e specifikuar;

iii. ambalazhuar në kuti, ku çdo kuti përfshin një etiketë me kodin e gjurmueshmërisë të vendndodhjes së prodhimit;

c) *Ato shoqërohen me një certifikatë fitosanitare të lëshuar nga NPPO-ja e Kenias, që certifikon përputhjen me kërkesat e kësaj Rregulloreje dhe përfshin, nën rubrikën “Deklarata Shtesë”:*

i. emrin/emrat e vendndodhjes/vendndodhjeve të prodhimit të miratuar prej nga bimët origjinojnë;

ii. kodin/kodet e gjurmueshmërisë së vendndodhjes/vendndodhjeve të prodhimit prej nga bimët origjinojnë;

iii. deklaratën “Kjo ngarkesë është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 25, të urdhrit nr. 113, datë 15.3.2022, i ndryshuar”.

2. Raporti vjetor mbi aktivitetet e vitit kalendarik të mëparshëm përfshin për secilin vendndodhje prodhimi:

a) numrin e bimëve të specifikuara të eksportuara në Shqipëri;

b) pasqyrën e inspektimeve zyrtare të kryera para eksportit;

c) gjetjet e pranisë së dëmtuesve të specifikuar;

ç) numri i bimëve të asgjësuar për shkak të dyshimit për prani dëmtuesish ose për shkak të pranisë së dëmtuesve të specifikuar; dhe

d) veprimet e marra për të rivendosur pastërtinë nga dëmtuesit e vendndodhjes së prodhimit dhe për të parandaluar përsëritjen e dëmtuesve të specifikuar.

ANEKSI XXI

KËRKESAT PËR HYRJEN E BIMËVE TË SPECIFIKUARA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KUSHTET SPECIFIKE PËR INSPEKTIMIN E VENDNDODHJEVE TË PRODHIMIT QË DUHEN PLOTËSUAR

SEKSIONI 1

KËRKESAT PËR HYRJEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË TË BIMËVE TË SPECIFIKUARA SIPAS PIKËS 2 TË NENIT 26

PJESA A

KËRKESA TË VEÇANTA QË DUHET TË PËRMBUSHEN PËR BIMËT E SPECIFIKUARA NË EGJIPT

a) Bimët e specifikuara janë kultivuar në vendndodhje prodhimi që kanë qenë subjekt i inspektimeve të kryera nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar nga NPPO-ja, në përputhje me seksionin 2 të këtij aneksi;

b) Bimët e specifikuara janë kultivuar në vendndodhje prodhimi, ku gjatë vitit të prodhimit dhe tre vjetësh të mëparshëm, rezultatet e inspektimeve kanë treguar, se:

i. asnjë bimë e specifikuar apo pjesë të tjera vegetative të bimëve të patates dhe as bimë të tjera të kultivuara ose të egra nga familja *Solanaceae*, të afta të mbartin dëmtuesin e specifikuar, nuk janë gjetur të infektuara nga dëmtuesi i specifikuar, dhe asnjë burim uji i lidhur, nuk është gjetur i kontaminuar nga dëmtuesi i specifikuar, pas testimeve të kryera për praninë e dëmtuesit të specifikuar nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar prej saj; dhe

ii. asnjë bimë e specifikuar me origjinë nga këto vendndodhje prodhimi nuk ka rezultuar pozitive pas testimeve për praninë e dëmtuesit të specifikuar nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar prej saj, ose nga Shtetet Anëtare ose Shqipëria, pas largimit nga këto vendndodhje prodhimi;

c) Bimët e specifikuara janë kultivuar në një vendndodhje prodhimi të identifikuar me numrin e tij zyrtar individual të kodit, i caktuar nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar prej saj;

ç) Bimët e specifikuara janë kultivuar nga bimë për mbjellje të certifikuara në BE, dhe të importuara nga Bashkimi Evropian në Egjipt, ose janë kultivuar



nga bimë për mbjellje të certifikuar zyrtarisht nga NPPO-ja e Egjiptit si të pastra nga dëmtuesit karantinorë të Shqipërisë (e cila është ekuivalente me listen e Bashkimit Evropian);

d) Në rastin e bimëve për mbjellje, sipas shkronjës “ç”, të certifikuar nga NPPO-ja e Egjiptit, ato janë kultivuar në një vendndodhje prodhimi dhe çdo lot ka qenë subjekt i marrjes së mostrave zyrtare nga NPPO-ja e Egjiptit dhe testimeve nga NPPO-ja e Egjiptit ose nga një trupë e deleguar për zbulimin e dëmtuesit të specifikuar;

dh) Gjatë procesit të përzgjedhjes, bimët e specifikuar janë inspektuar nga NPPO-ja e Egjiptit në stacionin e ambalazhimit dhe zbardhokët me simptoma ose dyshime për praninë e dëmtuesit të specifikuar janë testuar zyrtarisht nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar prej saj, dhe janë gjetur të pastra nga ai autoritet;

e) Bimët e specifikuar janë ambalazhuar në lote, ku çdo lot përbëhet nga bimë të specifikuar me origjinë nga një vendndodhje prodhimi e vetme;

ë) Bimët e specifikuar janë ambalazhuar në material që është i ri, ose i pastruar dhe dezinfektuar në përputhje me metoda të përshtatshme të miratuara zyrtarisht nga NPPO-ja e Egjiptit;

f) Ambalazhimi i tyre mban një etiketë të dukshme të ngjitur me vulë zyrtare dhe të lëshuar nga NPPO-ja e Egjiptit ose nga një operator profesionist nën mbikëqyrjen zyrtare të NPPO-ja e Egjiptit, në gjuhën shqipe, dhe përmban të gjitha elementët e mëposhtëm:

- i. treguesin: “Origjina: Egjipt”;
- ii. kodi i vendndodhjes së prodhimit;
- iii. numri i lotit;
- iv. emri dhe numri i identifikimit të stacionit të ambalazhimit;
- v. emri dhe numri i identifikimit të eksportuesit;
- vi. treguesin “jo për mbjellje”.

g) Sa më afër kohës së eksportit në territorin e Shqipërisë, një mostër përfaqësuese prej 200 bimësh të specifikuar për çdo lot me maksimum 27,5 tonë bimë të specifikuar është marrë dhe i është nënshtruar inspektimit të zbardhokëve të prerë nga NPPO-ja e Egjiptit, dhe mostra është testuar në laborator nga një operator profesionist, ose nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar për zbulimin dhe identifikimin e dëmtuesit të specifikuar;

gj) Menjëherë pas marrjes së mostrës sipas shkronjës (f), ambalazhet e bimëve të specifikuar janë mbyllur dhe vulosur nga NPPO-ja e Egjiptit;

h) Bimët e specifikuar janë ruajtur në objekte magazinimi që përdoren vetëm për ruajtjen e bimëve të specifikuar, ose nëse objektet janë përdorur për qëllime të tjera, ato janë subjekt i masave të përshtatshme higjienike, përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin përpara përdorimit për ruajtje;

i) Bimët e specifikuar janë trajtuar duke përdorur makineri që përdoret vetëm për trajtimin e bimëve të specifikuar ose, nëse është përdorur për qëllime të tjera, është pastruar dhe dezinfektuar me metoda të përshtatshme përpara trajtimit të atyre bimëve;

j) Testimi i bimëve të specifikuar, për qëllimet e shkronjave (a), (b), (d), (dh) dhe (g) të kësaj pjese, si dhe të seksionit II të këtij aneksi, është kryer në përputhje me skemën e testimit të udhëzimit nr. 24, datë 20.9.2024, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për çrrënjosjen dhe për parandalimin e përhapjes brenda vendit të kalbëzimit kaf *Ralstonia solanacearum* (smith 1896) *Yabuuchi et al. 1996 emend Safni et al. 2014*, i ndryshuar.”²

PJESA B

KËRKESAT NË RAST DYSHIMI OSE KONFIRMIMI TË PRANISË SË DËMTUESIT TË SPECIFIKUAR NË VENDNDODHJET E PRODHIMIT DHE BURIMET UJORE NË EGJIPT

1. Në rastin e çdo dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar në një vendndodhje prodhimi, ose në ndonjë bimë të specifikuar me origjinë nga ajo vendndodhje prodhimi, të gjitha lotet e bimëve të specifikuar me origjinë nga ajo vendndodhje prodhimi nuk janë lëvizur dhe kanë mbetur nën mbikëqyrjen e NPPO-së së Egjiptit, përveç nëse, pas hetimeve të kryera nga kjo NPPO, konkludohet se prania e dëmtuesit të specifikuar nuk ka lidhje me vendndodhjen përkatëse të prodhimit.

2. Në rastin e çdo dyshimi për praninë e dëmtuesit të specifikuar në një burim uji në Egjipt, të gjitha lotet e bimëve të specifikuar me origjinë nga vendndodhjet e prodhimit ku është përdorur ky burim uji për ujitje nuk janë lëvizur dhe kanë mbetur nën mbikëqyrjen e NPPO-së së Egjiptit, përveç



nëse, pas hetimeve të kryera nga kjo NPPO, konkludohet se prania e dëmtuesit të specifikuar nuk ka lidhje me burimin përkatës të ujit.

3. Kur prania e dëmtuesit të specifikuar është konfirmuar në bimët e specifikuara në një vendndodhje prodhimi, përpara eksportit të tyre drejt territorit të Shqipërisë, ose në një burim uji në Egjipt, NPPO-ja e Egjiptit ka ndërmarr menjëherë këto veprime:

a) ka hequr nga lista e përmendur në shkronjën (a) të nënpikës 5.1 të pikës 5 të nenit 26, kodin e vendit të prodhimit të identifikuar si burimi i infektimit të bimëve të specifikuara me dëmtuesin e specifikuar;

b) ka hequr nga e njëjta listë kodin ose kodet e të gjitha vendndodhjeve të prodhimit që kanë përdorur ujë të infektuar gjatë vitit të kaluar;

c) i ka dërguar SPMB-së një listë të përditësuar me ndryshimet e bëra; dhe

d) ka ndaluar eksportin drejt territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara nga vendndodhjet e prodhimit të hequra nga lista.

4. Kur NPPO-ja e Egjiptit ka hequr një eksportues ose një stacion ambalazhimi nga listat e përmendura në shkronjat (b) ose (c) të nënpikës 5.1 të pikës 5 të nenit 26, ajo i ka dërguar menjëherë SPMB-së listat e përditësuara që pasqyrojnë ndryshimet e bëra dhe ka ndaluar eksportin drejt territorit të Shqipërisë të bimëve të specifikuara nga eksportuesit e hequr nga lista dhe të bimëve të specifikuara të ambalazuara në stacione të hequra nga lista.

SEKSIONI 2

KËRKESA SPECIFIKE QË DUHET TË PËRMBUSHEN PËR INSPEKTIMET E VENDNDODHJEVE TË PRODHIMIT SIPAS PIKËS 2 TË NENIT 26

Vendndodhjet e prodhimit kanë qenë subjekt i inspektimeve të thelluara gjatë periudhës së prodhimit të bimëve të specifikuara, me qëllim të zbulimit të dëmtuesit të specifikuar, të cilat janë kryer nga NPPO-ja e Egjiptit, ose nga një trupë e deleguar nga kjo NPPO-ja.

Për çdo vendndodhje prodhimi, këto inspektime kanë përfshirë:

a) inspektime të kulturës në rritje, për marrje mostrash nga bimët e specifikuara për testim dhe ekzaminim të zhardhokëve të prerë për simptoma të dëmtuesit të specifikuar dhe për testim;

b) në rastin e kultivimit të kulturave të tjera të familjes *Solanaceae* në të njëjtin vendndodhje prodhimi brenda tre vjetëve para prodhimit të bimëve të specifikuara për import në territorin e Shqipërisë, inspektime dhe marrje mostrash nga këto kultura për testim laboratorik;

c) në rastin e pranisë së bimëve të egra bujtëse të familjes *Solanaceae*, inspektime dhe marrje mostrash nga këto bimë për testim laboratorik;

ç) marrje mostrash për testim laboratorik nga burimet ujore në Egjipt dhe, në rast se një burim uji është përdorur për disa vendndodhje prodhimi, të paktën një mostër uji nga ky burim është marrë dhe testuar;

d) marrje mostrash për testim laboratorik në përputhje me udhëzimin nr. 24, datë 20.9.2024, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për çrrënjosjen dhe për parandalimin e përhapjes brenda vendit të kalbëzimit kaf *Ralstonia solanacearum* (Smith 1896) *Yabuuchi et al. 1996 emend Safni et al. 2014, i ndryshuar*.³

Çdo vit, rezultatet e inspektimeve për vitin kalendarik janë dorëzuar nga NPPO-ja e Egjiptit pranë SPMB-së, në çdo rast, jo më vonë se dorëzimi i listave të përmendura në nënpikën 5.1 të pikës 5 të nenit 26.

URDHËR

Nr. 571, datë 22.5.2026

PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË VEGJËL

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminatëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panaire dhe grumbullime të tjera në qarkun Durrës.

2. Ndalimin e lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imëta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për sëmundjen e Murtajës së Ruminantëve të Vegjël (PPR)”.

9. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

Nr.	Njësia Administrative	Fshati
3 km		
1.	Sukth	Rrushkull
2.	Katund i Ri	Jubë
3.	Sukth	Vadardhë
4.	Sukth	Hamallaj
5.	Sukth	Kulla
6.	Sukth	Perlat
10 km		
1.	Xhafzotaj	Fllakë
2.	Manzë	Manzë
3.	Sukth	Sukth
4.	Katund i Ri	Katund i Ri
5.	Shijak	Shijak
6.	Xhafzotaj	Xhafzotaj
7.	Rashbull	Arapaj

8.	Rashbull	Rrashbull
9.	Maminas	Maminas

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 575, datë 25.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HOLANDËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës, janë sipas tabelës së mëposhtme:



Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Drenthe	Aa en Hunze*
2.	Gelderland	Barneveld*
3.	Gelderland	Kesteren*
4.	Gelderland	Hummelo en Keppel*
5.	Flevoland	Noordoostpolder*
6.	Friesland	Achtkarspelen*
7.	Gelderland	Ede*
8.	Flevoland	Dronten*
9.	Noord-Holland	Beverwijk*
10.	Groningen	Delfzijl*
11.	Zuid-Holland	Dordrecht*
12.	Zeeland	Hulst*
13.	Limburg	Meerlo-Wanssum*
14.	Limburg	Helden*
15.	Overijssel	Wierden*
16.	Flevoland	Zeewolde*
17.	Gelderland	Nijkerk*
18.	Gelderland	Harderwijk*
19.	Drenthe	Coevorden*
20.	Gelderland	Ermelo*
21.	Noord-Brabant	Woudrichem*
22.	Limburg	Venray*
23.	Noord-Brabant	Deurne*
24.	Noord-Brabant	Oisterwijk*
25.	Zuid-Holland	Maasland*
26.	Gelderland	Buren*
27.	Overijssel	Almelo*
28.	Groningen	Stadskanaal*
29.	Friesland	Dongeradeel*
30.	Groningen	Eemsmond*
31.	Utrecht	Renswoude*
32.	Gelderland	Neede*
33.	Gelderland	Putten*
34.	Drenthe	Hoogeveen*
35.	Noord-Brabant	Moerdijk*
36.	Friesland	Ferwerderadiel*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 310, datë 24.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 576, datë 25.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË MBRETËRINË
E BASHKUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;



b) spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
England	Barnsley	Barnsley*
England	Bath and North East Somerset	Bath and North East Somerset*
England	Buckinghamshire	Buckinghamshire*
England	Bournemouth, Christchurch and Poole	Bournemouth, Christchurch and Poole*
England	Bracknell Forest	Bracknell Forest*
England	Bradford	Bradford*
England	Calderdale	Calderdale*
England	Cambridgeshire	East Cambridgeshire*
England	Cambridgeshire	South Cambridgeshire*
England	Central Bedfordshire	Central Bedfordshire*
England	Cheshire East	Cheshire East*
England	Cheshire West and Chester	Cheshire West and Chester*
England	Cornwall	Cornwall*
England	Cumberland	Cumberland Council*
England	Derbyshire	Amber Valley*
England	Derbyshire	Bolsover*
England	Derbyshire	Derbyshire Dales*
England	Derbyshire	High Peak*
England	Derbyshire	North East Derbyshire*
England	Devon	East Devon*
England	Devon	Mid Devon*
England	Devon	Teignbridge*
England	Devon	South Hams*
England	Devon	West Devon*
England	Dorset	Dorset*
England	Gloucestershire	Stroud*
England	Gloucestershire	Cotswold*
England	East Riding of Yorkshire	East Riding of Yorkshire*
England	East Sussex	Rother*
England	East Sussex	Lewes*
England	East Sussex	Wealden*
England	Essex	Braintree*
England	Essex	Brentwood*
England	Essex	Chelmsford*
England	Essex	Colchester*
England	Essex	Epping Forest*
England	Essex	Maldon*
England	Essex	Harlow*
England	Essex	Tendring*
England	Greater London	Harrow*
England	Herefordshire, County of	Herefordshire, County of*
England	Hertfordshire	Dacorum*
England	Hertfordshire	East Hertfordshire*
England	Hertfordshire	Hertsmere*
England	Hertfordshire	Three Rivers*
England	Medway	Medway*

England	Milton Keynes	Milton Keynes*
England	Shropshire	Shropshire*
England	Kent	Ashford*
England	Kent	Canterbury*
England	Kent	Dover*
England	Kent	Gravesham*
England	Kent	Folkestone and Hythe*
England	Kent	Maidstone*
England	Kent	Sevenoaks*
England	Kent	Swale*
England	Kent	Tonbridge and Malling*
England	Kent	Tunbridge Wells*
England	Kirklees	Kirklees*
England	Isle of Wight	Isle of Wight*
England	Somerset	Somerset Council*
England	Suffolk	East Suffolk*
England	Suffolk	Babergh*
England	Suffolk	Mid Suffolk*
England	Suffolk	Waverley*
England	Suffolk	West Suffolk*
England	Surrey	Guildford*
England	Surrey	Runnymede*
England	Hampshire	Basingstoke and Deane*
England	Hampshire	East Hampshire*
England	Hampshire	Eastleigh*
England	Hampshire	Hart*
England	Hampshire	Test Valley*
England	Hampshire	New Forest*
England	Hampshire	Winchester*
England	Lancashire	Chorley*
England	Lancashire	Hyndburn*
England	Lancashire	Lancaster*
England	Lancashire	Ribble Valley*
England	Leicestershire	Charnwood*
England	Leicestershire	Harborough*
England	Leicestershire	Hinckley and Bosworth*
England	Leicestershire	North West Leicestershire*
England	Lincolnshire	East Lindsey*
England	Lincolnshire	West Lindsey*
England	Lincolnshire	South Kesteven*
England	Staffordshire	East Staffordshire*
England	Staffordshire	Newcastle-under-Lyme*
England	Staffordshire	Stafford*
England	Staffordshire	Staffordshire Moorlands*
England	Staffordshire	South Staffordshire*
England	Southampton	Southampton*
England	South Gloucestershire	South Gloucestershire*
England	Stockport	Stockport*
England	Norfolk	Breckland*
England	Norfolk	Broadland*
England	Norfolk	Great Yarmouth*
England	Norfolk	King's Lynn and West Norfolk*
England	Norfolk	South Norfolk*
England	Norfolk	North Norfolk*



England	North Yorkshire	North Yorkshire Council*
England	Nottinghamshire	Bassetlaw*
England	Nottinghamshire	Newark and Sherwood*
England	Oxfordshire	South Oxfordshire*
England	Oxfordshire	Vale of White Horse*
England	Tameside	Tameside*
England	Trafford	Trafford*
England	Thurrock	Thurrock*
England	York	York*
England	West Berkshire	West Berkshire*
England	Wiltshire	Wiltshire*
England	Wokingham	Wokingham*
England	Westmorland and Furness Council	Westmorland and Furness Council*
England	West Sussex	Arun*
England	West Sussex	Chichester*
England	West Sussex	Horsham*
England	West Sussex	Mid Sussex*
Isle of Man	Glenfaba	Patrick*
Isle of Man	Middle	Braddan*
Isle of Man	Rushen	Arbory*
Isle of Man	Rushen	Rushen*
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Brightlingsea*	
United Kingdom Exclusive Economic Zone	Middleton*	
Wales	Denbighshire	Denbighshire*
Wales	Monmouthshire	Monmouthshire*
Wales	Powys	Powys*
Wales	Wrexham	Wrexham*
Northern Ireland	North Down and Ards	Ards*
Northern Ireland	Ards and North Down	North Down*
England	Wakefield	Wakefield*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërtetohet që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë Culicoides, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) Janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjithë serotipave të demonstruar të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjithë serotipave të demonstruar se janë të pranishëm në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërtetohet që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1 të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupeve ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të



mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe

Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermën dhe embrionet e kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 498, datë 11.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në Mbretërinë e Bashkuar”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 577, datë 25.5.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR.
231, DATË 4.3.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË”**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 3 të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1.1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 231, datë 4.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.

2.2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i



Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 579, datë 28.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETET E BASHKUARA
TË AMERIKËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- d) materialit biologjik të shpendëve;
- e) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
1.	Kansas	Grant*
2.	Kansas	Anderson*
3.	New Jersey	Burlington*
4.	Montana	Carbon*
5.	Iowa	Kossuth*
6.	Kansas	Pratt*
7.	Texas	Shelby*

8.	Kansas	Nemaha*
9.	Indiana	Elkhart*
10.	Indiana	Noble*
11.	Michigan	Kent*
12.	Indiana	LaGrange*
13.	Minnesota	Meeker*
14.	Illinois	Crawford*
15.	Illinois	Lawrence*
16.	Colorado	Weld*
17.	North Carolina	Hyde*
18.	Indiana	Daviess*
19.	Illinois	Perry*
20.	North Carolina	Wayne*
21.	South Carolina	Lee*
22.	Indiana	Boone*
23.	Mississippi	Amite*
24.	Kansas	Haskell*
25.	Minnesota	Kandiyohi*
26.	Arkansas	Clay*
27.	South Dakota	Hutchinson*
28.	South Dakota	Edmunds*
29.	New Jersey	Hunterdon*
30.	Indiana	Crawford*
31.	North Dakota	Lamoure*
32.	North Dakota	Dickey*
33.	Minnesota	Big Stone*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.



7. Urdhri nr. 489, datë 6.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 580, datë 28.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Chemihiv	Ripkyns'kyi*	
Chemihiv	Chemivets'ka*	
Chemihiv	Nizhyns'kyi*	
Chemihiv	Kozelets'kyi*	
Chemihiv	Pryluts'kyi*	
Chemihiv	Nosivs'kyi*	
Chemihiv	Sribnians'kyi*	
Chemihiv	Mens'kyi*	
Chemivtsi	Hlybots'kyi*	
Chemivtsi	Sokyrans'kyi*	
Chemivtsi	Storozhynets'kyi*	
Chemivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Cherkasy	Cherkas'kyi*	
Dnipropetrovs'k	Mahdalynivs'kyi*	
Dnipropetrovs'k	Sofivs'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Donets'k	Krasnolymans'kyi*	
Donets'k	Velykonovosilivs'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kharkiv	Valkivs'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Baryshivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'kyi*	
Kirovohrad	Oleksandriis'kyi*	
Kirovohrad	Petrivs'kyi*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Chudnivs'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomys'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Kherson	Velykooleksandrivs'kyi*	
L'viv	Zhovkivs'kyi*	
Mykolayi	Mykolavcs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayi	Berezhnevats'kyi*	
Mykolayiv	Kazanetskyi*	
Mykolayiv	Kryvoozers'kyi*	
Mykolayiv	Novobuz'kyi*	
Mykolayiv	Vradkivs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Odessa	Izmad's'ka*	
Odessa	Bilhorod-Dnistrovs'kyi*	
Odessa	Bilavcs'kyi*	
Poltava	Hlobyns'kyi*	
Poltava	Khorol's'kyi*	
Poltava	Kobelians'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	
Poltava	Poltavs'kyi*	



Poltava	Semenivs'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Rozhnativs'kyi*	
Sumy	Konotops'kyi*	
Sumy	Krolevets'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Nedryhailivs'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Sumy	Sums'kyi*	
Vinnitsya	Bershad's'kyi*	
Vinnitsya	Iampil's'kyi*	
Vinnitsya	Illinets'kyi*	
Vinnitsya	Litvyn's'kyi*	
Vinnitsya	Lypovets'kyi*	
Vinnitsya	Tul'chyn's'kyi*	
Zaporizhzhya	Orikhivs'kyi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe e tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të

përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur, në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre



vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

c) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe

janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe



nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 552, datë 20.5.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 581, datë 28.5.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 432, DATË 21.4.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E MBRETËRISË
SË BASHKUAR”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në nenin 113, të

ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 432, datë 21.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Mbretërisë së Bashkuar”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 582, datë 28.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;



e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszczewo*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Żuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Poddębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Ślupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemien*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wohryn*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzecz Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
42.	Wielkopolskie	Turek	Brudzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęczyno*
45.	Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzany*
51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Legnica	Prochowice*

53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Nad Prosną*
54.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
55.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Janikowo*
56.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
57.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
58.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Kruszwica*
59.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Lwówek*
60.	Wielkopolskie	Leszno	Włoszakowice*
61.	Łódzkie	Brzeziny	Jeżów*
62.	Mazowieckie	Żuromin	Biezuń*
63.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
64.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sierszowice*
65.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzycy*
66.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
67.	Mazowieckie	Mława	Strzegowo*
68.	Mazowieckie	Żuromin	Kuczork- Osada*
69.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
70.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
71.	Mazowieckie	Płońsk	Baboszewo*
72.	Wielkopolskie	Kalisz	Brzeziny*
73.	Pomorskie	Starogard	Skarszewy*
74.	Mazowieckie	Mława	Stupsk*
75.	Lubuskie	Żary	Żary*
76.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
77.	Kujawsko-Pomorskie	Golub-Dobrzyń	Kowalewo Pomorskie*
78.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Raszków*
79.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Nowe Miasto Lubawskie (rural)*
80.	Mazowieckie	Sierpc	Gozdowo*
81.	Lubelskie	Biała Podlaska	Drelów*
82.	Dolnośląskie	Wrocław	Długolęka*
83.	Mazowieckie	Plock	Stara Biała*
84.	Mazowieckie	Plock	Bielsk*
85.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Purda*
86.	Kujawsko-Pomorskie	Brodnica	Bartniczka*
87.	Łódzkie	Zgierz	Aleksandrów Łódzki*
88.	Mazowieckie	Żuromin	Lubowidz*
89.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Rybno*
90.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
91.	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
92.	Wielkopolskie	Jarocin	Kotlin*
93.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.



5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 536, datë 18.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 594, datë 29.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të Ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70°C në 3.6 sekonda;

iii. 74°C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Polonisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wolomin	Thuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21.	Mazowieckie	Zuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Zuromin	Zuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*



27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemet*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszyniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytów*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminiek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyna*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81.	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82.	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83.	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84.	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85.	Śląskie	Mikolów	Mikolów*
86.	Mazowieckie	Mława	Szeńsk*

87.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88.	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszewo*
89.	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
90.	Opolskie	Olesno	Zębówice*
91.	Małopolskie	Wieliczka	Wieliczka*
92.	Śląskie	Cieszyn	Hażlach*
93.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
94.	Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
95.	Kujawsko-Pomorskie	Sępólno	Sośno*
96.	Zachodniopomorskie	Gryfice	Gryfice*
97.	Kujawsko-Pomorskie	Brodnica	Świdziebina*
98.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Żnin*
99.	Kujawsko-Pomorskie	Mogilno	Jeziora Wielkie*
100.	Pomorskie	Sztum	Sztum*
101.	Pomorskie	Bytów	Studzienice*
102.	Pomorskie	Człuchów	Przechlewo*
103.	Wielkopolskie	Oborniki	Oborniki*
104.	Kujawsko-Pomorskie	Tuchola	Tuchola*
105.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
106.	Wielkopolskie	Pila	Białosławie*
107.	Lubuskie	Zielona Góra (City)	Zielona Góra*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk kanë pasur njofim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.



7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 554, datë 20.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

VENDIM
Nr. 44, datë 2.4.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 31.3.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 17 (S) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sali Hasa, përfaqësuar nga avokatët Ermir Dobjani dhe Erajd Dobjani, me prokurë të posaçme.

SUBJEKTI I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Bledar Maksuti.

OBJEKTI: Shfuqizimi pjesërisht i vendimeve nr. 18, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të

cilin është ndryshuar vendimi nr. 36, datë 31.5.2022, i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1823 (281), datë 14.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, lidhur me deklarimin fajtor dhe dënimin e kërkuesit për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 30, 42, 43, 131, shkronjat “a” dhe “f”, si dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pikat 1 dhe 2, 7 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 27, 49, pika 3, 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit Sali Hasa (*kërkuesi*), që ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi është proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme për veprat penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë” dhe “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i remë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, të parashikuara respektivisht nga nenet 319/ç dhe 257/a, paragrafi i dytë, të Kodit Penal (KP). Lidhur me veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, prokuroria ka arritur në përfundimin se kërkuesi, në detyrën e prokurorit: i. ka fshehur pasurinë e paluajtshme të



llojit “tokë” (kullotë), 2000 m², të ndodhur në Palermo, Himarë, duke e regjistruar në mënyrë formale në emër të dy fëmijëve të tij; ii. gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar e ka deklaruar në mënyrë të rreme atë, duke e pasqyruar vetëm si një pasuri prej 1000 m², të fituar me dhurim nga një i tretë në favor të dy fëmijëve të tij.

2. Në përfundim të gjykimit të shkurtuar të çështjes, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 36, datë 31.5.2022, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin të pafajshëm të kërkuarit për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së. Sipas asaj gjykate, nuk provohej fakti penal i fshehjes dhe deklarimit të rremë, pasi kontrata e dhurimit përcaktonte qartë sipërfaqen e dhuruar, ajo ishte deklaruar rregullisht, veprimet e mëpasshme nuk zhbënin vullnetin e qartë të kontratës së dhurimit dhe shkaku i dhurimit lidhej me njohjet familjare, pra jo me ndonjë rast të konfliktit të interesit. Prokurori i Posaçëm ka paraqitur apel ndaj vendimit, duke kundërshtuar, ndër të tjera, edhe pjesën që ka vendosur pafajësinë e kërkuarit.

3. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*), me vendimin nr. 18, datë 23.3.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar fajtor kërkuarin për të dyja veprat penale që akuzohej dhe e ka dënuar atë përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Në lidhje me akuzën e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, gjykata e apelit ka vlerësuar se provohej përtej çdo dyshimi se kërkuari kishte fshehur pasurinë dhe e kishte deklaruar në mënyrë të rreme atë, pasi: i. kishte deklaruar vetëm një pjesë të pasurisë të regjistruar (1000 m² nga 2000 m²); dhe ii. ndonëse kontrata e dhurimit ishte “e përmbyllur” *de jure* në emër të fëmijëve të tij, *de facto* përfitues i pronës së dhuruar ishte vetë kërkuari. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuari.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1823 (281), datë 14.11.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit për pjesën që ka vendosur fajësinë e kërkuarit për akuzën e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, me arsyetimin se nuk evidentohej ndonjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ndërsa për pjesën që ka vendosur

fajësinë e kërkuarit për veprën penale të korrupsionit pasiv, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së, Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatën e apelit.

5. Në datën 13.6.2025 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Me vendimin e datës 30.7.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 15.9.2025, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet e kundërshtuara i janë cenuar:

6.1. *E drejta e mosdënimit pa ligj*, e garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, për shkak të interpretimit antikushtetues të ligjit. Fakti i fshehjes dhe deklarimit të rremë të pasurisë në deklaratën “*Vetting*” nuk parashikohet si vepër penale në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji për Rivlerësimin Kalimtar*). Gjykatat kanë analizuar edhe ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar (*Ligji për Deklarimin e Pasurisë*), i cili nuk është miratuar me shumicë të cilësuar. Neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së nuk mund të zbatohet për raste të parashikuara si vepra penale në ndonjë ligj tjetër jashtë përmbytjes së KP-së, kur ai ligj nuk është miratuar sipas nenit 81, pika 2, të Kushtetutës. Rregullimi i pasaktë i normës i lë shteg zbatuesit t’i japë asaj kuptime të ndryshme, të tilla që çojnë rrjedhimisht në krijimin e problemeve. Kërkuari, në cilësinë e subjektit deklarues, nuk mban përgjegjësi ligjore për veprimet ose mosveprimet e anëtarëve madhorë të familjes që kanë pasuri të regjistruara në emër të tyre.

6.2. *Parimi i sigurisë juridike*, i garantuar nga neni 4 i Kushtetutës, pasi në përfundim të hetimeve në vitin 2022 ai është akuzuar për veprime që janë deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë të vitit



2014 të dorëzuar në datën 16.3.2015. Në këtë mënyrë ligjit penal i është dhënë fuqi prapavepruese dhe vepra penale është parashkruar. Gjykatat duhet të konsideronin datën e parë të deklarimit të veprimeve, pasi individit nuk mund të dënohet sa herë shteti kërkon përsëritjen e deklarimit, për më tepër që Kushtetuta dhe KP-ja e kanë përjashtuar institutin e rivënies në afat për veprat penale që janë parashkruar.

6.3. *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

6.3.1. *Parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve*, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar faktet që shfaqësonin kërkuesin, vlerën e indiceve që përmbajnë mesazhet dhe përgjimet telefonike të kërkuesit dhe dhuruesit të pasurisë, vlerën e shkresës së zyrës së kadastrës së Vlorës se prona është regjistruar gabimisht dy herë, pasi është depozituar dy herë kontrata e dhurimit ose faktin që të ketë dy kontrata dhurimi duhet të ketë dy deklarata noteriale për pranimin e dhurimit. Këto pasaktësi dhe gabime në dukje kanë rënduar pozitën e kërkuesit. Gjykata e apelit nuk ka pranuar të marrë në shqyrtim si prova dokumentet e depozituara me shkrim nga kërkuesi në gjykatën e shkallës së parë në datën 18.2.2022, me argumentin e shqyrtimit të çështjes me ritin e gjykimit të shkurtuar, ndonëse ka pranuar kërkesën e prokurorit për rishqyrtimin gjyqësor të provave, duke u bërë në këtë mënyrë palë me prokurorin në dëm të kërkuesit. Provat nuk i janë nënshtruar debatit gjyqësor dhe ato nuk janë të mjaftueshme tej çdo dyshimi të arsyeshëm për të vërtetuar ekzistencën e faktit penal, për rrjedhojë gjykatat kanë cenuar edhe *parimin e prezumimit të pafajësisë*.

6.3.2. *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor i lidhur me aksesin në gjykatë*, pasi gjykata e apelit nuk ka arsyetuar për momentet kryesore të akuzës dhe vendimi është kontradiktor, ka paragjykim në dëm të personit të akuzuar dhe bazohet në supozime dhe hamendësim dhe jo në të gjitha provat e marra gjatë hetimeve paraprake dhe të verifikuara në procesin gjyqësor, duke e shpallur fajësinë e kërkuesit jo sipas standardit “tej çdo dyshimi të arsyeshëm”. Cenimi i këtyre standardeve është provuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim për akuzën e korrupsionit pasiv dhe po njësoj ajo duhet të kishte disponuar edhe ndaj akuzës për veprën penale të fshehjes dhe deklarimit të rremë të pasurisë. Po kështu, Gjykata e Lartë, duke u gjendur përpara dy vendimeve kontradiktore të gjykatave të

faktit për sa i takon akuzës për veprën penale sipas nenit 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, nuk mund të vendoste mospranimin e rekursit, por ajo duhej të shprehej se cilin vendim linte në fuqi. Ajo ka inkorporuar të njëjtin arsyetim të gjykatës së apelit pa bërë vetë një analizë të pretendimeve të kërkuesit të paraqitura në rekurs për ligjin e zbatueshëm, duke e bërë arsyetimin e saj të vakët dhe të pamjaftueshëm.

6.3.3. *E drejta për t'u mbrojtur*, pasi prokuroria nuk ka krijuar lehtësi për të përgatitur dhe realizuar mbrojtjen në kushtet kur aktet e hetimeve paraprake janë përfshirë në 30 volume të përbëra nga 8000 fletë pa një rend dhe rregullsi. Një pjesë e konsiderueshme e akteve janë në formatin e fotokopjes të përsëritura disa herë të dokumenteve të administruara gjatë procesit të rivlerësimit. Materialet në format elektronik të vëna në dispozicion për mbrojtjen nuk përputheshin me përmbajtjen e dosjeve fizike. Kjo gjë ka vënë në vështirësi serioze jo vetëm përgatitjen e mbrojtjes, por edhe vetë gjykatat në shqyrtimin gjyqësor të çështjes.

6.3.4. *Parimi i transparencës dhe objektivitetit në hetimet paraprake*, pasi prokurori i çështjes është caktuar pa short dhe të gjitha veprimet hetimore të kryera prej tij janë të vesuara dhe rezultat i një obsesioni të pabazë, subjektiv dhe të pamotivuar ligjërisht. Pavarësisht se ka kërkuar disa herë informacione lidhur me regjistrimin e njoftimit të veprës penale në ngarkim të tij, nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare. Prokuroria ka keqzbatuar pikën 1 të nenit 287 të KPP-së dhe kërkuesi ka qëndruar nën hetim nga data 17.2.2020 deri në datën 28.1.2022, pra rreth 23 muaj, ndërkohë që gjykata ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për zgjatjen e hetimeve vetëm një herë, pra janë të justifikuar vetëm 8 muaj. Po kështu, gjatë përgjimit është *shkelur privatësia e tij*, e garantuar nga neni 36 i Kushtetutës.

7. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e brendshme juridike të parashikuara nga ligji për zgjidhjen e çështjes. Kjo, pasi GJKKO-ja e Apelit, pas rishqyrtimit të çështjes, me vendimin nr. 28 (87-2025-209), datë 18.6.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për deklarimin e kërkuesit fajtor për kryerjen e veprës penale të korrupsionit pasiv, dënimin e tij përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim dhe



moszbatimin e nenit 59 të KP-së. Në këtë situatë, GJKKO-ja e Apelit i ka shqyrtuar të dyja vendimet objekt kundërshtimi të ankimit kushtetues individual dhe nuk ka njoftim nëse kërkuesi ka ushtruar rekurs ndaj atij vendimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

9. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në të cilin janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ai justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

10. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, sipas të cilit Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t'u jetë drejtuar të gjitha shkallëve të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*sibih vendimet nr. 3, datë 15.1.2026; nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër,

Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore që kthejnë çështjen për rigjykim, si rregull, nuk janë përfundimtare për efekte të gjyimit kushtetues, pasi ato nuk zgjidhin themelin e çështjes e se, në të tilla raste, kërkuesi i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të tij gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese në këtë Gjykatë (*sibih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 39, datë 6.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, Gjykata vëren se kërkuesi është akuzuar për dy vepra penale, ndaj për këtë shkak ka pasur bashkim të procedimeve në kuptim të nenit 79 të KPP-së. Procedimi penal për akuzën penale të deklarimit të rremë dhe të fshehjes së pasurisë, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, ka përfunduar në datën 14.11.2024, kur Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit ndaj vendimit penal të dënimit. Ndërsa procedimi penal për akuzën penale të korrupsionit pasiv, të parashikuar nga neni 319/ç i KP-së, është në zhvillim e sipër, pasi Gjykata e Lartë, me të njëjtin vendim të datës 14.11.2024, ka vendosur rigjykimin e çështjes në gjykatën e apelit. Kjo e fundit, në datën 18.6.2025 (pas paraqitjes së ankimit kushtetues) dha vendim dënimi me burgim për kërkuesin. Mbi bazën e rekursit të kërkuesit, çështja për akuzën e parashikuar nga neni 319/ç i KP-së u regjistrua në Gjykatën e Lartë në datën 21.11.2025 dhe aktualisht është në pritje për shqyrtim.

12. Ndërkohë, kërkuesi në ankimin kushtetues individual ka kundërshtuar vendimet gjyqësore të gjykatës së apelit të vitit 2023 dhe të Gjykatës së Lartë të vitit 2024, për atë pjesë që kanë përmblyllur procedimin penal për akuzën e parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, duke parashtruar se ato janë përfundimtare për qëllime të kontrollit kushtetues.

13. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se kërkuesi nuk ka ezauruar të gjitha mjetet e brendshme juridike të parashikuara nga ligji për zgjidhjen e çështjes, për shkak se Gjykata e Lartë ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e apelit. Kjo e fundit, pas rishqyrtimit të çështjes të urdhëruar nga Gjykata e Lartë, në datën 18.6.2025 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë për fajësinë e kërkuesit për veprën penale të korrupsionit pasiv, ndaj sipas



subjektit të interesuar, vendimet e kundërshtuara nuk mund të konsiderohen përfundimtare.

14. Gjykata, duke analizuar rrethanat procedurale të vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë, vëren se në datën 14.11.2024 procedimet penale janë ndarë *de facto* sipas akuzave, në kuptim të nenit 93 të KPP-së. Procedimi penal për akuzën e fshehjes dhe deklarimit të rremë të pasurisë është përmbyllur me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 14.11.2024 me mospranimin e rekursit të kërkuarit. Për këtë arsye, në ndryshim nga sa prapëson subjekti i interesuar, Gjykata çmon se për vendimet gjyqësore që lidhen me këtë akuzë kërkuari e ka përmbyllur kriterin e shterimit të mjeteve juridike në dispozicion, pasi i ka përdorur formalisht të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apeli me në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm.

15. Për sa i takon aspektit substancial të shterimit të mjeteve juridike, Gjykata do të analizojë fillimisht pretendimet për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe asaj për jetë private. Në kuadër të këtyre pretendimeve, kërkuari ka parashtruar se hetimet paraprake nuk kanë qenë objektive dhe transparente, si dhe i kanë cenuar të drejtën për jetë private, duke argumentuar, ndër të tjera, se: i. prokuroria ka keqzbatuar pikën 1 të nenit 287 të KPP-së dhe megjithëse afati i hetimeve është zgjatuar vetëm një herë me vendim të gjykatës, ai ka qëndruar nën hetim për 23 muaj; ii. si pasojë e përgjimit atij i është cenuar e drejta e jetës private; iii. Gjykata e Lartë e ka kthyer çështjen për rishqyrtim në gjykatën e apeli, duke konstatuar, bazuar në nenin 319/ç të KP-së, pamjaftueshmëri arsyetimi në analizimin dhe shqyrtimin e provave, konkretisht të rezultateve të përgjimit.

16. Gjykata çmon se për këto pretendime kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, në kuptimin substancial, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim. Konkretisht, nuk rezulton që pretendimet për kohëzgjatjen e hetimeve paraprake dhe cenimin e jetës private nga përgjimet të jenë ngritur më parë prej tij gjatë shqyrtimit të akuzës së fshehjes dhe deklarimit të rremë të pasurisë në gjykatat e zakonshme. Ndërsa në lidhje me rregullsinë e veprimeve të përgjimit, siç u evidentua më lart (*shih paragrafin 11 të vendimit*), procedimi penal për akuzën e korrupsionit pasiv nuk është bërë ende përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, ndaj kërkuari ka ende mjetin ligjor të rekursit në dispozicion.

17. Ndryshe paraqitet situata për pretendimet që lidhen me cenimin e të drejtave të mosdënimit pa ligj dhe të procesit të rregullt ligjor në aspektet e tjera (kontradiktoriteti dhe barazia e armëve të lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, standardi i arsytimit i lidhur me aksesin, mbrojtja dhe objektiviteti i hetimeve paraprake i lidhur me procedurat për caktimin e prokurorit), si dhe të parimit të sigurisë juridike, të cilat kërkuari i ka ngritur në përmbajtje të rekursit drejtuar Gjykatës së Lartë. Rrjedhimisht, për këto pretendime ai e ka përmbyllur kriterin e shterimit të mjeteve juridike, si në aspektin formal, ashtu edhe atë substancial.

18. Kërkuari legjitimohet edhe *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës dhe në jurisprudencën kushtetuese (*shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi i arsyetuar i Gjykatës së Lartë i është përcjellë avokatit të kërkuarit në rrugë elektronike në datën 14.2.2025, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 13.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuari ka pretenduar cenimin e së drejtës së mosdënimit pa ligj, së drejtës për proces të rregullt ligjor në disa aspekte (parimi i kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve i lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë, standardi i arsytimit të vendimit i lidhur me aksesin në gjykatë, e drejta për t'u mbrojtur dhe objektiviteti i hetimeve paraprake i lidhur me procedurat për caktimin e prokurorit), si dhe parimin e sigurisë juridike.

20. Lidhur me pretendimin për objektivitetin e hetimeve paraprake, kërkuari ka parashtruar se prokurori nuk është caktuar me short dhe se ai e ka disfavorizuar me dashje në përgatitjen e materialeve hetimore. Këtë pretendim gjykatat e faktit e kanë analizuar në drejtim të paanshmërisë së prokurorit të çështjes dhe e kanë gjetur të pabazuar. Kështu, GJKKO-ja e Apeli është shprehur se ndjekja penale dhe përfaqësimi i akuzës në gjykim janë kryer në përputhje me nenin 148 të Kushtetutës dhe nenin 24, pika 1, të KPP-së, pasi nuk ka pasur ndonjë shkak ligjor për zëvendësimin e prokurorit të çështjes. Gjithashtu, ajo gjykatë ka vënë në dukje se drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka rrëzuar kërkesën për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, me arsyetimin se pretendimet e ngritura lidheshin me vlerën provuese që provat kishin për akuzën, prova të cilat do të verifikoheshin gjyqësisht. Sipas



gjykatës së apelit, neni 27 i KPP-së ka parashikuar situatat e zëvendësimit të prokurorit nga drejtuesi i prokurorisë dhe këtë mekanizëm ligjor e ka ndjekur edhe kërkuesi, kërkesa e të cilit është rrëzuar. Gjykata e Lartë është shprehur se kërkuesi ka marrë përgjigje të argumentuar për të gjitha pretendimet thelbësore të ngritura në apel, që do të thotë se arsyetimi i gjykatës së apelit për paanshmërinë e hetimeve është legjitimuar edhe prej Gjykatës së Lartë. Në këtë situatë, Gjykata çmon se, siç kanë vënë në dukje me të drejtë gjykatat e zakonshme, nuk është vërtetuar ndonjë rrethanë që të vërë në dyshim paanshmërinë e prokurorit gjatë këtij procesi, që të cenojë rregullshmërinë në përfaqësimin e akuzës gjatë hetimit dhe gjykimit të çështjes. Në këtë kuptim pretendimi i tij për rregullat e shortit të caktimit të prokurorit të çështjes mbetet pa përmbajtje në aspektin kushtetues, ndaj nuk mund të merret në shqyrtim.

21. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur, kërkuesi ka parashtruar se prokuroria nuk i ka krijuar lehtësi të përshtatshme për të përgatitur dhe realizuar mbrojtjen, pasi aktet e hetimeve paraprake kanë qenë voluminoze, pa një rend dhe rregullsi, gjë që ka vështirësuar aksesin në to (*shih paragrafin 6.3.3. të vendimit*).

22. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se e drejta e mbrojtjes në procesin penal, e garantuar nga neni 31, shkronja "b", i Kushtetutës, nuk duhet të pengohet. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm duhet të marrin të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të rregullt ligjor t'i japin mundësinë individit të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar parimin e barazisë së armëve (*shih vendimet nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 35, datë 1.6.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata thekson se lehtësimi të së drejtës së mbrojtjes i shërbejnë edhe rregullat ligjore dhe nënligjore për formën e akteve, inventarizimin dhe sistemimin e tyre në fashikull, si në fazën e hetimit paraprak, ashtu edhe gjatë gjykimit të çështjes. Organizimi i akteve në fashikull, në thelb, është veprimtari administrative, megjithatë në raste të veçanta ajo mund të ndërhyjë në të drejtën e palëve për proces të rregullt ligjor, duke marrë kështu në dukje vlerë kushtetuese. Në një çështje penale voluminoze, sistemimi dhe organizimi i rregullt i akteve në fashikull mundëson aksesin pa vonesa në aktet e procedimit, duke ndihmuar ushtrimin efektiv të së drejtës së mbrojtjes

dhe respektimin e parimit të barazisë së armëve. Në këtë kuptim, renditja kronologjike dhe logjike e dokumentacionit procedural i shërben orientimit të gjykatës dhe palëve në çështje, lehtëson administrimin dhe vlerësimin e provave, si dhe shmang paqartësinë ose shpërfilljen e elementeve me rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

24. Thënë sa më lart, Gjykata çmon se për të vlerësuar nëse organizimi i akteve në fashikull ka cenuar të drejtën e mbrojtjes, duhen parë disa elemente së bashku: i. nëse ka parregullsi objektive në renditje, indeksim ose përfshirje të dokumenteve; ii. nëse këto parregullsi kanë penguar realisht aksesin e mbrojtjes dhe përdorimin në kohë të provave; iii. nëse këto parregullsi kanë krijuar disavantazh procedural për individin; iv. nëse këto parregullsi kanë ndikuar në drejtësinë e vendimit.

25. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se çështja e kërkuesit është komplekse dhe përfshin një volum të madh aktesh hetimore, çka ka sjellë vështirësi në sistemimin dhe shqyrtimin e tyre. Megjithatë, nuk konstatohet një parregullsi objektive në organizimin e fashikullit e tillë që të ketë cenuar aksesin në dokumente. Po ashtu, nuk rezulton që mbrojtja të jetë penguar realisht në njohjen ose përdorimin e provave, pasi ajo është ushtruar në çdo fazë nga avokatë të zgjedhur, të cilët kanë marrë pjesë aktivisht në proces. Në këto kushte, parregullsitë e mundshme nuk kanë krijuar disavantazh procedural dhe as kanë ndikuar në drejtësinë e vendimarrjes. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mënyra e organizimit të akteve gjatë hetimit në rastin e kërkuesit nuk përbën argument të mjaftueshëm kushtetues për të mbështetur pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u mbrojtur.

26. Për sa u takon pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se ato kanë të bëjnë me mënyrën sesi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë gjykuar dhe arsyetuar bazueshmërinë e akuzës së Prokurorisë së Posaçme për veprën penale të deklarimit të rremë dhe fshehjes së pasurisë mbështetur mbi dokumentet e dorëzuara në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, në kushtet kur ai për këtë akuzë ishte shpallur i pafajshëm nga gjykata e shkallës së parë. Duke mbajtur në konsideratë se kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit dhe se interpretimi i ligjit i nënshtrohet juridiksionit kushtetues, vetëm



kur shoqërohet me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata çmon ta analizojë çështjen në këndvështrim të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës së mosdënimit pa ligj, të garantuara respektivisht nga nenet 30 dhe 29 të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

27. Kërkuesi ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka analizuar përmbajtjen e provave që e shfajësonin atë në drejtim të faktit se regjistrimi i dy pasurive ishte gabim faktik i zyrës së kadastrës. Sipas tij, ajo gjykatë është bërë palë me prokurorin, pasi ka rishqyrtuar provat e paraqitura nga organi i akuzës, ndërsa ka refuzuar të shqyrtojë dokumentet e depozituara nga kërkuesi në gjykimin në shkallë të parë. Provat nuk janë të mjaftueshme tej çdo dyshimi të arsyeshëm për të vërtetuar ekzistencën e faktit penal. Gjithashtu, sipas kërkuesit, vendimi i gjykatës së apelit përmban paragjykitime dhe supozime të paarsyeshme. Gjykata e Lartë, sipas tij, gjendej përpara dy vendimeve të kundërta të gjykatave të faktit, ndaj nuk duhet të vendoste mospranimin e rekursit.

28. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur ndonjë prapësim lidhur me këtë pretendim, pasi ka mbajtur qëndrimin se çështja nuk duhet të shqyrtohet në themel (*shih paragrafin 7 të vendimit*).

29. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

30. Gjykata ka theksuar se, në rastin e gjykimit penal, parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërës të procesit të rregullt ligjor. Ai kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.4.2025; nr. 20, datë 3.4.2024; nr. 4, datë 21.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të

përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 12, datë 24.4.2018; nr. 68, datë 14.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Nën dritën e standardeve kushtetuese të mësipërme, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj tij gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, që kanë të bëjnë me: i. ndalimin e shfaqjes së paragjykitimeve për shkak të refuzimit të marrjes së provave që e shfajësonin kërkuesin; ii. vlerësimin e dyshimeve në favor të kërkuesit.

32. Në drejtim të ndalimit të shfaqjes së paragjykitimeve, kërkuesi ka parashtruar se gjykata e apelit ka refuzuar marrjen e provave të kërkuara prej tij, ndonëse ka vendosur përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor. Në lidhje me këtë argument, Gjykata vëren se gjatë seancës paraprake kërkuesi ka kërkuar gjykimin e shkurtuar të çështjes. GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka pranuar kërkesën, pasi ka çmuar se çështja mund të zgjidhej në gjendjen që ishin aktet. Për rrjedhojë, gjykimi në shkallë të parë është zhvilluar vetëm mbi bazën e akteve të mbledhura gjatë hetimeve paraprake, pa administrim provash të reja në seancë gjyqësore, me përjashtim të dokumenteve që lidheshin me gjendjen personale dhe familjare të kërkuesit. Në përfundim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, ndër të tjera, e ka deklaruar kërkuesin të pafajshëm për veprën penale të parashikuar nga nenin 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së.

33. Kundër vendimit për pjesën që e deklaronte të pafajshëm kërkuesin, prokurori ka paraqitur apel, duke kërkuar përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave që lidheshin me veprën penale të deklarimit të rremë të pasurisë, të cilat ishin mbledhur gjatë hetimit paraprak. Ai ka paraqitur një listë të gjerë provash, përfshirë deklarata, dokumente të administruara nga Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), akte noteriale, procesverbale sekuestrimi dhe dokumente të gjetura gjatë kontrolleve. Mbrojtja e kërkuesit e ka kundërshtuar këtë kërkesë, duke kërkuar që gjykata të administronte disa prova të saj, të llojit “dokument”, që ndonëse ishin paraqitur në



seancën paraprake, ishin refuzuar nga gjykata e shkallës së parë.

34. GJKKO-ja e Apelit ka vendosur përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor vetëm mbi provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak, pra duke refuzuar aktet e paraqitura nga mbrojtësi. Ajo ka arsyetuar se përsëritja e pjesshme e shqyrtimit gjyqësor mbi provat e administruara gjatë hetimit paraprak, duke ruajtur përfitimet e gjykimit të shkurtuar, i garantonte kërkuarit një mbrojtje më të gjerë dhe mundësi reale kontradiktoriteti mbi aktet. GJKKO-ja e Apelit ka theksuar se në gjykimin e shkurtuar provat merren gjatë hetimit paraprak dhe se në gjykim mund të paraqiten vetëm dokumente që lidhen me gjendjen personale ose familjare të të pandehurit. Ky vlerësim është mbështetur edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka çmuar se GJKKO-ja e Apelit ka respektuar garancitë e procesit të rregullt ligjor dhe u ka dhënë palëve mundësinë të debatonin mbi provat e administruara.

35. Gjykata ka theksuar se gjykimi i shkurtuar është një formë e posaçme gjykimi, e cila vihet në lëvizje me kërkesë të të pandehurit, por pranohet nga gjykata vetëm kur çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet. Ky institut sjell përfitime si për të pandehurin, përmes uljes së dënimit me 1/3-at, ashtu edhe për interesin publik, duke siguruar një gjykim më të shpejtë dhe më ekonomik (*shih vendimet nr. 6, datë 26.2.2013; nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 10.1.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar gjithashtu se nëse gjykatat do të mund të rëndonin pozitën e të pandehurit përtej kërkesës së prokurorit edhe në gjykimin e shkurtuar, ky institut do të humbiste funksionin e tij kushtetues, pasi i pandehuri do të hiqte dorë nga disa garanci procedurale kushtetuese pa përfituar asnjë avantazh (*shih vendimin nr. 4, datë 10.2.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në analizë të sa më sipër, Gjykata vë në dukje se në gjykimin e shkurtuar çështja e fajësisë zgjidhet vetëm mbi bazën e provave të mbledhura gjatë hetimit paraprak, pasi vetë thelbi i këtij instituti qëndron në pranimin nga i pandehuri të gjendjes së akteve dhe heqjen dorë nga administrimi i provave në seancë gjyqësore. Në këmbim të këtij qëndrimi procedural, ligji i njeh të pandehurit përfitimin e uljes së dënimit me një të tretën. Për rrjedhojë, nëse pas pranimin të gjykimit të shkurtuar do të lejohej administrimi i gjerë i provave të reja ose rihapja e plotë e shqyrtimit gjyqësor, ky institut do të

humbiste funksionin e tij, pasi ai bazohet pikërisht në ekuilibrin midis përfitimit përmes uljes së dënimit dhe interesit publik për zhvillimin e një gjykimi më të shpejtë dhe me ekonomi gjyqësore. Nisur nga ky këndvështrim, Gjykata vëren se megjithëse kërkuari ishte shpallur i pafajshëm në gjykimin e shkurtuar në shkallë të parë, GJKKO-ja e Apelit vendosi të përsëriste pjesërisht shqyrtimin gjyqësor pas ankimit të prokurorit, i cili kërkonte deklarinë fajtor të tij. Gjatë këtij shqyrtimi u analizuan vetëm provat e mbledhura gjatë hetimit paraprak, kurse kërkuarit iu dha mundësia të paraqiste kundërshtimet dhe argumentet e tij, të cilat u debatuan gjatë gjykimit. Në këtë pikëpamje, shqyrtimi i provave të mbrojtjes, siç kanë arsyetuar gjykatat e zakonshme, nuk mund të pranohej për shkak të gjykimit të shkurtuar, pasi bëhej fjalë për akte që nuk ishin mbledhur gjatë hetimit paraprak. Po ashtu, nuk rezulton që gjykata e apelit të ketë ndryshuar cilësimin juridik të veprës penale ose të ketë caktuar një dënim më të rëndë nga ai i kërkuar nga prokurori. Përkundrazi, ajo ka respektuar përfitimet procedurale që burojnë nga gjykimi i shkurtuar. Në këtë situatë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuarit se gjykatat kanë paragjykuar fajësinë e tij për shkak të refuzimit të provave nuk qëndron.

37. Argumenti tjetër i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë ka të bëjë me vlerësimin e dyshimeve jo në favor të tij. Sipas kërkuarit, provat e administruara nuk ishin të mjaftueshme për të provuar fajësinë e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, por ngrinin vetëm dyshime, të cilat gjykata e apelit i ka interpretuar në favor të akuzës. Po ashtu, sipas kërkuarit, Gjykata e Lartë nuk e ka riparuar këtë cenim, pasi nuk ka pranuar për shqyrtim rekursin e tij.

38. Në analizë të këtyre argumenteve, Gjykata vëren se vlerësimi i provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i nënshtrohet kontrollit kushtetues vetëm kur cenohen parime, standarde ose të drejta kushtetuese (*shih vendimin nr. 63, datë 20.11.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuadër, Gjykata do të shqyrtojë nëse në procesin penal ndaj kërkuarit ka pasur zhvendosje të barrës së provës nga prokuroria tek ai dhe nëse fajësia është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

39. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Apelit e ka deklaruar kërkuarin fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, në formën e fshehjes dhe deklarimit të rremë të



pasurisë. Për këtë përfundim, ajo ka analizuar: i. dëshmitë e katër shtetasve (dhuruesit të pronës, projektuesit të ndërtimit dhe dy punonjësve të bashkisë); ii. aktet e procesit të rivlerësimit kalimtar; iii. dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja në kuadër të deklarimeve vjetore; iv. aktet noteriale; v. komunikimet telefonike; vi. dokumentet e regjistrimit të pasurive; vii. aktet e sekuestruara gjatë kontrollit të banesës së kërkuesit. Mbi bazën e këtyre provave, ajo gjykatë ka përcaktuar rrethanat e faktit penal.

40. Sipas GJKKO-së së Apelit, kërkuesi, në cilësinë e prokurorit, ka depozituar më 27.1.2017 deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar, ku ka deklaruar se një shtetas (dhuruesi) u kishte dhuruar dy fëmijëve të tij një sipërfaqe toke 1000 m² në Palermo, Himarë, në bashkëpronësi me pjesë të barabarta. Ai i ka qëndruar këtij deklarami përgjatë gjithë procesit të rivlerësimit kalimtar. I njëjti deklarami ishte bërë nga kërkuesi edhe në deklaratën periodike të vitit 2014. Mirëpo, në kundërshtim me këtë deklarami, në emër të dy fëmijëve të kërkuesit rezultojnë të regjistruara dy pasuri të veçanta, secila me sipërfaqe 1000 m² të përfituara mbi bazën e së njëjtës kontratë dhurimi të datës 17.10.2014. Nga dokumentacioni i administruar rezultonte se për secilën pasuri ishin kryer aplikime të ndryshme regjistrimi, të shoqëruara me dokumentacion të veçantë hipotekar dhe plane rievimi që identifikonin parcela të ndryshme.

41. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se regjistrimi i dy pasurive nuk mund të konsiderohej gabim material i zyrës së regjistrimit të pasurive, pasi secili aplikim ishte mbështetur në dokumentacion të ndryshëm, përfshirë vërtetime hipotekare dhe plane rievimi që individualizonin dy parcela të ndryshme. Për rrjedhojë, ajo ka arritur në përfundimin se ishte kërkuar dhe realizuar regjistrimi i dy pasurive të ndryshme, secila me sipërfaqe 1000 m². Gjithashtu, ajo gjykatë ka vlerësuar se gjatë procesit të rivlerësimit kërkuesi kishte paraqitur vetëm një pjesë të dokumentacionit të regjistrimit, duke fshehur dokumente të tjera që lidhnin kontratën e dhurimit me dy pasuri të ndryshme. Sipas saj, kërkuesi kishte dijeni të plotë për ekzistencën e të dyja pasurive, jo vetëm për shkak të dokumentacionit të regjistrimit, por edhe për shkak të veprimeve noteriale të kryera nga fëmijët e tij për administrimin dhe shitjen e tyre. Kjo dijeni konfirmohej edhe nga komunikimet telefonike me dhuruesin dhe nga dëshmia e këtij të

fundit, sipas së cilës kontaktet lidhur me pasuritë mbaheshin me kërkuesin dhe jo me fëmijët e tij.

42. Po kështu, GJKKO-ja e Apelit ka marrë në konsideratë edhe një sërë veprimesh noteriale të kryera nga kërkuesi dhe fëmijët e tij gjatë kohës së procesit të rivlerësimit, duke nxjerrë përfundimin se këto veprime tregonin se kërkuesi dhe fëmijët e tij silleshin si pronarë të të dyja pasurive. Konkretisht: i. më 23.11.2019 kërkuesi ka lëshuar një deklaratë noteriale, sipas së cilës ai vetë kishte aplikuar për regjistrimin e një kontrate tjetër dhurimi të datës 16.10.2014, të lidhur nga dhuruesi në favor të një shtetaseje tjetër, ndërsa fëmijët e tij kishin përfituar vetëm një pasuri prej 1000 m²; ii. më 25.11.2019 dy fëmijët e kërkuesit kanë deklaruar me akt noterial se atyre u ishte dhuruar dhe regjistruar vetëm një pasuri me sipërfaqe 1000 m²; iii. më 23.6.2020 ata (fëmijët) kanë lëshuar një prokurë të posaçme noteriale, me anë të së cilës autorizonin dhuruesin të shiste në emër dhe për llogari të tyre dy pasuri të paluajtshme, secila prej 1000 m², duke përcaktuar se çmimi i shitjes duhej të kalonte në llogaritë e tyre bankare. Prokurës i janë bashkëlidhur edhe vërtetimet hipotekare të të dyja pasurive nr. 52 dhe nr. 54, të lëshuara më 5.2.2015; iv. më 6.7.2020 fëmijët e kërkuesit kanë revokuar pjesërisht këtë prokurë, duke autorizuar shitjen vetëm të njëres pasuri dhe duke përjashtuar çdo veprim për pasurinë tjetër; v. më 26.2.2021 është lidhur kontrata e shitjes vetëm për pasurinë nr. 54, sipas së cilës dhuruesi, në cilësinë e përfaqësuesit të dy fëmijëve të kërkuesit, ia ka shitur atë një personi të tretë kundrejt çmimit 200.000 lekë. Kontratës i janë bashkëlidhur prokura e posaçme, revokimi i pjesshëm i saj dhe kopja e certifikatës së pronësisë për pasurinë nr. 54.

43. Gjithashtu, gjatë kontrollit të banesës së kërkuesit janë gjetur dokumente që lidhen me pronat e dhuruesit, përfshirë materiale për një projekt ndërtimi në emër të kërkuesit. Po kështu, nga komunikimet telefonike rezultojnë se kërkuesi interesohej vazhdimisht për problematikat e pronësisë së dhuruesit dhe komunikonte me të për administrimin e pasurive dhe aktet noteriale përkatëse.

44. GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar gjerësisht edhe përse nuk bëhej fjalë për gabim teknik të zyrës së regjistrimit të pasurive. Kështu, ajo ka rrëzuar pretendimin se shitja e njëres prej pasurive kishte synuar korrigjimin e një gabimi material në regjistrim. Ajo ka vlerësuar se dëshmia e dhuruesit



ishite kontradiktore dhe se dokumentacioni i shitjes nuk provonte kalimin real të çmimit të fëmijët e kërkuarit. Sipas saj, këto rrethana tregonin ushtrimin faktik të të drejtave të pronarit nga kërkuarja dhe fëmijët e tij. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se analiza e gjykatës së shkallës së parë, sipas së cilës kontrata e dhurimit përbënte titull vetëm për 1000 m², kishte natyrë civile dhe nuk përjashtonte përgjegjësinë penale. Sipas saj, legjislacioni për deklarimin dhe kontrollin e pasurive synon identifikimin edhe të pasurive që zotërohen *de facto* nga zyrtarët publikë.

45. Në analizë të fakteve të provuara, GJKKO-ja e Apelit ka arritur në dy përfundime. Së pari, kërkuarja ka fshehur pasuri, pasi ka deklaruar vetëm 1000 m², ndërkohë që në emër të fëmijëve të tij rezultonin të regjistruara 2000 m². Ajo ka vlerësuar se marrëdhëniet e ngushta të kërkuarit me dhuruesin, përfshirja e tij në administrimin e pronave, dokumentet e gjetura në banesën e tij dhe sjellja e mbajtur ndaj pasurive provonin se ato i përkisnin atij *de facto*. Së dyti, ajo gjykatë ka vlerësuar se dhuruesi ka marrëdhënie të drejtpërdrejta me kërkuarjen dhe jo me fëmijët e tij, ndërsa dhurimi ka ardhur si shenjë mirënjohjeje për ndihmën që kërkuarja i ka dhënë ndër vite lidhur me problematikat gjyqësore të pronësisë. Në këto rrethana, GJKKO-ja e Apelit ka arritur në përfundimin se dhurimi ishte formalizuar në emër të fëmijëve, por në thelb përfitues ishte vetë kërkuarja, i cili, duke e paraqitur ndryshe këtë situatë, kishte konsumuar elementet e veprës penale të deklarimit të rremë të pasurisë.

46. Arsyeimi i gjykatës së apelit është gjetur i drejtë nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuarit për këtë pjesë të vendimmarrjes. Ajo ka çmuar se GJKKO-ja e Apelit ka kryer një vlerësim të plotë dhe në përputhje me nenin 152 të KPP-së të provave të administruara, duke i analizuar ato në lidhje dhe unitet me njëra-tjetrën. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykata e apelit ka marrë në konsideratë, ndër të tjera, dokumentet e regjistrimit të kontratës së dhurimit, vërtetimet hipotekare, planet e rievimit, deklaratat për pranimin e dhurimit, si dhe qëndrimin e mbajtur nga kërkuarja gjatë procesit të deklarimit dhe rivlerësimit kalimtar. Sipas saj, pretendimet e ngritura në rekurs kishin natyrë faktike dhe synonin një rivlerësim të provave, çështje që ishte shqyrtuar gjerësisht nga GJKKO-ja e Apelit, e cila kishte argumentuar se

akuza ndaj kërkuarit për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, ishte provuar dhe se pretendimet e mbrojtjes për pafajësi nuk qëndronin.

47. Në vlerësim të sa më sipër, Gjykata çmon se GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në vlerësimin e provave. Gjykata e apelit e ka mbështetur përfundimin e saj mbi një analizë tërësore të provave të administruara, të lidhura logjikisht me njëra-tjetrën. Arsyeimi i saj nuk është bazuar në prezumime të përgjithshme ose në zhvendosjen e barrës së provës tek kërkuarja, por në një tërësi elementesh faktike dhe provash, të cilat, sipas saj, provonin dijeninë, kontrollin dhe përfitimin faktik të kërkuarit mbi pasuritë në fjalë. Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se vendimmarrja e gjykatës së apelit mbështetej në një vlerësim të plotë dhe të argumentuar të provave, pa pasur mangësi që cenonin ligjshmërinë e asaj vendimmarrjeje. Po kështu, nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë zhvendosur barrën e provës tek kërkuarja, përkundrazi, ato kanë dhënë argumente të mjaftueshme në drejtim të përmbushjes të standardit të të provuarit të fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës së mosdënimit pa ligj

48. Kërkuarja ka parashtruar se fakti penal që i atribuohet nuk parashikohet si vepër penale në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, as në Ligjin për Rivlerësimin Kalimtar dhe as në deklaratën “*Vetting*”. Sipas tij, dispozitat kushtetuese dhe ligjore parashikojnë vetëm sanksione administrative, kurse Ligji për Deklarimin e Pasurisë nuk është miratuar me shumicë të cilësuar, si i tillë nuk është pjesë e KP-së dhe, po kështu, formularët e plotësuar për efekt të procesit të deklarimit nuk përbëjnë ligj, sipas kritereve që përcakton fryma dhe përmbajtja e Kushtetutës. Për më tepër, kërkuarja është deklaruar fajtor dhe është dënuar për veprime që janë deklaruar rregullisht në datën 16.3.2015, përtej afatit ligjor të parashkrimit.

49. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, nuk ka paraqitur ndonjë prapësim lidhur me këtë pretendim, pasi ka mbajtur qëndrimin se kërkuarja nuk ka ezauruar të gjitha mjetet juridike në



dispozicion, në kushtet kur çështja është rigjykuar nga GJKKO-ja e Apelit (*shih paragrafin 7 të vendimit*).

50. Neni 29 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të akuzohet ose të deklarohet fajtor për një veprë penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj (*pika 1*). Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo e drejtë është element thelbësor i shtetit të së drejtës dhe duhet të interpretohet dhe zbatohet në mënyrë që të ofrojë siguri efektive kundër ndjekjes, deklarimit fajtor dhe dënimit arbitrar. Çdo veprë penale duhet të parashikohet me ligj dhe individit duhet të jetë objektivisht në gjendje, nëse është e nevojshme edhe me ndihmën e interpretimeve gjyqësore, të kuptojë përmbajtjen e normës penale, pra se çfarë veprimesh ose mosveprimesh do ta bëjnë atë përgjegjës penalisht (*shih vendimet nr. 55, datë 10.10.2025; nr. 4, datë 31.1.2024; nr. 16, datë 15.6.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, duke pranuar rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, ka pohuar se, si rregull, është e pamundur që normat të hartohen në mënyrë të tillë që të parashikojnë çdo rast praktik të së ardhmes, ndaj mbetet detyrë kryesore e organeve ligjzbatuese, ku përfshihen edhe gjykatat, që kuptimin e ligjit ta plotësojnë natyrshëm gjatë zbatimit praktik të tij, duke përdorur metoda të qëndrueshme interpretimi (*shih vendimet nr. 32, datë 30.5.2023; nr. 34, datë 20.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Gjykata vëren se kërkuesi është akuzuar dhe dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, i cili parashikon, ndër të tjera, se fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të çdo personi që ka detyrimin ligjor për deklarim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kjo dispozitë penale ka përcaktuar konceptin e fshehjes ose/dhe deklarimit të rremë nga çdo funksionar publik që ka detyrimin ligjor të deklarojë pasurinë dhe interesat privatë. Kërkuesi ka ushtruar funksionin e prokurorit dhe i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, duke pasur në këtë mënyrë dy detyrime deklarimi. Detyrimi i parë buron nga Ligji për Deklarimin e Pasurisë, i cili ka parashikuar se prokurorët e të gjitha niveleve mbartin detyrimin për deklarimin periodik (*neni 3, pika 1, shërkronja "dh"*). Po sipas nenit 38 të këtij ligj, deklaratat dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë ato janë dokumente zyrtare dhe paraqitja në to e të dhënave të rreme përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi. Detyrimi i dytë

bazohej në rregullat e Aneksit të Kushtetutës dhe Ligjit për Rivlerësimin Kalimtar. Në deklaratën "Vetting" që bashkëshoqëron Ligjin për Rivlerësimin Kalimtar dhe që është pjesë përbërëse e tij është shënuar se ky formular përbën dokument zyrtar dhe pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota e të pasakta e bën deklaratën të rreme dhe ndëshkohet penalisht. Nga përmbajtja e këtij kuadri ligjor, Gjykata nuk konstaton mungesë ligji ose paqartësi të tij lidhur me faktin se nëse prokurori fsheh ose deklaron në mënyrë të rreme pasuritë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, atëherë ai u nënshtrohet sanksioneve penale të parashikuara nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së.

52. Po ashtu, Gjykata vëren se GJKKO-ja e Apelit ka argumentuar se ndjekja penale lidhet me deklaratën e pasurisë të dorëzuar nga kërkuesi në procesin e rivlerësimit kalimtar më 27.1.2017, ndaj afatet e parashkrimit nuk ishin tejkaluar. Sipas saj, neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së është dispozitë *blankete*, kuptimi i së cilës plotësohet nga Ligji për Rivlerësimin Kalimtar dhe Ligji për Deklarimin e Pasurisë. Në këtë kuptim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë gjatë procesit të rivlerësimit përfshihet në elementet e kësaj figure penale. Ajo kërkon dashje të drejtpërdrejtë dhe qëllim për fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurisë. Gjykata e Lartë e ka çmuar të drejtë dhe të bazuar këtë pjesë të arsytimit të vendimmarrjes së gjykatës së apelit, duke vënë në dukje se nëpërmjet parashikimit të kësaj veprë penale synohet të mbrohen marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar saktësinë e deklarimit të pasurisë të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet dhe mosveprimet e kundërligjshme. Deklarimi i rremë sipas vetë Ligjit për Deklarimin e Pasurive, përmes paraqitjes të të dhënave të rreme, përbën veprë penale dhe dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

53. Në vlerësim të sa më sipër, Gjykata vë në dukje se interpretimi i nenit 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së nga gjykatat e zakonshme nuk përmban gabime të dukshme ligjore që do ta bënin gjykimin të padrejtë. Ato i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit të kërkuesit për të drejtën për të mos u dënuar pa ligj. Gjithashtu, Gjykata evidenton se interpretimi i nenit 257/a të KP-së nga gjykatat është mbështetur në metoda të njohura dhe të qëndrueshme interpretimi, duke qëndruar brenda



kuptimit të arsyeshëm të ligjit dhe pa cenuar sigurinë juridike ose garancinë kushtetuese të parashikuar nga neni 29 i Kushtetutës. Në këtë kuptim, parimi i mosdënimit pa ligj nuk kërkon që norma penale të parashikojë në mënyrë shteruese çdo situatë konkrete që mund të paraqitet në praktikë, por që ajo të jetë mjaftueshmërisht e qartë dhe e parashikueshme për individin. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kuadri ligjor që rregullon deklarin e pasurisë është i qartë në lidhje me përgjegjësinë penale të subjekteve që kanë detyrimin ligjor për deklarin, ndaj pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës për të mos u dënuar pa ligj është i pazuar.

54. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit janë të pazuara, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 2.4.2026.

Shpallur më 26.5.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Marsida Xhaferllari

Anëtar kundër: Asim Vokshi

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen që i përket kërkesës së kërkuarit Sali Hasa, me objekt shfuqizimi pjesërisht i vendimeve nr. 18, datë 23.3.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe pjesërisht i vendimit nr. 00-2024-1823 (281), datë 14.11.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit kundër

vendimit të gjykatës së apelit për dënimin për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka realizuar funksionin e vet kushtetues e ligjor të zhvillimit të praktikës gjyqësore në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së vendimmarrjes së Gjykatës së Posaçme të Apelit, për sa i përket respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë në lidhje me provueshmërinë e përgjegjësisë penale tej çdo dyshimi të arsyeshëm (*parimi in dubio pro reo*). Për këtë shkak, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej të prishte vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe të linte në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë në lidhje me këtë pjesë (*pjesa tjetër e prishur dhe kthyer për rigjykim nuk është pjesë e analizës vijuese, pasi nuk ka qenë as pjesë e ankimit kushtetues individual*). Kjo, pasi arsytimi në lidhje me rrethanat e çështjes nga Gjykata e Posaçme e Apelit në ndryshim nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe, për rrjedhojë, përfundimi i arritur prej saj për ekzistencën e dashjes dhe përgjegjësisë penale të kërkuarit për kryerjen e veprës penale sipas nenit 257/a, paragrafi i dytë, të KP-së, është në shkelje të standardit kushtetues të mishëruar në nenin 30 të Kushtetutës dhe përbën një gabim themelor që nuk do të duhej të kryhej nga një gjykatë e kujdesshme.

3. Kur Kushtetuta parashikon në nenin 42, pika 2, të saj se “[...] kushdo, [...] në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një *gjykimi të drejtë* [...]”, ajo ngre në nivel kushtetues vlerësimin e drejtësisë së vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme, e cila mund të merret në shqyrtim nga Gjykata Kushtetuese në respekt të nenit 131, shkronja “F” të Kushtetutës. Vlerësimi i drejtësisë së vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme nuk e kthen Gjykatën Kushtetuese në shkallë të katërt, por përforcon rolin e kësaj gjykate për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve kushtetuese dhe bërjen e interpretimit përfundimtar të Kushtetutës, sipas përcaktimeve të nenit 124, pika 1, të saj. Gjykata Kushtetuese nuk sheh saktësinë e zgjidhjes së dhënë nga gjykatat e zakonshme, pasi edhe një vendim i dhënë për një rast të zgjidhur jo saktë, mund të jetë imun ndaj shqyrtimit kushtetues, pasi nuk hyn në



kategorinë e vendimeve që përbëjnë gjykim të padrejtë në aspektin kushtetues. Vendime që e bëjnë të padrejtë gjykimin në tërësinë e tij, janë ato të cilave u mungon boshti ose skeleti kushtetues, domethënë ato vendime që janë të pazonja të rrinë drejt, nëse shihen me syrin e një vëzhguesi mesatar të jashtëm, me njohuri, eksperiencë dhe aftësi mesatare juridike dhe njerëzore. Vendim i padrejtë është ai që paraqitet në thelb antikushtetues, që dështon të garantojë të drejtat themelore të kujtdo të cilit i drejtohet dhe që për këtë shkak nuk bind as vëzhguesin mesatar se një gjykatë e kujdesshme do ta merrte vendimin objekt të ankimit kushtetues. Gjykata Kushtetuese nuk “zëvendëson” vështtrimin dhe mendimin e specializuar të gjyqtarit profesionist të gjykatave të zakonshme, i cili njeh dhe zbaton ligjin në raste konkrete, por e shkëputur nga ky specializim (për shkak të përbërjes specifike që ka Gjykata Kushtetuese), dallon drejtësinë e vendimmarrjes (e cila duhet të jetë gjithnjë e pranishme) me shikimin e një vëzhguesi të tretë të paanshëm, për të evidentuar nëse vendimmarrja është e tillë që mund të rrijë në këmbët e veta dhe të përbëjë një standard kushtetues gjykimi për raste të ngjashme, duke qenë e drejtë, pavarësisht pasaktësive që mund të ketë. Nëse shihet me këndvështrimin e mësipërm rasti objekt gjykimi, atëherë mendoj se rezultati duhej të ishte ndryshe.

4. Për sa u përket aspekteve faktike të ankimit kushtetues individual të kërkuarit Sali Hasa, duhet theksuar se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 36, datë 31.5.2022, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin të pafajshëm të kërkuarit për veprën penale të fshehjes së pasurisë, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, me arsyetimin se nuk provohet fakti penal në formën e fshehjes dhe deklarimit të rremë, për shkak se akti i fitimit të pronës përcakton qartë sipërfaqen e dhuruar dhe ajo është deklaruar rregullisht. Veprimet e mëpasshme në çdo rast nuk mund të zhbënin një vullnet që rezultonte i qartë nga kontrata e dhurimit, e cila ishte bërë për shkak të njohjeve familjare dhe kërkuari nuk gjendej në ndonjë rast konflikti interesi me dhuruesin. Ndërsa, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me vendimin nr. 18, datë 23.3.2023, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke e deklaruar fajtor kërkuarin për të dyja veprat penale që akuzohej dhe e ka

dënuar atë përfundimisht me 2 vjet e 4 muaj burgim. Sipas gjykatës së apelit, është provuar përtej çdo dyshimi se kërkuari ka kryer deklarim të rremë e ka fshehur pasurinë, pasi ka deklaruar vetëm një pjesë të pasurisë të regjistruar (1000 m² nga 2000 m²) dhe se ndonëse kontrata e dhurimit është “e përmbyllur” *de jure* në emër të fëmijëve të tij, *de facto* është vetë kërkuari përfituesi i pronës së dhuruar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit kundër vendimit të gjykatës së apelit për pjesën që kishte vendosur fajësinë e kërkuarit për veprën penale të fshehjes së pasurisë të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi i dytë, i KP-së, me arsyetimin se përfundimet e gjykatës së apelit janë rezultat i çmuarjes dhe vlerësimit të provave në konformitet me nenet 152 dhe 383 të KPP-së, përkundërt të cilave kërkuari në rekurs nuk ka evidentuar ndonjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë dhënë përgjigje të argumentuara, që rrëzojnë çdo dyshim të arsyeshëm, në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit të deklarimit fajtor mbi bazën e provave bindëse, sipas nenit 152 të KPP-së. Gjykata e Posaçme e Apelit nuk ka analizuar mjaftueshëm në planin e standardeve kushtetuese motivet që duhet të dalin qartë nga rrethanat objektive, tek të cilat të shfaqej dashja e kërkuarit për të gënjer në deklaratën “*Vetting*”, me qëllim që të fshihte 1000 m² tokë të regjistruar në regjistrat publikë në emër të fëmijëve të vet, kur kishte deklaruar 1000 m² “të tjera”. Gjykata duhej të analizonte bindshëm të paktën në dy drejtime: 1) a mund të “fshihet” një fakt që lidhet me kërkuarin ose familjarët e tij dhe që pasqyrohet në regjistra publikë, domethënë që është lehtësisht i dokumentueshëm në çdo kohë nga çdo subjekt me tagra verifikues dhe 2) si arrin gjykata në përfundimin se prona e dhuruar në fakt është e kërkuarit dhe jo e fëmijëve të tij? Vlerësoj se veçanërisht, në rastin kur vullneti i palëve është i mishëruar në një kontratë publike të shkruar dhe të hartuar para noterit, gjykata ka barrën e të argumentuarit bindshëm pse faktet nuk janë ato që pasqyrohen në kontratë, por përfshihen në hipotezën tjetër të fakteve penale të dënueshme. Faktet që pasqyrohen në kontratë, kur lind një hetim penal, minimalisht përbëjnë dyshim të arsyeshëm se ngjarjet janë ashtu siç thotë kontrata dhe nuk mund të hidhen poshtë thjesht me “ndjesi” të gjykatës ose



me indicie, të cilat, në kuptim të nenit 152, pika 2, të KPP-së, nuk argumentohen bindshëm se janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Në të kundërt cenohet standardi *in dubio pro reo* i parashikuar në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit “kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.” Në funksion edhe të këtij parimi është detyrimi kushtetues që rëndon mbi gjykatat, sipas nenit 142, pika 1, të Kushtetutës, që vendimet duhet t’i japin të arsyetuara dhe i lidhur ngushtë me këtë është edhe detyrimi që rrjedh nga neni 8/a i KPP-së që gjykatat të shqyrtojnë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij. Në këtë këndvështrim, që në pamje të parë vendimi i deklarimit fajtor dhe dënimit të kërkuesit nga gjykatat e zakonshme duket se nuk ka respektuar parimin kushtetues *in dubio pro reo*, dhe Gjykata e Lartë, ndonëse nuk është gjykatë fakti, duhej ta kishte konstatuar këtë element ligjor e kushtetues dhe të vendoste respektivisht.

6. Përfundimet e Gjykatës së Posaçme të Apelit nuk rrëzojnë bindshëm shpjegimin e kërkuesit se kur ai ka shkuar pranë ZVRPP-së për të regjistruar kontratën e dhurimit i është kërkuar nga sportelisti që të bëjë dy aplikime për secilin nga fëmijët e tij dhe ai ka depozituar të njëjtën kontratë (veçse me fraksion të ndryshëm në varësi të kopjes që secili nga përfituesit e dhurimit kishte), e cila është regjistruar dy herë gabimisht prej organit administrativ. Duhet theksuar se kontrata noteriale e dhurimit ka kaluar në pronësi të fëmijëve të kërkuesit vetëm 1000 m² dhe që ky dhurim të kompletohej ligjërisht duhej që përfituesit të bënin edhe deklaratën e pranimi të dhurimit. Me deklaratën noteriale nr. 4239 rep., nr. 10382 kol., datë 18.10.2014 për pranim dhurimi, siç pranohet në paragrafin 106 të vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, është bërë pranimi i vetëm 1000 m² sipërfaqe toke dhe jo i 2000 m².

7. Kërkuesi si në deklaratën periodike vjetore të depozituar në vitin 2015, ashtu edhe në deklaratën “*Vetting*” të vitit 2017 ka deklaruar vetëm pasurinë e paluajtshme prej 1000 m², që ligjërisht dhe me kontratë publike u ishte kaluar në pronësi me dhurim fëmijëve të tij nga shtetasi V.R. (*pavarësisht defektit në individualizimin konkret të kësaj sipërfaqe brenda sipërfaqes totale prej 38000 m² që dhuruesi kishte në pronësi*). Fakti që bazuar në një kontratë me të cilën dhurohen vetëm 1000 m² tokë dhe njëkohësisht në deklaratën e pranimi të dhurimit me të cilën pranohen po

vetëm këto 1000 m² tokë, në ZVRPP-në përkatëse janë regjistruar dy pasuri me nga 1000 m² tokë (pra 2000 m²) në vendndodhje të ndryshme (*për shkak të planimetrive të ndryshme që i janë bashkëlidhur aplikimeve në ZVRPP*), nuk do të thotë se nuk qëndron shpjegimi i kërkuesit se ky është një gabim që ka ndodhur në ZVRPP dhe nuk ka lidhje me ndonjë dashje të tij për të fshehur ndonjë pasuri të fëmijëve të tij. Minimalisht mund të thuhet se si dyshimi se kërkuesi ka fshehur pasurinë, ashtu edhe ai se bëhet fjalë për një gabim administrativ në regjistrim, janë njësoj të vlefshme (çka bie ndesh me standardin kushtetues të provueshmërisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm). Nuk ka logjikë fshehja e një pasurie duke e regjistruar atë në regjistra publikë pa pasur titull, në emër të fëmijëve të tu, për të cilët njëkohësisht deklaron pasurinë. Në vijim, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar në mënyrë të detajuar çështjen, i referohem arsyetimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, e cila shprehet në fund të paragrafit të dytë të faqes 120 të vendimit të saj se “*referuar praktikës së plotë të kontratës së dhurimit të administruar pranë noteres L.T., plani i rilevimit i përmendur në kontratën e dhurimit identifikon pasurinë nr. 1/21, pra asnjërin prej dy pasurive për regjistrimin e të cilave ishte aplikuar me dy kërkesa, pasuri të cilat janë ato nr. 1/17 dhe 1/18*”. Bazuar mbi këtë konstatim fakti, Gjykata e Posaçme e Apelit ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka dëshiruar regjistrimin e dy pasurive me nga 1000 m² (gjithsej 2000 m²) dhe jo të një pasurie me 1000 m².

8. Arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Posaçme të Apelit, që gjen dashje dhe fajësi tek kërkuesi (*shih paragrafin 127.1. të vendimit*), është kontradiktor, pasi nuk mban parasysh se gabimet në këtë rast janë bërë jo vetëm nga ZVRPP-ja, por edhe nga noterja që tjetër plan rilevimi mban në arkivin e saj e të tjera plane rilevimi u bashkëlidhë dy kopjeve të së njëjtës kontratë dhurimi, të përdorur për regjistrim në ZVRPP. Praktikisht i bie që fëmijët e kërkuesit nuk janë bërë pronarë të asnjërës nga pronat e regjistruara, pasi një planimetri e tretë qenka te praktika noteriale e noteres L.T. Vendimi i gjykatës bazohet në një arsyetim induktiv në vend që të ndjekë një arsyetim deduktiv (të bazuar mbi fakte të sigurta dhe bindëse), pasi niset nga pasoja (regjistrimi i gabuar) për të gjetur shkakun dhe përgjegjësinë penale me faj në formën e dashjes dhe e gjen atë te veprimet me keqdashje të kërkuesit, për të cilat nuk përjashtohet me siguri se janë fryt i



gabimit njerëzor. Gjykatat e zakonshme duhet të mbanin parasysh se është ligjësi njerëzore që gabimet në ndërveprimin e përditshëm ndodhin edhe nëse nganjëherë përpiqesh maksimalisht t'i shmangësh. Dhe gabimet ose pasaktësitë pikërisht pse ndodhin dhe mund të krijojnë perceptime të gabuara, ndaj edhe korrigjohen administrativisht dhe në forma të tjera që parashikon ligji. Arsyetimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit që nisët nga fakti i qenies së dy pasurive nga 1000 m² secila të regjistruara në regjistra publikë në emër të fëmijëve të kërkuarit dhe bazuar mbi këtë fakt synon të gjejë faj penal për “fshehje” pasurie nga kërkuari, referuar deklarimit të tij në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, është dukshëm i pabazuar dhe do të duhej të ishte konstatuar nga Gjykata e Lartë si cenim i arsyetimit nga Gjykata e Posaçme e Apelit në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, provueshmërisë së fajit tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe faktit se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit.

9. Nuk pajtohem me logjikën se nëse i pandehuri dyshohet ose duket *prima facie* se është i fajshëm (ndoshta edhe për faktin se në të njëjtin proces penal ndaj tij rëndonte edhe një akuzë tjetër për korupsion, për fakte të palidhura me deklarin në deklaratën “Vetting”, si dhe se ai ishte shkarkuar nga organi administrativ KPK), ai është edhe realisht i tillë për sa akuzohet, pasi në këtë rast gjykata ka barrën të zhvleftësorë me argumente bindëse dhe prova çdo dyshim të arsyeshëm i cili shkon në favor të të pandehurit dhe për të cilin ky i fundit ka dhënë plotësisht dhe pa rezerva shpjegimet e veta. Në rastin konkret duket qartë se rezultati i regjistrimit të dy sipërfaqeve nga 1000 m² është rrjedhojë e pasaktësive në dokumentacion dhe gabimeve të bëra nga disa aktorë (noterja, punonjësi i ZVRPP, etj.), e jo qartazi pjesë e një qëllimi kriminal për të fshehur kërkuari pasurinë nëpërmjet regjistrimit të saj në emër të fëmijëve të vet në regjistra publikë. Ky konkluzion është jo vetëm i palogjikshëm, por edhe ekstrem, në dritën e rrethanave të këtij rasti, sa e bën gjykimin jo vetëm të padrejtë, por në kundërshtim me standardet kushtetuese të mishëruara në nenin 30 të Kushtetutës dhe nenet 8/a e 152 të KPP-së.

10. Që ndodhemi në kushtet e një gabimi dhe konfuzioni, të cilin Gjykata e Posaçme e Apelit gabimisht e sheh në dritën e përgjegjësisë penale me dashje, por të paargumentuar se është tej çdo dyshimi të arsyeshëm, rrjedh edhe nga konkluzioni i arritur prej asaj gjykate në paragrafin 128.1. të

vendimit, ku evidenton se gjatë procesit të *vetting*-ut kërkuari ka depozituar një plan-vendosje nr. 1/25, e cila është e ndryshme nga ato nr. 1/17 dhe nr.1/18 bashkëlidhur aplikimeve për regjistrim në ZVRPP dhe asaj nr.1/21 bashkëlidhur praktikës që ndodhej te noterja. Ky konfuzion objektiv duket se ka ardhur nga fakti se kontrata e dhurimit dhe deklarata e pranimit të dhurimit shprehen për 1000 m², por pa qenë ato të ndara nga pasuria mëmë prej 38000 m² në pronësi të dhuruesit. Fakti që dalin 4 vendndodhje të ndryshme zbeh fajësinë në formën e dashjes të kërkuarit Sali Hasa. Ky fakt ngre dyshimin e arsyeshëm se ngatërresa ka ardhur për shkak të shumë faktorëve që janë bashkuar, si gjendja e dokumentacionit që kishte dhuruesi i tokës, aftësia e noteres për të saktësuar objektin e dhurimit, plan-rilevimet e ndryshme të bëra nga eksperti privat dhe roli mungues kontrollues i ZVRPP-së, e cila duhej të kontrollonte dokumentacionin dhe të regjistronte në emër të fëmijëve të kërkuarit vetëm 1000 m², aq sa kishin përfutur në dhurim dhe pranuar me vullnet në pronësi. Por në mungesë të një arsyeje ose motivi pse kërkuari kishte interes të deklaronte 1000 m² dhe të fshihte faktin se sipërfaqja ishte 2000 m² (nëse do të kishin përfutur fëmijët e vet aq tokë), nuk ka kuptim të arsyeshëm akuza për fshehje pasurie. Nëse kërkuari do e kishte fituar vetë pronën me dhurim dhe nuk do të rezultonte ndonjë paligjshmëri në këtë veprim juridik, siç edhe nuk është provuar të ketë pasur ndonjë konflikt interesi ose veprim korruptiv, atëherë nuk mund të thuhet se ai ka fshehur pronën. Në këtë kuptim s'del llogaria intelektuale që prona është e vetja (*de facto*), por e kamufluar (*de jure*) në emër të fëmijëve të tij. Dhuruesi ka dhënë shpjegime bindëse pse ka bërë dhurimin dhe në mungesë të provave të kundërta, gjykata penale nuk mund të gjejë fajësi aty ku nuk ka. Siç rezulton nga paragrafi 128.2. i vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, kërkuari ka dhënë një shpjegim të arsyeshëm të situatës së krijuar, por pa argumente ligjore gjykata në paragrafin 128.4. përdor si justifikim të vendimmarrjes së vet faktin e dy regjistrimeve, për të arritur në përfundimin se kërkuari është fajtor për kryerjen me dashje të veprës penale (paragrafi i dytë), pa argumentuar motivet dhe sesi mund të fshihet një pronë e regjistruar në emrin e fëmijëve të tij në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme.

11. Dukshëm i pabazë paraqitet edhe arsyetimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit që gjen fajësi tek



veprimet e kërkuarit Sali Hasa në lidhje me faktin pse ai nuk ka deklaruar në *vetting* se kishte edhe një planimetri tjetër bashkëlidhur vërtetimit nr. 23, datë 16.1.2015. Ndërkohë që shpjegimit logjik se nuk kishte si ta deklaronte pasi fëmijët e tij nuk kishin marrë në pronësi ose posedim një send të tillë, nuk i jepet përgjigje, por në paragrafin 129 të vendimit të vet, gjykata mjaftohet me faktin e pranuar nga kërkuari se ai ka regjistruar pasuritë në ZVRPP. Gjykata përdor si argument se publikimi i së drejtës reale në regjistrat publikë të regjistrimit të pasurive të paluajtshme u mundësonte fëmijëve të kërkuarit gëzimin e plotë të sendit kundrejt të tretëve, duke u bazuar kështu në një argument arbitrar, i cili lidhet me një situatë hipotetike, që për më tepër nuk është materializuar deri në momentin që kërkuari mori dijeni gjatë procesit *vetting* për këtë pasaktësi. Fëmijët e kërkuarit nuk mund të gëzonin një pasuri që nuk e kishin në pronësi ose posedim, pasi regjistrimi në ZVRPP nuk të bën pronar dhe për më tepër regjistrimi i paligjshëm i bërë nga ZVRPP-ja mund dhe duhej t'u zhbëhej atyre me fshirje administrativisht, në mungesë të dukshme të titullit të pronësisë.

12. Vlerësoj se është haptazi e pabazuar që të vlerësohet fajësia e kërkuarit në vitin 2015 ose vitin 2017 (deklarimet *vetting*) bazuar mbi veprimet e vitit 2020 të fëmijëve të tij, të cilët pasi kanë ardhur në dijeni të regjistrimit të parregullt dy herë të së njëjtës kontratë dhurimi janë përpjekur ta zgjidhin atë nëpërmjet lëshimit të një prokure ndaj dhuruesit (me gjasë sipas këshillës juridike të marrë nga ndokush që nuk e njihnte mirë ligjin civil e administrativ). Dijenia e kërkuarit për këtë prokurë dhe komunikimi i tij me përfaqësuesin nuk mund të interpretohen si fajësi për “fshehje” pasurie, por si interesim i babait për zgjidhjen e një problematike në regjistrimin e pronës së fëmijëve të tij, që po i nxirrte probleme në *vetting*. Këtu nuk ka asgjë penale, përveç nëse injorohen dyshimet e arsyeshme, të cilat rrëzojnë standardin provues penal të provueshmërisë së veprës penale dhe fajësisë tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Më tej, e pakuptimtë paraqitet edhe analiza që i bën Gjykata e Posaçme e Apelit deklarimeve të dëshmitarit V.R. në faqen 128 të vendimit, se “[...] nëse ke vetëdijen që po shet pronën tënde, por që gabimisht është regjistruar në emër të personave të tjerë, atëherë qartazi rezulton se dëshmitari V.R., duke u shprehur se edhe mund ta kishte shitur (fillimisht e mohoi kategorikisht çdo veprim shite mbi këtë pronë), duke mos i kujtuar asgjë

edhe emri i blerësit (ndërkohë që para finalizimit të kontratës së shitblerjes palët i shoqëron një fazë më e hershme e bisedimeve shites-blerës), tregon se sjellja e tij karshi pronës së regjistruar në emër të fëmijëve të të pandehurit Sali Hasa, shitur po në emër të tyre [...], nuk është sjellja e një pronari, në vetëdijen e të cilit ai (në këtë rast dëshmitari) duhej të mbetej i tillë, pavarësisht se cilët figurojnë pronarë në hipotekë”. Nuk është e qartë se mbi çfarë standardi bazohet Gjykata e Posaçme e Apelit në analizën e mësipërme me karakter psikologjik dhe si ndikon ajo në fshehjen e pasurisë nga kërkuari Sali Hasa, kur në fakt është provuar lidhja miqësore midis kërkuarit dhe dëshmitarit V.R., çka duhet të nxirrte në pah se komunikimet dhe përpjekjet e tyre për ndreqjen e gabimit në regjistrim, ndonëse joperfekte nga pikëpamja e së drejtës civile ose asaj administrative, gjithsesi kanë synuar rregullimin e situatës, meqë u zbulua pasaktësia e regjistrimit gjatë procesit *vetting* të kërkuarit. Padija nuk përbën faj penal, sepse nuk mund të barazohet automatikisht me dashje, në kuadër të veprës penale për të cilën është dënuar kërkuari.

13. Gjykata e Posaçme e Apelit duket se nuk ka ofruar si duhet garancitë e një gjykimi të drejtë, kur i është referuar në paragrafin 131 të vendimit të saj (si dhe në disa paragrafë të tjerë) vendimmarjes nr. 433, datë 3.9.2021 të organit *sui generis* me karakter administrativ, KPK-së (për shkarkimin nga detyra të kërkuarit), të marrë në një procedurë po *sui generis* e të jashtëzakonshme, funksioni i së cilës lidhej vetëm me qëndrimin ose jo administrativisht të kërkuarit në detyrën e prokurorit. Në vitin 2014, kur është lidhur kontrata e dhurimit, nuk dihej versioni përfundimtar i ligjit të *vetting*-ut e madje as nëse do të miratohej ose jo ndonjë i tillë, ndaj argumenti i gjykatës në lidhje me dyshimet që duhet të ketë pasur në mendje kërkuari që mund të lindnin nëse dhuroheshin 2000 m² në vend të 1000 m², e që mund të sillte, ndër të tjera, edhe humbjen e besimit të publikut, duken haptazi të paqena. Si 1000 m², ashtu edhe 2000 m² në mënyrë të arsyeshme mund të thuhet se ngjallin njësoj dyshim, nëse i dhurohen fëmijëve të një funksionari shtetëror, nga persona të tretë, jo familjarë. Për sa kohë që nuk është provuar se ky dhurim ishte në kushte konflikti interesi ose pasojë e veprimeve korruptive, konkluzioni i Gjykatës së Posaçme të Apelit është jo vetëm i pavend, por edhe i padrejtë në atë masë që duhej të ishte korrigjuar nga Gjykata e Lartë. Në këtë vazhde edhe vlerësimi formal i Gjykatës së Posaçme të



Apelit se kërkuesi duhej të kishte deklaruar pasurinë e dytë që figuronte në emër të fëmijëve të vet, kishte ose nuk kishte kaluar në pronësi të tyre me kontratë, por mjafton që figuronte e regjistruar në ZVRPP, nuk thotë asgjë për dashjen e tij në kryerjen e veprës penale (nëpërmjet “fshehjes”) për të cilën u dënua. Pa dashje nuk ka vepër penale, por maksimalisht ndonjë masë administrative për pakujdesinë e treguar në plotësimin e deklaratës përkatëse.

14. Në lidhje me fajësinë e kërkuesit paraqitet e pabazuar edhe analiza e Gjykatës së Posaçme të Apelit se meqë kërkuesi Salë Hasa është interesuar ndër vite për pronat e V.R. (dhe i janë gjetur në shtëpi dokumente të pronave të këtij personi) dhe se ky i fundit nuk mbante mend, kur është pyetur, emrat dhe datëlindjet e fëmijëve të kërkuesit, në fakt, për këto shkaqe, dhurimi nuk u është bërë fëmijëve, por vetë kërkuesit. Sipas kësaj gjykate, nëse do të ishte vetë kërkuesi përfitues i dhurimit, edhe pse jo në kushtet e ndonjë konflikti interesi, ai do të ngjallte dyshim, ndaj ka zgjedhur të vendosë pronat në emër të fëmijëve të tij, në vend që t'i merrte në emrin e tij. Ky përfundim, përveçse subjektiv dhe i pambështetur në prova, madje në kundërshtim me faktet e provuara me dëshminë e dëshmitarëve, gjen fajësi aty ku ndonjëse mund të ketë dyshime se e vërteta është ashtu siç argumenton Gjykata e Posaçme e Apelit, gjithsesi dështohet të argumentohet provueshmëria e fajit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kjo pasi faktet e çështjes sipas analizës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, jo vetëm paraqiten bindëse (sipas asaj analize), por mbi të gjitha minimalisht ekspozojnë dyshime të arsyeshme që rrëzojnë çështjen penale në ngarkim të kërkuesit.

15. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhej të kishte konstatuar vetë sa më sipër dhe të prishte vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit, si vendim i pabazuar në një vlerësim të balancuar të fakteve që të nxirrnin në pah fajësi penale tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në dukje vendimmarrja e Gjykatës së Posaçme të Apelit, për të cilën nuk është pranuar rekursi i kërkuesit nga Gjykata e Lartë, është ndikuar edhe nga konteksti i akuzave (përfshirë edhe akuzën për korrupsion të cilën Gjykata e Lartë e ktheu për rigjykim), si dhe nga referimi dhe mbajtja parasyshe e një vendimi të KPK-së, i cili është marrë në kuadër të një procesi të jashtëzakonshëm, ku jo vetëm barra e provës ishte e përmbytur, por edhe të drejtat e kërkuesit ishin të kufizuara për shkak të interesit të lartë publik për garantimin e pastërtisë së figurës së

gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Ndaj jam i mendimit se Gjykata Kushtetuese në këtë rast duhej të kishte prishur vendimin e Gjykatës së Lartë dhe të kthente çështjen për rigjykim pranë asaj gjykate, me qëllim që ajo të zbatonte konstatimet e mësipërme me natyrë kushtetuese dhe të vendoste për çështjen, sipas rregullave të një gjykimi të drejtë, duke prishur pjesërisht vendimin e Gjykatës së Posaçme të Apelit dhe lënë në fuqi për atë pjesë vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë.

Anëtar: Asim Vokshi

VENDIM

Nr. 117, datë 24.4.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 20, 37, pika 2, germa “a”, dhe 44 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 17, pikat 2, 3 dhe 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016; neneve 4, germa “b”, 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin e ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/2 prot., datë 23.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e



Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tri degëzimet e Përroit të Neshtës, Degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005 prot., datë 30.3.2026, shoqëria ka depozituar në ERE kërkesën për transferimin e plotë të licencës së sipërcituar, të shoqëria e krijuar “HEC Polemi” sh.p.k., me ortak të vetëm shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., e cila do të administrojë dhe do të operojë aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për transferim, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin/informacionin e kërkuar për transferimin e licencës sipas germave (“b” dhe “c”).

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 17 “Transferimi i plotë dhe i pjesshëm i licencës”:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë të dhënat e kërkuara në zbatim të germave “b” dhe “c” të shtojcës 1 të Rregullores.

- Germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë dokumentacionin përkatës për vlefshmërinë e marrëveshjes së transferimit, të përcaktuar në këtë marrëveshje.

- Germa “f”: Shoqëria duhet të depozitojë miratimin apo qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në lidhje me këtë transferim.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 17, pika 1 dhe 5 të Rregullores së licencimit, ku përcaktohet, se: aplikimi për transferimin e aseteve fikse duhet të bëhet paralelisht me aplikimin për transferimin e licencës, sipas përcaktimeve të “Rregullores për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, dhe duke qenë se, sa informuar nga shoqëria, transferimi i licencës do të shoqërohet dhe me transferimin e plotë të aseteve të hidrocentralit, vlerësohet fillimi i procedurës dhe për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës në zbatim të Rregullores së transferimit të aseteve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për transferimin e licencës nr. 577, seria P24, dhënë shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

2. Të fillojë procedurën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 118, datë 24.4.2026****MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 13 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 275/12 prot., datë 23.4.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘GSA’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. ka paraqitur aplikim për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në datën 26.2.2026.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 70, datë 10.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.3.2026 dhe 12.3.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo objeksioneve nga të tretët (data 21.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 275/6 prot., datë 12.3.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për licencimin e saj dhe informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet për këtë aplikim.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 275/7 prot., datë 19.3.2026 dhe nr. 275/9 prot., datë 8.4.2026, shoqëria ka depozituar në ERE informacion/dokumentacion plotësues, duke

kërkuar kohë për depozitimin e dokumentacionit të mbetur.

- Për sa më sipër, me vendimin nr. 104, datë 14.4.2026, Bordi vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 275/11 prot., datë 16.4.2026, shoqëria depozitoi dhe dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A dhe ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Duke qenë se shoqëria ka një licencë të vlefshme për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike deri më 23.6.2026, vlerësohet që afati 5-vjeçar të fillojë në datën 24.6.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 24.6.2026.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GSA” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM
Nr. 126, datë 6.5.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
MIRATIMIN E LICENCËS TIP PËR
VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË
IMPIANTET E GNK-së ME PËRMASA
TË VOGLA**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 16, 22, pika 2, germa “P”, dhe 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1527 prot., datë 6.5.2026, të përgatitur nga drejtoritë teknike, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla”,

konstatoi se:

- Në zbatim të neneve 16, pika 11; 22, pika 2, germa “P” dhe nenit 23, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, ERE ka autoritetin për të miratuar licencën dhe kushtet e saj për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, si dhe përcakton kushtet dhe kriteret e licencimit për ushtrimin e veprimtarive në sektorin e gazit natyror.

- Licenca tip e hartuar nga ERE, parashikon detyrimin e të licencuarit për të projektuar, ndërtuar, operuar dhe mirëmbajtur impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në përputhje me standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme, përfshirë standardet ISO, normat evropiane (EN), si dhe rregullat teknike për pajisjet nën presion, mbrojtjen kundër shpërthimit (ATEX), mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë industriale, duke garantuar disponueshmërinë e kompresorëve, depozitave të presionit, sistemeve të tubacioneve, valvulave të sigurisë dhe pajisjeve të tjera teknologjike të certifikuara sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit shqiptar.

- Kushtet e licencës tip sanksionojnë detyrimin e të licencuarit për të siguruar që impiantet e GNK-së me përmasa të vogla të pajisen me sisteme automatike të ndalimit emergjent (*Emergency*

Shutdown System – ESD), sisteme detektimi të rrjedhjeve të gazit, sisteme mbrojtjeje kundër zjarrit dhe shpërthimit, ventilim teknik të përshtatshëm, sinjalistikë sigurie dhe zona të klasifikuara sipas kërkesave ATEX-it, si dhe me personel të trajnuar dhe të certifikuar për operime me gaz natyror dhe pajisje nën presion.

- Licenca tip parashikon detyrimin e të licencuarit për të hartuar dhe për të zbatuar plane emergjence, procedura evakuimi dhe masa reagimi ndaj incidenteve industriale, duke garantuar raportimin e menjëhershëm pranë ERE-s dhe institucioneve kompetente për çdo incident teknik, rrjedhje gazi, shpërthim apo situatë me risk të lartë, si dhe kryerjen e kontrolleve periodike teknike të të gjitha pajisjeve dhe infrastrukturës së impiantit.

- Licenca tip parashikon detyrimin e të licencuarit për të mbajtur llogari të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe për të dorëzuar balance financiare vjetore pranë ERE-s brenda datës 31 mars të çdo viti, duke raportuar periodikisht të dhëna operative, financiare dhe sasiore, përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat operative, pasqyrat e rrjedhës së parasë, sasitë e GNK-së të transportuara, numrin e klientëve të shërbyer, si dhe ankesat e regjistruara dhe trajtimin e tyre, në zbatim të nenit 30 dhe të kërkesave të raportimit sipas nenit 16, pika 24 të ligjit nr. 102/2015.

- Kushtet e licencës tip garantojnë aksesin objektiv dhe jodiskriminues të palëve të treta në shërbimet e ofruara nga i licencuari, duke ndaluar çdo formë diskriminimi ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura, si dhe duke parashikuar detyrimin e të licencuarit për të mbrojtur informacionin konfidencial me natyrë tregtare të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë.

- Licenca tip parashikon mekanizma të qartë për zbatimin e masave administrative dhe heqjen e licencës nga ERE, në rastet kur i licencuari nuk përmbush kushtet thelbësore të licencës, rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve, shkel dispozitat për mbrojtjen e mjedisit, ose nuk kryen pagesat rregullatore të vendosura nga ERE në zbatim të neneve 27 dhe 106 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe rregulloreve përkatëse të miratuara nga ERE.

- Në këtë kuadër, licenca tip synon të rregullojë ushtrimin e kësaj veprimtarie në mënyrë të unifikuar,



duke garantuar respektimin e kërkesave ligjore, standardeve teknike dhe të sigurisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e licencës tip për veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla (dokumenti bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Rregullimit të Gazit Natyror të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

LICENCË PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNK-së ME PËRMASA TË VOGLA

Licenca i jepet: _____

NUIS: _____

Numri i licencës: _____

Seria: _____

Data e hyrjes në fuqi: _____

Kohëzgjatja: _____

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë (“ERE”) i jep këtë licencë (“licenca”), për të kryer veprimtarinë e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, personit të lartpërmendur, i quajtur “I licencuari”, subjekt i Kushteve të Licencës të bashkangjitura dhe pjesë integrale të saj, si dhe kushteve të përcaktuara nga Bordi në vendimin e tij.

Kjo licencë hyn në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi, deri në përfundim të afatit të dhënë, në rast se nuk hiqet nga ERE, në përputhje me Kushtet e Licencës të përfshira këtu, apo parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

KRYETAR I ERE-s

KUSHTET E LICENCËS PËR VEPRIMTARINË E OPERIMIT NË IMPIANTET E GNK-së ME PËRMASA TË VOGLA

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur në kreun III, seksionin I, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, për të lëshuar dhe për të deklaruar hyrjen në fuqi të kësaj licence.

1. Nëse ndonjë kusht i kësaj licence bëhet nul ose i anulueshëm, apo pushon të qenët në fuqi, ky kusht do të hiqet nga licenca dhe kushtet e mbetura të licencës do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi.

2. Në rastet e transferimit të licencës, i licencuari ka detyrimin të njoftojë menjëherë ERE-n.

3. ERE ka të drejtën ekskluzive për të modifikuar këtë licencë, në rast se kushtet dhe rrethanat kanë ndryshuar, si dhe për të përmbushur dispozitat e rregullave për organizimin e tregut të gazit natyror: ligji nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”; kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror; Kodit të Rrjetit të Transmetimit; Kodi i Rrjetit të Shpërndarjes; Kodit të Matjes; dhe/ose akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ERE, në zbatim të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

Përkufizimet e termave të përcaktuar në:

- Ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;

- Rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017;

- Rregullore “Mbi procedurat e heqjes së licencave në sektorët e energjisë elektrike dhe të gazit



natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 58, datë 18.4.2017;

- “Rregulloren e organizimit, funksionimit dhe procedurat e ERE”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016;

- Rregullat dhe rregulloret që i përkasin sektorit të gazit natyror (legjislacioni në fuqi), përfshihen në këtë licencë për çdo qëllim.

Fjalë dhe fraza të tjera, të përdorura në këtë licencë dhe në kushtet e licencës, të cilat nuk përfshihen në ligjet dhe rregulloret e mësipërme, kanë kuptimet si më poshtë vijon:

- **“Gaz natyror i komprimuar” (GNK)** është gazi metan CH₄, i cili komprimohet në presionin 200 atm.

- **“Implant me përmasa të vogla”** është njësi lëvizëse që përdoret për prodhimin/depozitimin, transportimin dhe/ose shpërndarjen e sasive të vogla të GNK-së.

- **“Ndërsuvencionime”** do të thotë transferimi i fondeve ose ndarje e kostove ndër llogaritë e të licencuarit, ose llogaritë, me qëllim mbështetjen financiare të një aktiviteti, apo biznesi, përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror nga të ardhurat e fituara nga i licencuari që kryen aktivitetin e licencuar, ose duke i kaluar kostot të shkaktuara nga i licencuari gjatë kryerjes së aktivitetit të licencuar tek një aktivitet, apo biznes tjetër, përveç furnizimit, prodhimit dhe/ose tregtimit të gazit natyror.

- **“Aktivitet i licencuar”** do të thotë aktivitetet e lidhura direkt dhe të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të operimit në implantet e GNK-së me përmasa të vogla, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, rregullat për organizimin e tregut të gazit natyror, kushtet e përgjithshme për furnizimin me gaz natyror, si dhe rregullat dhe rregulloret e tjera që aplikohen.

- **“I licencuar”**, sikurse përdorur në këtë dokument, do të thotë personi i përmendur në faqen e parë të kësaj licence, që mban licencën e lëshuar nga ERE për kryerjen e aktivitetit të licencuar.

- **“Procedurat e licencimit për sektorin e gazit natyror”** do të thotë procedura e parashikuar në rregulloren “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017.

- **“Legjislacioni në fuqi”** do të thotë të gjitha standardet, kodet, rregullat, rregulloret, metodologjitë dhe çdo vendim ose akt tjetër në fuqi, të miratuara nga ERE dhe autoritete të tjera kompetente sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar.

- **“Informacion me ndjeshmëri tregtare”** do të thotë, të dhëna në lidhje me biznesin ose me natyrë tregtare të përdoruesve të sistemit, që zotërohen nga i licencuari gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit të licencuar, të cilat duhet të mbahen konfidenciale.

- **“Informacion me avantazh tregtar”** do të thotë informacion i lidhur me aktivitetin e vetë të licencuarit, i cili duhet të mbahet konfidencial dhe nuk duhet t’i jepet apo t’u bëhet i ditur të tjerëve në mënyrë diskriminuese.

- **“Forcë madhore”** është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

- **“Pagesa rregullatore”** është pagesa vjetore që shoqëritë e licencuara në sektorin e gazit natyror paguajnë në ERE për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij, në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE.

Neni 2

Kryerja e aktivitetit të licencuar

1. I licencuari autorizohet nga kjo licencë për të zhvilluar aktivitetin e operimit në implantet e GNK-së me përmasa të vogla, sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në rast se subjekti synon të ushtrojë edhe veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, si transmetimi, shpërndarja apo depozitimi, ai duhet të pajiset me licencat përkatëse për secilën prej tyre, në përputhje me nenin 22, germa “f”, të ligjit nr. 102/2015. Në çdo rast, i licencuari mban llogari të ndara për secilën veprimtari të licencuar, sipas nenit 30 të këtij ligji.



2. I licencuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të tentojë të ndalojë të licencuarit e tjerë ose pjesëmarrësit potencialë ose konkurrentët që të angazhohen ose të hyjnë në biznesin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla apo në aktivitete të tjera në sektorin e gazit natyror në Republikën e Shqipërisë;

3. I licencuari nuk do të përfshihet në asnjë formë aktiviteti monopol ose antikonkurrencë të ndaluar nga legjislacioni në fuqi ose rregulloret dhe rregullat e miratuara nga ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës.

4. I licencuari nuk mund të ushtrojë veprimtari të tjera të rregulluara në sektorin e gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen apo depozitimin e gazit natyror, pa u pajisur me licencën përkatëse nga ERE.

5. Brenda datës 31 janar të çdo viti, i licencuari do t'i dërgojë ERE-s një informacion dhe deklaratë me shkrim për kryerjen e aktivitetit gjatë vitit paraardhës dhe përmbushjes së kuadrit ligjor në sektorin e gazit natyror, sipas kërkesave raportimit të vendosura nga ERE, sipas nenit 16, pika 24 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar.

6. I licencuari nuk do të bashkëpunojë me persona të tjerë për të dëmtuar interesat e të licencuarve ose klientëve të gazit natyror.

7. I licencuari do ta kryejë aktivitetin e licencuar, në përputhje me parimet e transparencës, të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

8. I licencuari që do të angazhohet në aktivitete të tjera të ndryshme nga aktiviteti për të cilin është licencuar, duhet të informojë ERE-n, në rastet kur synon të:

a) angazhohet në aktivitet tjetër përveç aktivitetit të licencuar; ose

b) të ngrejë një biznes shoqëruar.

9. ERE mund ta ndalojë angazhimin në një aktivitet tjetër, ose të vendosë kushte të veçanta për ngritjen e bizneseve shoqëruar, të nevojshme për të mbrojtur interesat e klientëve.

10. I licencuari nuk është përgjegjës për mospërmbushjen e Kushteve të Licencës në rast të një force madhore deri në atë shkallë sa forca madhore është shkaku për këtë mospërmbushje të Kushteve të Licencës. Në këtë rast, i licencuari duhet të njoftojë menjëherë ERE-n dhe të licencuarit e tjerë ose klientët me të cilët i licencuari ka lidhur marrëveshje.

Neni 3

Detyrimet e të licencuarit

1. I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe gjithë vendimet e Këshillit të Ministrave dhe rregulloret e rregullat e miratuara nga ERE, si dhe rregullave specifike që lidhen me kryerjen e aktivitetit nga institucionet e përcaktuara për të dhënë vërtetimet ose certifikimet.

2. I licencuari është i detyruar të projektojë, ndërtojë, operojë dhe mirëmbajë impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në përputhje me standardet teknike kombëtare dhe ndërkombëtare të aplikueshme, përfshirë standardet ISO, EN (Normat Evropiane) dhe rregullat teknike për pajisjet nën presion, mbrojtjen kundër shpërthimit (ATEX), mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë industriale.

3. I licencuari në aktivitetin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në zbatim të kësaj licence, duhet:

a) të ndërmarrë masat e nevojshme për garantimin e aftësive teknike dhe financiare për kryerjen e aktivitetit të licencuar; të dorëzojë përmbledhje të projektit, duke përfshirë llojin e impiantit dhe funksionimin e tij të synuar;

b) të regjistrohet si pjesëmarrës i tregut shqiptar të gazit natyror pranë operatorit të tregut të gazit natyror, sipas procedurave të regjistrimit dhe do të zbatojë legjislacionin në fuqi dhe vendimet e ERE-s; emri ligjor i individit ose entitetit, akti i partneritetit dhe dokumentet CNIC/identifikimi, dhe lloji specifik i licencës; adresa e detajuar, hartat topografike që tregojnë zonat përreth brenda 100 metrave dhe prova e blerjes së tokës;

c) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës operative dhe ekonomike të veprimtarisë së licencuar, me qëllim që të sigurojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve të ofruara prej tij në përfitim të klientëve dhe të sektorit të gazit natyror;

d) të kryejë operimin në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, në kushte të sigurta, të qëndrueshme dhe eficiente, duke marrë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të garantojë mjete të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e shërbimit;

e) të sigurojë kushte objektive dhe jodiskriminuese, për akses në shërbimin e operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla;



f) të kufizojë diskriminimin ndërmjet përdoruesve ose grupeve të përdoruesve të shërbimit operimit në impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, sidomos kur ky diskriminim favorizon shoqëritë e lidhura;

g) të mbrojë informacionin konfidencial, me natyrë tregtare, të marrë gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

i) të disponojë kompresorë, depozita presioni, sisteme tubacionesh, valvula sigurie dhe pajisje të tjera teknologjike të certifikuar sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe legjislacionit shqiptar për pajisjet nën presion;

j) të sigurojë që impianti të pajiset me:

- sisteme automatike të ndalimit emergjent (*Emergency Shutdown System – ESD*);

- sisteme të detektimit të rrjedhjeve të gazit;

- sisteme të mbrojtjes kundër zjarrit dhe shpërthimit;

- ventilim teknik të përshtatshëm;

- sinjalistikë sigurie dhe zona të klasifikuara sipas kërkesave ATEX;

k) të sigurojë që operimi i impiantit të kryhet vetëm nga personel i trajnuar dhe i certifikuar për operime me gaz natyror dhe pajisje nën presion;

l) të hartojë dhe të zbatojë plane emergjence, procedura evakuimi dhe masa reagimi ndaj incidenteve industriale;

m) të kryejë kontroll periodik teknik;

n) i licencuari garanton që impiantet e GNK-së me përmasa të vogla, janë ndërtuar dhe operohen në mënyrë të sigurt, duke minimizuar rrezikun për jetën, shëndetin, pronën dhe mjedisin;

o) i licencuari është përgjegjës, për:

a) zbatimin e kërkesave të sigurisë teknike dhe industriale;

b) kontrollin e integritetit të pajisjeve nën presion;

c) monitorimin e rrjedhjeve dhe emetimeve të gazit;

d) menaxhimin e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme;

e) respektimin e distancave të sigurisë nga objektet përreth sipas legjislacionit në fuqi.

p) i licencuari e zhvillon veprimtarinë e tij në referencë dhe zbatim të akteve përkatëse të kolaudit, certifikatave të konformitetit të pajisjeve, lejet mjedisore dhe kundër zjarrit; procedurave operative standarde dhe manualeve të sigurisë.

Çdo incident teknik, rrjedhje gazi, shpërthim apo situatë me risk të lartë duhet t'i raportohet menjëherë ERE-s dhe institucioneve kompetente.

Neni 4

Llogaritë dhe raportimi

1. I licencuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë bilance financiare, të cilat do të mbahen të ndara për aktivitetin e licencuar dhe çdo aktivitet tjetër (përfshirë aktivitete të tjera të licencuara), ku është angazhuar i licencuari, në përputhje me rregullat e kontabilitetit dhe procedurat e miratuara nga ERE dhe në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror". Kur është e nevojshme dhe sipas kushteve të përcaktuara të rregullat dhe rregulloret që aplikohen, këto llogari mund të ofrohen në një formë të konsoliduar. I licencuari do t'i dorëzojë ERE-s bilance financiare vjetore deri në datën 31 mars të çdo viti. Nëse i licencuari ushtron më shumë se një aktivitet, faturat e shpenzimeve për çdo aktivitet që ushtron, duhet të jenë lehtësisht të dallueshme se cilit aktivitet i përkasin, me shenja dalluese të qarta sipas përkatësisë së aktivitetit të licencuar për të cilin janë përdorur.

2. Në çdo rast të tillë, i licencuari duhet t'i deklarojë ERE-s mënyrën e identifikimit të secilës faturë.

3. Të dhënat duhet të përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve përkatëse, si:

a) kohëzgjatja;

b) rregullat e ofertës dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;

c) sasinë, datat;

d) kohën e ekzekutimit të kontratës;

e) çmimet e transaksionit;

f) mjetet e identifikimit të klientëve me shumicë të përfshirë, detaje për të gjitha kontratat e papaguara.

4. ERE mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut të dhëna të caktuara, të deklaruara nga i licencuari, me kusht që të mos publikohet informacioni që përbën sekret tregtar.

5. I licencuari njofton menjëherë ERE-n për çdo situatë emergjente që ndikon në funksionimin e impiantit, duke përshkruar masat e marra.

6. I licencuari do të ndajë shpenzimet e përbashkëta mes aktivitetit të tij të licencuar dhe tipave të tjerë të aktiviteteve, në përputhje me



rregulloret dhe rregullat e ERE-s. I LICENCUARI do t'i paraqesë ERE-s, në kërkesën e tij, në formën dhe në afatin e vendosur nga ERE, dokumentacionin që vendos bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta mes aktiviteteve që do të ushtrohen, si dhe rezultatet e arritura pas kësaj ndarje.

7. I licencuari do të njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim, të:

- a) adresës;
- b) statutit të të licencuarit;
- c) certifikatës së regjistrimit;
- d) NUIS-it
- e) organeve kryesore drejtuese; ose
- f) strukturës së biznesit të licencuar.

8. Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet, pretendimet ose korrespondenca tjetër me ERE-n lidhur me licencën duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar respektivisht nga një zyrtar i autorizuar, ose përfaqësues ligjor i caktuar i të licencuarit ose ERE-s, dhe të dërgohet me korrier ose postë të regjistruar, duke kërkuar një verifikim të fletës së marrjes. Adresat e palëve duhet të vendosen mbi zarf. Gjithë njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i dorëzimit, ose nëse nuk janë dorëzuar për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i prezantimit.

9. I licencuari do të dërgojë në ERE informacion periodik, lidhur me:

- a) shpenzimet dhe të ardhurat operative (mujore dhe në progresion 3-mujor);
- b) pasqyra *Cash-Flow* (mujore dhe progresive);
- c) tabela e të dhënave mbi sasitë e GNK-së me përmasa të vogla, të transportuara (mujore dhe progresive);
- d) çdo informacion të kërkuar rast pas rasti nga ERE;
- e) numrin e klientëve për të cilët ka ofruar shërbimin e transportimit (mujore dhe progresive);
- f) grafikët e ngarkesës;
- g) sistemet e matjes;
- h) të dhëna mbi ankesat e regjistruara, trajtimin dhe korrigjimet në faturimet përkatëse objekt ankimi (mujore dhe progresive);
- i) çdo informacion tjetër sipas ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe kërkesave të raportimit të miratuara nga ERE, sipas nenit 16 pika 24 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Neni 5

Përdorimi i informacionit

1. I licencuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë si rezultat i aktivitetit të tij të licencuar nuk do t'i jepet askujt, me përjashtim të rasteve kur:

- a) jepet pëlqim paraprak me shkrim i personit me të cilin lidhet informacioni;
- b) informacioni është bërë publik;
- c) kur të licencuarit i kërkohet ose lejohej të përhapë informacionin për të përmbushur kushtet e kësaj licence, sipas një urdhri të ERE-s, ose çdo dispozite ligjore të aplikueshme;
- d) informacioni duhet përhapur në funksion të kryerjes së aktivitetit të licencuar.

2. I licencuari do të sigurojë që çdo biznes shoqërues nuk do të përdorë asnjë informacion të të licencuarit për të fituar një avantazh konkurrues të pajustificuar dhe do të sigurojë që nuk do të përhapë asnjë informacion të ndonjë person tjetër (përfshirë biznese të tjera shoqëruese), që mund ta mundësojnë këtë person të fitojë çdo lloj përfitimi komercial të pajustificuar.

3. Çdo informacion me avantazh tregtar në zotërim të të licencuarit duhet të shpërndahet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe duhet të aksesohet lehtësisht dhe në mënyrë të barabartë nga konsumatorët aktualë dhe të mundshëm dhe palët e tjera të interesuara. Shpërndarja e informacionit me avantazh tregtar duhet të përpunohet për të parandaluar trajtimet preferenciale të konsumatorëve individualë, pjesëmarrësve të tjerë të tregut të gazit natyror ose palëve të tjera të interesuara, në lidhje me fushëveprimin, përmbajtjen dhe/ose formën e informacionit të shpërndarë dhe/ose kohën kur ai është shpërndarë.

4. I licencuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta ruajtur konfidencial informacionin në posedim të tij dhe për t'i raportuar ERE-s në përputhje me detyrimet ligjore, sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, kushteve të përgjithshme për furnizimin me gaz natyror dhe kontratën e furnizimit me gaz natyror.

5. Informacioni i dërguar ERE-s nga i licencuari do të konsiderohet publik me përjashtim të rasteve kur me kërkesë specifike të të licencuarit, ERE, me vendim, përcakton që ky informacion është i natyrës pronësore dhe përhapja e tij nuk i shërben interesit publik.



6. ERE ruan konfidencialitetin e Informacionit të ndjeshëm tregtar të marrë nga i licencuari, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara të rregulloret dhe rregullat që aplikohen sipas neneve 16 pika 15 dhe 20 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

7. I licencuari nuk do të hyjë në marrëveshje, të cilat i licencuari e di ose duhet ta dijë që çojnë në shkelje të Kushteve të Licencës.

8. I licencuari do të respektojë ligjet dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe rregulloret e rregullat e ERE-s.

Neni 6

Pagesat e rregullimit

1. I licencuari do t'i paguajë ERE-s pagesa rregullimi në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme gjatë afatit të kësaj licence, siç përcaktohet nga ERE në rregulloren për pagesat e rregullimit, si dhe nenin 14 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Nëse i licencuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit brenda afatit të përcaktuar nga ERE, i licencuari do të penalizohet, në përputhje me ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe rregulloren “Mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 95, datë 4.7.2017.

Neni 7

Kontrolli mbi kryerjen e aktivitetit të licencuar

1. ERE do të monitorojë respektimin nga i licencuari të kushteve të licencës, do të rishikojë raportet e marra nga i licencuari dhe është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiarë të të licencuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik dhe/ose financiar të veprimtarive të të licencuarit. Për këtë qëllim, ERE ndër të tjera duhet të ketë akses të pakufizuar të llogaritë e të licencuarit, sipas neneve 30 dhe 31 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

2. Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të licencuarit për të inspektuar veprimtarinë e licencuar sipas rregullave të ERE-s. I licencuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.

3. Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me iniciativën e vet, ERE mund të nisë

një hetim administrativ për respektimin nga i licencuari të Kushteve të Licencës ose rregullave të ERE-s.

4. Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i licencuari nuk i ka respektuar Kushtet e Licencës, ERE mundet të ndërmarrë masa të tjera brenda autoritetit të saj, me qëllim që të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj licence.

5. I licencuari do ta informojë dhe sqarojë ERE-n për çdo shkelje të Kushteve të Licencës, jo me vonë se një javë pasi kjo shkelje i bëhet e njohur të licencuarit.

6. I licencuari do t'u bindet vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 8

Amendimi i licencës

1. ERE mund të ndryshojë/shfuqizojë Kushtet e Licencës, në rast se ato nuk përputhen me:

a) Legjislacionin në fuqi dhe vendimet e qeverisë së Republikës së Shqipërisë, që janë në përputhje me Legjislacionin në fuqi;

b) Vendimet e nxjerra nga një Gjykatë Shqiptare me kompetencë juridiksionale.

2. Në çdo kohë i licencuari mund t'i propozojë ERE-s ndryshime të tjera të Kushteve të kësaj Licence, duke paraqitur një propozim me shkrim, së bashku me dokumentet mbështetëse. ERE mund të propozojë ndryshime të kushteve të kësaj licence e t'i konsultojë ato me palët e interesit përpara miratimit.

3. ERE do të marrë vendimin përfundimtar, vetëm pasi të marrë në konsideratë interesat e klientëve dhe të licencuarve të tjerë. Palët e interesuara do të informohen me shkrim për çdo ndryshim të propozuar. Nëse ERE dhe i licencuari arrijnë një marrëveshje për këto ndryshime, Kushtet e Licencës do të amendohen. Nëse marrëveshja nuk arrihet, i licencuari mund të apelojë në Gjykatën Administrative Tiranë.

4. Të gjitha ndryshimet të Kushteve të Licencës duhet të kryhen nga ERE, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, procedurës së licencimit për sektorin e gazit natyror dhe akteve të tjera nënligjore që aplikohen.

5. Amendimet e bëra në Kushtet e Licencës do të publikohen në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.



Neni 9

Vendosja e masave administrative dhe heqja e licencës

1. Nëse i licencuari nuk përmbush kushtet e kësaj licence, ERE mund të aplikojë masa administrative, sipas nenit 106 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, dhe “Rregullores mbi kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën konkrete për çdo shkelje”.

2. ERE mund të heqë licencën në përputhje me nenin 27 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”.

Neni 10

Heqja e licencës

1. ERE heq një licencë kur i licencuari:

- a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës;
- b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;
- c) rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve;
- d) nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE;
- e) bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit;
- f) me kërkesë të të licencuarit;
- g) ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës.

2. Licenca mund të hiqet nga ERE sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara të ligji nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, procedurave të licencimit për sektorin e gazit natyror, rregullores mbi procedurat e refuzimit të licencës në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror, si dhe rregullave dhe rregulloreve të tjera që aplikohen.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe e drejta për apelim

1. Çdo çështje e diskutueshme ose kërkesë mes të licencuarit dhe çdo pjesëmarrësi tregu do të zgjidhet sa më shumë që të jetë e mundur me mirëkuptim, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret dhe rregullat e ERE-s.

2. Nëse zgjidhja nuk arrihet me mirëkuptim, atëherë ERE në bazë të kërkesës së çdo personi që

është palë në këtë mosmarrëveshje do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do të nxjerrë vendimin e tij në përputhje me nenin 98 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga konsumatorët dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorët e energjisë elektrike dhe gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

3. I licencuari mund të apelojë kundër vendimeve të ERE-s në Gjykatën Administrative Tiranë.

KËRKESË**Nr. 532/6, datë 2.6.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Zgjerimi i rrugës Elbasan–Qafëthanë (faza 1)”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 278.400 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasurinë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “arë” dhe “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 278.400 (dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritet Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM**Ermal Shena**



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMI E PROJEKTIT “ZGJERIM I RRUGËS ELBASAN-QAFËTHANË (FAZA I)”

Nr.	PRONARI			Adresa e pasurisë	TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM									SHUMA TOTALE	SHËNIM E (SEKSIONI C, D, E TË KARTELËS SË PASURISË)	ADRESAT E PRONARËVE	
	Emër	Atësi	Mbiemër		Zona kadastrale	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Arë (m²)	Ndërtesë (m²)	ARË			Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)				
											Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)										
	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	M	N	O = (M) x (N)	Q	R = (P) x (Q)	U = (S) x (T)	X	Y	Z=X*Y	W=O+R+U+Z			
1	Ali	Rrapush	Murati	Mirakë	2696	488	Arë	1248			14	174	2,436.00							2,436.00		Rruga "Mirakë", "Gjovac"	
2		Shiteti		Mirakë	2696	499/2	Arë	1055			176	0	-							-			
3	Beqir	Rrapush	Murati	Mirakë	2696	499/1	Arë	3480			383	174	66,642.00							66,642.00		Rruga "Mirakë", "Gjovac"	
4	Fende	Idriz	Krozi	Mirakë	2696	508	Arë	1467			226	174	39,324.00							39,324.00			
	Hasan	Sherif	Krozi	Mirakë																			
	Muzejane	Sherif	Koçi	Mirakë																			
	Qamile	Nezir	Krozi	Mirakë																			
	Irym	Hasan	Krozi	Mirakë																			
	Dëshira	Hasan	Krozi	Mirakë																		Rruga e Kocit	
5	Xhaferi	Ali	Krozi	Mirakë	2696	512	Arë	1454			283	174	49,242.00							49,242.00		Rruga e Kocit	
	Mustafa	Ali	Krozi	Mirakë	2696	518	Arë	1000			140	174	24,360.00							24,360.00		Mirakë	
7	Dritan	Idriz	Krozi	Mirakë	2696	524	Arë	895			123	174	21,402.00							21,402.00			
	Xhemile	Selman	Krozi	Mirakë																			
	Andolina	Idriz	Hoxha	Mirakë																			
	Fatime	Idriz	Zeneli	Mirakë																			
	Gentian	Idriz	Krozi	Mirakë																		Mirakë	
8	Ramazan	Ismail	Terziu	Mirakë	2696	536	Arë+Truall	1585			208	174	36,192.00							36,192.00		Mirakë	
9	Republika e Shqipërisë			Mirakë	2696		Mirakë	383			290	0	-							-			Mirakë
10	Musa	Ismail	Terziu	Mirakë	2696	539	Arë+Truall	1090			104	174	18,096.00							18,096.00		Sip. banimi katë përdhies 49.5 m²	
	Irena	Necras	Terziu	Mirakë																			
11	Qamile	Ali	Terziu	Mirakë	2696	548	Arë	883			119	174	20,706.00							20,706.00			
	Hajn	Ibrahim	Terziu	Mirakë																			
	Icimir	Ibrahim	Terziu	Mirakë																			
	Harni	Ibrahim	Terziu	Mirakë																			
	Enjon	Ibrahim	Terziu	Mirakë																			
	Xhevalure	Ibrahim	Cam	Mirakë																			
SHUMA PARAPRAKE																				278,400.00			

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin nr. 1271, datë 12.3.2026, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Spiro Jaçaj, i lindur më 14.8.1960 në Vlorë, me atësi Mustafa dhe amësi Kostë, dhe caktimin si datë të vdekjes, datën 1.11.2008. Caktimin e kërkuësës Andina Bajrami (Jaçaj) si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të shtetasit Spiro Jaçaj.



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 336 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 117][Datë: 08.06.2026 13:32:17
+02:00][36ec9376-31fe-4ef8-83c9-c4bccd58f7a8]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)